



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2025 – Numri: 53

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 17 mars 2025

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 18/2025, datë 13.3.2025	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për “Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”.....	6227
Dekret i Presidentit nr. 99, datë 17.3.2025	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit.....	6264
Ligj nr. 19/2025, datë 13.3.2025	Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje.....	6264
Dekret i Presidentit nr. 100, datë 17.3.2025	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit.....	6294





**LIGJ**  
**Nr. 18/2025**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË, SI HUAMARRËS,  
BANKËS SË SHQIPËRISË, SI AGJENT  
I HUAMARRËSIT, DHE BASHKIMIT  
EVROPIAN, TË PËRFAQËSUAR NGA  
KOMISIONI EVROPIAN, SI  
HUADHËNËS, PËR “LEHTËSINË E  
REFORMËS DHE ZGJERIMIT PËR  
BALLKANIN PERËNDIMOR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së

**LEHTËSIA E REFORMËS DHE ZGJERIMIT PËR  
BALLKANIN PERËNDIMOR  
MARRËVESHJE HUAJE  
ndërmjet  
BASHKIMIT EVROPIAN  
të përfaqësuar nga Komisioni Evropian  
si Huadhënës  
DHE  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
si Huamarrës  
dhe  
BANKËS SË SHQIPËRISË  
si Agjent i Huamarrësit  
2024**

Kjo Marrëveshje Huaje lidhet nga dhe ndërmjet Bashkimit Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian,

si Huadhënës,

dhe

Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministri i Financave,

Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për “Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 99, datë 17.3.2025,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bajram Begaj.**



si Huamarrës,

dhe

Bankës së Shqipërisë, që vepron si agjent për Huamarrësin, e përfaqësuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë,

në këtë Marrëveshje bashkërisht të referuara si "Palët" dhe individualisht si "Pala".

## PREAMBULË

Duke pasur parasysh se:

- (1) Rregullorja (BE) 2024/1449 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ("Rregullorja e 2024/1449"), ka krijuar "Lehtësinë e Reformës dhe Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor" ("Lehtësia")<sup>1</sup> për të mbështetur procesin e zgjerimit, duke përshpejtuar përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian, për të përshpejtuar integrimin ekonomik rajonal si dhe konvergjencën socio-ekonomike me BE-në.
- (2) Mbështetja në bazë të Lehtësisë duhet të sigurohet pas miratimit nga Komisioni, në përputhje me Nenin 15 të Rregullores (BE) 2024/1449, të një Axhende Reforme të paraqitur nga Huamarrësi ("Axhenda e Reformës"), e cila përcakton reformat që duhet të ndërmerren nga përfituesi si dhe zonat e investimit. Axhenda e Reformës duhet të ofrojë një kornizë gjithëpërfshirëse për arritjen e objektivave të Lehtësisë në bazë të, ndër të tjera, një marrëveshjeje lehtësie dhe një marrëveshjeje huaje që do të lidhen ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Huamarrësit.
- (3) Në përputhje me Nenet 11, 12 dhe 13 të Rregullores (BE) 2024/1449, Huamarrësi ka përgatitur dhe dorëzuar Axhendën e Reformës Komisionit në 11 tetor 2024. Në përputhje me Nenet 14 dhe 15 të Rregullores (BE) 2024/1449, Komisioni ka vlerësuar rëndësinë, gjithëpërfshirjen dhe përshtatshmërinë e Axhendës së Reformës dhe e ka miratuar atë me anë të një vendimi zbatues në 23 tetor 2024<sup>2</sup> ("Vendimi Zbatues i Komisionit").

<sup>1</sup> Rregullorja (BE) 2024/1449 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 maj 2024, për krijimin e Lehtësisë të Reformës dhe Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor, GZ L, 2024/1449, 24.5.2024, f. 1.

<sup>2</sup> C(2024) 7375, 23.10.2024.



- (4) Në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/1449 Komisioni ka miratuar, me anë të Vendimit Zbatues të Komisionit, një kontribut financiar total maksimumi deri në shumën 657,458,743.67 Euro, si mbështetje me hua të lidhur me përmbushjen e pranueshme të kushteve të pagesës (hapat cilësorë dhe sasiorë), siç specifikohet në Axhendën e Reformës, si dhe të parakushteve dhe kushteve të përgjithshme për disbursimin të specifikuar përkatësisht në Nenet 5 dhe 12 të Rregullores (BE) 2024/1449.
- (5) Mbështetja me hua, që do të zbatohet pjesërisht përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor ("KIBP"), do të disbursohet drejtpërdrejt në thesarin e Huamarrësit. Huamarrësi do të transferojë 34,75% të mbështetjes me hua në Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (FPEBP), i krijuar në bazë të KIBP-së për marrjen e kontributeve të donatorëve në përputhje me marrëveshjet e kontributit që do të lidhen ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës Evropiane të Investimeve ("Menaxherët e Fondit"), në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me fondin ("Kushtet e Përgjithshme FPEBP").
- (6) Në përputhje me Nenin 9 të Rregullores (BE) 2024/1449, Bashkimi Evropian ka lidhur një marrëveshje lehtësie ("Marrëveshja e Lehtësisë") me Huamarrësin, që përcakton parimet e bashkëpunimit financiar midis Bashkimit Evropian dhe përfituesit dhe specifikon dispozitat e hollësishme për sa i përket, ndër të tjera, aktiviteteve që lidhen me menaxhimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin dhe auditimin e fondeve në bazë të Lehtësisë, si dhe masat për të parandaluar, zbuluar, hetuar, korrigjuar dhe raportuar në mënyrë të efektshme parregullsitë, rastet e mashtrimit, korrupsionit dhe çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe konfliktet e interesave, duke përfshirë hetimin dhe ndjekjen e efektshme të veprave që prekin interesat financiare të Bashkimit Evropian, dhe për të shmangur financim të dyfishtë.
- (7) Në përputhje me Nenin 9(2) të Rregullores (BE) 2024/1449, Marrëveshja e Lehtësisë duhet të plotësohet me një marrëveshje huaje që përcakton dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e financimit, që i ofrohet Huamarrësit në formën e huave në bazë të Lehtësisë.
- (8) Në përputhje me Nenin 9(3) të Rregullores (BE) 2024/1449, financimi do t'i jepet Huamarrësit vetëm pasi Marrëveshja përkatëse e Lehtësisë dhe marrëveshja e zbatueshme e huasë të kenë hyrë në fuqi.
- (9) Në përputhje me Nenet 12 dhe 21 të Rregullores (BE) 2024/1449, disbursimi i mbështetjes me hua duhet të sigurohet me këste, në bazë të përmbushjes të pranueshme të kushteve të pagesës, në formën e hapave cilësorë dhe sasiorë të specifikuar në Vendimin Zbatues të Komisionit dhe sipas përmbushjes së parakushteve dhe kushteve të përgjithshme të specifikuar përkatësisht në Nenet 5 dhe 12 të Rregullores (BE) 2024/1449.
- (10) Në përputhje me Nenin 21(11) të Rregullores (BE) 2024/1449, disbursimet e huasë i nënshtrohen financimit të disponueshëm dhe një këst mund të disbursohet në një ose më shumë transhe.
- (11) Në përputhje me Nenin 20 të Rregullores (BE) 2024/1449, përfituesit e Ballkanit Perëndimor mund të kërkojnë, pas dorëzimit të Axhendës së tyre të Reformës, një pagesë parafinancimi deri në vlerën 7% të shumës totale të parashikuar nga Lehtësia, sipas përmbushjes nga përfituesit e Ballkanit Perëndimor të parakushteve dhe kushteve të përgjithshme të



specifikuara përkatësisht në Nenet 5 dhe 12 të Rregullores (BE) 2024/1449. Në parafinancimin kombinohet mbështetja financiare e pakthyeshme dhe mbështetja me hua. Parafinancimi që korrespondon me huatë duhet të vihet në dispozicion të thesarit të Republikës së Shqipërisë.

- (12) Në Vendimin Zbatues të Komisionit përcaktohet një mbështetje totale në formën e mbështetjes me hua në bazë të Lehtësisë që arrin maksimumi deri në 657,458,743.67 Euro për Huamarrësin. Në përputhje me Nenin 20 të Rregullores (BE) 2024/1449, Huamarrësi ka kërkuar një shumë parafinancimi prej 46,022,112.06 EURO, në formën e mbështetjes me hua.
- (13) Në bazë të Nenit 9(4) të Rregullores (BE) 2024/1449, marrëveshja e huasë që do të lidhet ndërmjet Komisionit dhe Huamarrësit duhet të parashikojë detyrimet e Huamarrësit në lidhje me bashkëpunimin për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian, siç specifikohet në Nenin 129 të Rregullores (BE, Euratom) 2024/2509 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 23 shtator 2024, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian<sup>3</sup> ("**Rregullorja Financiare**")
- (14) Dispozitat e Rregullores Financiare në lidhje me zbatimin e ndihmës financiare nga Huadhënësi duhet të zbatohen për Huanë sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur derogohet nga Rregullorja (BE) 2024/1449;
- (15) Strategjia e financimit të Komisionit ("**Strategjia e Diversifikuar e Financimit**"), e specifikuar në Nenin 224 të Rregullores Financiare dhe e rregulluar nga rregullat e Vendimit Zbatues të Komisionit (BE, Euratom) 2023/2825<sup>4</sup>, të ndryshuar ose zëvendësuar sipas rastit, zbatohet për financimin e ndihmës financiare në formën e huave të dhëna në bazë të Lehtësisë.
- (16) Komisioni do të lançojë në emër të Bashkimit Evropian emëtime obligacionesh, kartëvaluta, kambiale afatshkurtra ose çdo transaksion tjetër të përshtatshëm financiar afatshkurtër dhe/ose afatgjatë ("**Instrumentet e Financimit**") për financimin e mbështetjes me hua të kërkuar nga Huamarrësi.
- (17) Në përputhje me pikën 50 dhe Nenin 17 të Rregullores (BE) 2024/1449, Komisioni duhet të ofrojë hua në kushte sa më koncesionare, me kohëzgjatje maksimale 40 vite, me shlyerjen e principalit duke filluar nga viti 2034, në pajtim të plotë me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar.
- (18) Afatet e çdo disbursimi të mbështetjes me hua përcaktohen në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/1449, Vendimin Zbatues të Komisionit, Axhendën e Reformës, Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove, Marrëveshjen e Lehtësisë dhe këtë Marrëveshje Huaje.
- (19) Masat e duhura në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit, korrupsionit dhe

<sup>3</sup> GZ L 239, 26.9.2024.

<sup>4</sup> Vendimi Zbatues i Komisionit (BE, Euratom) 2023/2825, i datës 12 dhjetor 2023



parregullsive të tjera që ndikojnë në Hua, duhet të parashikohen nga autoritetet e Huamarrësit.

**Tashmë dhe si rrjedhojë, Palët kanë rënë dakord si më poshtë:**

#### **Neni 1 PËRKUFIZIMET**

Në këtë Marrëveshje Huaje (duke përfshirë pikat e saj) termat e mëposhtëm kanë kuptimin e mëposhtëm:

- (1) **"Periudhë Disponueshmërie"** është periudha deri në datën e përcaktuar në Nenin 2(6) të kësaj Marrëveshjeje Huaje.
- (2) **"Përqindje e Shpërndarë"** është një pjesë e barabartë me 34.75% të mbështetjes me hua të dhënë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Huaje, të cilën Huamarrësi duhet ta transferojë tek FPEBP-ja.
- (3) **"Huamarrësi"** është Republika e Shqipërisë.
- (4) **"Ditë Pune"** është një ditë në të cilën sistemi i pagesave TARGET2 është i hapur për biznes.
- (5) **"Komisioni"** është Komisioni Evropian.
- (6) **"Njoftim Konfirmimi"** është njoftimi me shkrim i Huadhënësit për Huamarrësin në formën e Shtojcës 2 që specifikon kushtet përfundimtare të Këstit të Huasë ose, sipas rastit, një transh të Këstit të Huasë.
- (7) **"Metodologji e Shpërndarjes së Kostove"** është Vendimi Zbatues i Komisionit (BE, Euratom) 2024/1520, i datës 12 korrik 2024, i cili përcakton kornizën për alokimin e kostove në lidhje me operacionet e huamarrjes dhe menaxhimit të borxhit sipas strategjisë së diversifikuar të financimit<sup>5</sup>, të ndryshuar ose zëvendësuar sipas rastit.
- (8) **"Konflikt i Interesave"** në përputhje me Nenin 61 të Rregullores Financiare, është kur ushtrimi i paanshëm dhe objektiv i funksioneve të një personi të përfshirë në zbatimin e mbështetjes financiare në bazë të Lehtësisë rrezikohet për arsye që përfshijnë jetën familjare, emocionale, politike ose përkatësinë kombëtare, interesin ekonomik ose çdo interes tjetër personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë. Konflikti i interesave përfshin situata që objektivisht mund të kuptohen si konflikt interesash.
- (9) **"Korrupsion"** është korrupsioni siç përcaktohet në Nenin 4(2) të Direktivës (BE) 2017/1371 ose korrupsion aktiv sipas kuptimit të Nenit 3 të Konventës për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, e hartuar me anë të Aktit të Këshillit, të datës 26 maj 1997, ose sjellja e përmendur në Nenin 2(1) të Vendimit Kuadër të Këshillit 2003/568/JHA, ose korrupsioni siç përcaktohet në ligje të tjera në fuqi.

<sup>5</sup> GZ L, 2024/1974, 18.7.2024.



- (10) **"Kosto e Mbjajtjes"** është kostoja e mbajtjes, siç përcaktohet në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove.
- (11) **"Kosto e Financimit"** është kostoja e financimit, siç përcaktohet në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove.
- (12) **"Kosto e Menaxhimit të Likuiditetit"** është kostoja e menaxhimit të likuiditetit, siç përcaktohet në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove.
- (13) **"Kosto e Shërbimit"** është kostoja e shërbimit për shpenzimet e përgjithshme administrative, siç përcaktohet në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove.
- (14) **"Vendim Zbatues i Komisionit"** është Vendimi Zbatues i Komisionit i datës 23 tetor 2024, sipas Nenit 15 të Rregullores (BE) 2024/1449 mbi miratimin e Axfordës së Reformës të paraqitur nga Huamarrësi.
- (15) **"Marrëveshje Kontributi"** është marrëveshja me shkrim e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxherëve të Fondit të FPEBP-së, e cila specifikon shumën e përdorur/zotuar nga Huamarrësi në FPEBP, valutën e këtij kontributi, mënyrën në të cilën do të bëhen pagesat e saj në Llogarinë e Fondit dhe mund të përmbajë çështje të tjera administrative që mund të kërkojnë dhe lejohen nga Kushtet e Përgjithshme, dhe do të vërtetohen në formën bashkëlidhur në Shtojcën A të Kushteve të Përgjithshme, sipas rastit. Marrëveshja e Kontributit shërben gjithashtu si respektim i Kushteve të Përgjithshme të FPEBP-së.
- (16) **"Disbursim"** është disbursim i një Kësti të Parafinancimit të Huasë, Kësti ose Transhi të Huasë për Huamarrësin në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje.
- (17) **"Datë Disbursimi"** është data, në lidhje me Disbursimin, e transferimit të Shumës Neto të Disbursimit në llogarinë e specifikuar në Nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje Huaje.
- (18) **"Datë e Kërkueshme"** është çdo ditë në të cilën një pagesë nga Huamarrësi për Huadhënësin është e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë çdo datë të treguar në Njoftimin e Konfirmimit në të cilën duhet të bëhet pagesa e shumës së principalit, Kostoja e Financimit, Kostoja e Shërbimit dhe Kostoja e Menaxhimit të Likuiditetit.
- (19) **"Strategjia e Diversifikuar e Financimit"** është strategjia e financimit të Komisionit, e specifikuar në Nenin 224 të Rregullores Financiare dhe e rregulluar nga rregullat e Vendimit Zbatues të Komisionit 2023/2825.
- (20) **"Rimbursim i Parakohshëm"** është çdo shlyerje e parakohshme vullnetare, tërësisht ose pjesërisht, e Lehtësisë së Huasë, me nismën e Huamarrësit.
- (21) **"Shlyerje e Parakohshme"** është shlyerja e parakohshme e Lehtësisë së Huasë, e kërkuar nga Huadhënësi.
- (22) **"BERZH"** është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.



- (23) "BEI" është Banka Evropiane e Investimeve.
- (24) "Rast Mospërbushjeje të Detyrimeve" është një rast i përcaktuar në Nenin 13 (1) të kësaj Marrëveshje Huaje.
- (25) "BQE" është Banka Qendrore Evropiane.
- (26) "BE" është Bashkimi Evropian.
- (27) "Detyrim i Jashtëm" është i gjithë borxhi i Huamarrësit (i) i shprehur ose i pagueshëm në një valutë të ndryshme nga valuta e ligjshme e Huamarrësit dhe (ii) që nuk është krijuar ose marrë përsipër fillimisht në bazë të një marrëveshjeje ose instrumenti të bërë me ose ofruar kreditorëve kryesisht, ku të gjithë janë rezidentë të Huamarrësit ose subjekte që kanë selinë e tyre ose vendin kryesor të biznesit në territorin e Huamarrësit.
- (28) "FPEBP" është Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, i krijuar në bazë të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor për marrjen e kontributeve të donatorëve, në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të FPEBP-së të miratuara së fundi me Vendimin e Komisionit C (2023)4806, të datës 19 korrik 2023<sup>6</sup>.
- (29) "Lehtësi" është Lehtësia e Reformës dhe Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor, e krijuar me Rregulloren (BE) 2024/1449.
- (30) "Rregullore Financiare" është Rregullorja (BE, Euratom) 2024/2509 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 shtator 2024, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian.
- (31) "Llogaria e Fondit" është llogaria bankare, e hapur dhe e mbajtur nga BERZH-i, në të cilën Huamarrësi do të transferojë kontributet në Fond dhe nga e cila BERZH-i do të disbursojë burimet e Fondit, sipas nevojës, në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të FPEBP-së<sup>7</sup>.
- (32) "Instrument Financimi" janë emetimet e obligacioneve, kartëvalutat, kambialet afatshkurtra ose çdo transaksion tjetër financiar i përshtatshëm afatshkurtër dhe/ose afatgjatë, i lançuar nga Komisioni në emër të Bashkimit Evropian sipas Strategjisë së Diversifikuar të Financimit për financimin e mbështetjes me hua të kërkuar nga Huamarrësi.
- (33) "Marrëveshje e Lehtësisë" është Marrëveshja e Lehtësisë e lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni dhe Huamarrësit, në përputhje me Nenin 9 të Rregullores (BE) 2024/1449.
- (34) "Mashttrim" është mashtrimi sipas kuptimit të Nenit 3 të Direktivës (BE) 2017/1371 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane, të hartuar me Aktin e Këshillit të 26 korrikut 1995.

<sup>6</sup>Vendimi i Komisionit C (2023)4806 që ndryshon Vendimin e Komisionit C (2016)3610 përfundimtar në lidhje me miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor, 19.7.2023.



- (35) “Menaxherët e Fondeve” janë, në kontekstin e FPEBP-së, BERZH-i dhe BEI.
- (36) “Kushtet e Përgjithshme të FPEBP-së” është grupi i dispozitave që rregullojnë administrimin e FPEBP-së, vendosjen e roleve dhe përgjegjësi, përbërjen, metodat e punës dhe sistemet e vendimmarrjes të FPEBP-së, siç u miratuan fillimisht më 7 nëntor 2006 dhe më pas u ndryshuan më 2 tetor 2009, 16 qershor 2016 dhe 6 shtator 2023, dhe që mund të ndryshohen më tej, sipas nevojës, nga subjektet e saj qeverisëse.
- (37) “FMN” është Fondi Monetar Ndërkombëtar.
- (38) “Angazhimi i FMN-së” është çdo marrëveshje, program, lehtësi ose angazhim tjetër financiar ndërmjet Huamarrësit dhe FMN-së.
- (39) “Datë e Pagesës së Interesit” është çdo datë në të cilën interesi është i pagueshëm në bazë të Marrëveshjes së Huasë.
- (40) “Periudhë Interesi” është periudha e interesit, siç përcaktohet në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove.
- (41) “Opinion Ligjor” është opinionimi ligjor i dhënë nga Ministria e Drejtësisë e Huamarrësit në formën e specifikuar në Shtojcën 3.
- (42) “Huadhënës” është Bashkimi Evropian.
- (43) “Marrëveshje e Huasë” është kjo marrëveshje huaje.
- (44) “Këst i Huasë” janë shumat që kanë qenë objekt i një Kërkese për Pagesë.
- (45) “Lehtësi e Huasë” është mbështetja me hua që Komisioni vendos në dispozicion të Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe në përputhje me Vendimin Zbatues të Komisionit.
- (46) “Rast i Mosfunksionimit të Tregut” është, në kohën e një emetimi të propozuar të Instrumenteve të Financimit, ndodhia e ngjarjeve/rasteve ose rrethanave që ndikojnë në kushtet kombëtare ose ndërkombëtare financiare, politike ose ekonomike ose tregjet ndërkombëtare të kapitalit ose kursin e këmbimit valutor ose kontrollet e këmbimit, të cilat sipas opinionit të arsyeshëm të Huadhënësit, mund të cenojnë materialisht aftësinë e Huadhënësit për të realizuar një emetim, ofertë ose shpërndarje të suksesshme të Instrumenteve të Financimit me një çmim të arsyeshëm.
- (47) “Datë Maturimi” është data e planifikuar për shlyerjen e plotë të principalit të Këstit ose Transhit të Huasë, siç përcaktohet në një Njoftim Konfirmimi.
- (48) “Shumë Neto Disbursimi” janë të ardhurat e Instrumentit të Financimit minus shumën totale të shlyerjes së parafinancimit sipas Nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje Huaje në lidhje me çdo Disbursim, që rezulton në një shumë që duhet t’i disbursohet Huamarrësit.
- (49) “Këst Parafinancimi i Huasë” është pjesa e Lehtësisë së Huasë që do të disbursohet si



parafinancim që specifikohet në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

- (50) “Axfordë e Reformës” është Axforda e Reformës për Huamarrësin ose ndryshimi i saj i vlerësuar nga Komisioni dhe i miratuar nëpërmjet miratimit të Vendimit Zbatues të Komisionit.
- (51) **Kërkesë për pagesë**” është kërkesa e Huamarrësit për pagesën e Kësteve të Huasë në formën e Shtojcës 1 (a) ose Shtojcës 1 (b).
- (52) “**TARGET 2**” është Sistemi Automatik Transevropian i Transfertave Ekspres në Kohë Reale të Shlyerjeve Bruto i cili përdor një platformë të vetme të përbashkët dhe që u lançua më 19 nëntor 2007.
- (53) “**Taksë**” është çdo taksë, tarifë, detyrim, tatim ose detyrim tjetër ose mbajtje në burim të një natyre të ngjashme (përfshirë çdo penalitet ose interes të pagueshëm në lidhje me çdo mospërbushje për të paguar ose vonesë në pagimin e ndonjë prej tyre).
- (54) “**Transh**” është një pjesë e Këstit të Parafinancimit të Huasë ose e një Kësti Huaje.
- (55) “**KIBP**” është Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP), një nismë e përbashkët e BE-së, institucioneve financiare, donatorëve dypalësh dhe përfituesve, e cila synon të rrisë harmonizimin dhe bashkëpunimin në investime për zhvillimin socio-ekonomik të rajonit dhe të kontribuojë në perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor, siç përmendet në Nenin 12 të Rregullores (BE) 2021/1529<sup>7</sup>.

## Neni 2 OBJEKTI I MARRËVESHJES

- (1) Kjo Marrëveshje Huaje specifikon të drejtat dhe detyrimet e Palëve dhe termat dhe kushtet e zbatueshme për mbështetjen me hua të ofruar me synim përmbushjen e pranueshme nga Huamarrësi të kushteve të pagesës të specifikuar në Axfordën e Reformës të miratuar nga Vendimi Zbatues i Komisionit dhe përmbushjen e parakushteve dhe kushteve të përgjithshme të specifikuar përkatësisht në Nenet 5 dhe 12 të Rregullores (BE) 2024/1449.
- (2) Sipas dispozitave të Rregullores (BE) 2024/1449, Vendimit Zbatues të Komisionit, Metodologjisë së Shpërndarjes të Kostove, Marrëveshjes së Lehtësisë dhe kësaj Marrëveshjeje Huaje, Bashkimi Evropian i vendos në dispozicion Huamarrësit një Lehtësi Huaje në Euro në shumën totale të principalit maksimumi 657,458,743.67 Euro.
- (3) Lehtësia e Huasë do të vihet në dispozicion në Këste të Huasë. Këstet e Huasë do të disbursohen në një ose më shumë Transhe, sipas zgjedhjes së Huadhënësit.
- (4) Huamarrësi do të përdorë të gjitha shumat që ai ka marrë hua në bazë të Lehtësisë të Huasë në përputhje me detyrimet e tij sipas Axfordës së Reformës, Marrëveshjes së Lehtësisë dhe

<sup>7</sup> Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 shtator 2021, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) (GZ L 330, 20.9.2021, f. 1.



kësaj Marrëveshje Huaje.

- (5) Banka Kombëtare e Huamarrësit do të veprojë si agjenti financiar i Huamarrësit dhe nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë detyrim financiar të Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje.
- (6) Huaja do të shprehet vetëm në Euro, e cila është valuta e llogarisë dhe e pagesës. Periudha e Disponueshmërisë së mbështetjes me hua do të jetë nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2027.

### Neni 3 MATURIMI

- (1) Çdo Disbursim do të ketë një kohëzgjatje maksimumi 40 vjet nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje.
- (2) Shlyerja e shumës së principalit të një Disbursimi do të fillojë nga viti 2034 dhe do të shpërndahet në mënyrë të barabartë në pagesa të barabarta gjatë maturimit të mbetur të Disbursimit.

### Neni 4 PËRGJEGJËSIA E HUAMARRËSIT

- (1) Huamarrësi do të jetë përgjegjës për përmbushjen e kushteve të pagesës të lidhur me hapat cilësorë dhe sasiorë të specifikuar në Axhendën e Reformës, të miratuar në Vendimin Zbatues të Komisionit dhe për përmbushjen e pranueshme të parakushteve dhe kushteve të përgjithshme të specifikuara përkatësisht në Nenet 5 dhe 12 të Rregullores (BE) 2024/1449.
- (2) Përmbushja e pranueshme e kushteve të pagesës që rezultojnë nga Axhenda e Reformës e miratuar në Vendimin Zbatues të Komisionit presupozon që hapat që lidhen me të njëjtat reforma për të cilat Huamarrësi kishte arritur përmbushje të pranueshme në vendimet e mëparshme, nuk janë anuluar nga Huamarrësi.

### Neni 5 DETYRIMET E HUAMARRËSIT NË LIDHJE ME ZBATIMIN E NJË PJESE TË MBËSHTETJES ME HUA NËPËRMJET KIBP-së

- (1) Huamarrësi do t'i transferojë FPEBP-së përqindjen e shpërndarë.
- (2) Detyrimi i Huamarrësit sipas këtij Neni do të zyrtarizohet nëpërmjet Marrëveshjeve të Kontributit, në përputhje me Nenin 19(2) të Marrëveshjes së Lehtësisë.
- (3) Huamarrësi do të përfundojë Marrëveshjet e tilla të Kontributit brenda tre muajve nga miratimi i vendimit të lirimimit të Komisionit të përmendur në Nenin 8(1) të kësaj Marrëveshjeje.
- (4) Huamarrësi do t'i japë Komisionit kopje të marrëveshjeve të kontributit, si dhe të çdo ndryshimi të mëvonshëm të tyre, në përputhje me Marrëveshjen e Lehtësisë.



- (5) Huamarrësi do t'i japë Komisionit dëshmitë e kryerjes së pagesës sipas ndonjë marrëveshje kontributi.

#### Neni 6 PARAFINANCIMI

- (1) Huadhënësi do të disbursojë një shumë prej 46,022,112.06 Euro të parafinancimit, në një ose më shumë Transhe.
- (2) Pjesa e parafinancimit në lidhje me Përqindjen e Shpërndarë, që do t'i vihet në dispozicion KIBP-së dhe në shumën 15,992,683.94 EURO do të jetë sipas dispozitës të Nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.
- (3) Huamarrësi pranon dhe bie dakord në mënyrë të përvokueshme se:
- Disbursimi i Këstit të Parafinancimit të Huasë do t'i nënshtrohet disponueshmërisë së fondeve dhe, për pjesën e përqindjes së shpërndarë, në lidhje me parafinancimin të referuar në paragrafin 2 të këtij Neni, marrjes së një kopjeje të nënshkuar të Marrëveshjes së Kontributit, që mbulon të gjithë pjesën e Përqindjes së Shpërndarë në lidhje me parafinancimin;
  - Kostoja e Financimit, Kostoja e Menaxhimit të Likuiditetit dhe Kostoja e Shërbimit për Këstin e Parafinancimit të Huasë bazohen në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove;
  - Datat e Maturimit të Këstit të Parafinancimit të Huasë do të jenë deri në 40 vjet;
  - Kësti i Parafinancimit të Huasë do të disbursohet në një ose disa Transhe;
  - Do të paguajë çdo tarifë, kosto dhe shpenzime, duke përfshirë nëse është e zbatueshme kostot e ndërprerjes dhe koston e mbajtjes;
  - Do të mbulojë kostot e zbatimit dhe çdo tarifë të kërkueshme në lidhje me zbatimin e FPEBP-së, në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të FPEBP-së.
- (4) Huadhënësi do t'i japë Huamarrësit një Njoftim Konfirmimi që përcakton kushtet financiare të Këstit ose Transhit të Parafinancimit të Huasë. Huamarrësi do të konsiderohet se ka pranuar paraprakisht kushtet e Këstit ose Transhit të Parakohshëm të Huasë, të specifikuar në Njoftimin e Konfirmimit.
- (5) Për parafinancimin të paguar në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, një shumë që korrespondon me përqindjen e barabartë me raportin e parafinancimit të mbetur të pashlyer mbi shumën e mbetura të Lehtësisë së Huasë që do të disbursohet, do të zbritet nga çdo Disbursim për të llogaritur Shumën Neto të Disbursimit, në mënyrë që të shlyhet parafinancimi derisa të jetë shlyer plotësisht.
- (6) Me kërkesë të Huamarrësit në kërkesën e tij për pagesë, shumën shtesë mund të zbritet nga çdo Disbursim, në mënyrë që parafinancimi të shlyhet më herët.
- (7) Shumat e parafinancimit që nuk janë shlyer deri më 31 dhjetor 2027 ose, nëse më herët, datën në të cilën është kryer Disbursimi i fundit, do të jenë menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme. Komisioni ka të drejtë të kompensojë këto shuma kundrejt çdo pretendimi që Huamarrësi ka ndaj Huadhënësit.



- (8) Çdo parafinancim do të deklarohet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm pas reduktimit të mbështetjes me hua ose kërkesës për Shlyerje të Parakohshme në rastet e përmendura në Nenin 21 (5) dhe Nenin 21 (7) të Rregullores (BE) 2024/1449. Zbatohet Neni 13(3) i kësaj Marrëveshjeje Huaje.

#### Neni 7 KËRKESA PËR PAGESA DHE VERIFIKIMI I KUSHTEVE

- (1) Së bashku me çdo kërkesë për lëvrim të fondeve në bazë të Marrëveshjes së Lehtësisë, Huamarrësi do të paraqesë dy kërkesa për pagesë, duke përdorur formën e specifikuar në Shtojcën 1(a) dhe Shtojcën 1(b) të kësaj Marrëveshjeje Huaje, dhe konkretisht:
- një kërkesë për pagesë për një këst huaje që mbulon pjesën e huasë që korrespondon me përqindjen e shpërndarë të specifikuar në kërkesën për lirim të fondeve (Shtojca 1(a)); dhe
  - një kërkesë për pagesë për një këst huaje që mbulon pjesën e mbetur të huasë të specifikuar në të njëjtën kërkesë për lirim të fondeve (Shtojca 1 (b)).
- (2) Huamarrësi do të japë dokumentacionin e duhur për të justifikuar kërkesat për pagesë të paraqitura në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, për çdo hap të vetëm dhe sipas burimeve të verifikimit të përcaktuara në Shtojcën I të Axhendës së Reformës dhe në përputhje me Marrëveshjen e Lehtësisë:
- (3) Huamarrësi do të kërkojë, duke bërë përpjekjet më të mira, të zbatojë skedulim tregues të kërkesës për pagesë të specifikuar në Vendimin Zbatues të Komisionit. Kërkesa përfundimtare për pagesë do të dorëzohet deri më 30 shtator 2027.
- (4) Vlerësimi sipas Nenit 21(2) të Rregullores (BE) 2024/1449 do të kryhet nga Huadhënësi në bazë të informacionit të dhënë nga Huamarrësi në përputhje me paragrafin 3. Huadhënësi mund të kërkojë informacion shtesë dhe/ose të kryejë kontrolle dhe kontrolle në vend për të verifikuar përfundimin e hapave cilësorë dhe sasiorë, duke përfshirë moskthimin e hapave të mëparshme cilësore dhe sasiorë të përmbushura në mënyrë të kënaqshme.

#### Neni 8 TËRHEQJA, KUSHTET PARARENDËSE DHE DISBURSIMI

- (1) Pa cenuar Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje Huaje, çdo disbursim i një Kësti Huaje do të kushtëzohet me marrjen e vendimit për lëvrim nga Komisioni sipas Nenit 21(3) të Rregullores (BE) 2024/1449 dhe do të jetë i kufizuar në shumën e përcaktuar në atë vendim.
- (2) Asnjë disbursim nuk do të bëhet më përpara se:
- Marrëveshja e Lehtësisë të ketë hyrë në fuqi dhe;
  - Huadhënësi të ketë marrë nga Huamarrësi njoftimin zyrtar në formën e Opinionit Ligjor,



që të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore për dispozitat në lidhje me huatë që do të zbatohen dhe angazhimi i vlefshëm dhe i përvokueshëm i Huamarrësit për të gjitha detyrimet në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, janë përmbushur, dhe

(c) Huadhënësi të ketë marrë një Kërkesë për Pagesë.

Huamarrësi është i lidhur ligjërisht në mënyrë të përvokueshme, me kushtet e Kërkesës për Pagesë.

Pika c) e nënparagrafit të parë nuk do të zbatohet për këstin e parafinancimit të huasë.

- (3) Kërkesa për pagesë nuk konsiderohet e plotësuar siç duhet, nëse nuk specifikon informacionin e përcaktuar në Shtojcën 1.
- (4) Pas paraqitjes së një Kërkesë për Pagesë nga Huamarrësi, detyrimi i Huadhënësit për t'i paguar Huamarrësit Shumën Neto të Disbursimit në lidhje me një Këst të Huasë sipas kësaj Marrëveshjeje të Huasë, do të jetë duke pasur parasysh se:
- a. nuk ka ndodhur asnjë rast që do të bënte të pasaktë ndonjë deklaratë të dhënë në Opinionin Ligjor;
  - b. Huadhënësi ka marrë nga Ministri i Financave i Huamarrësit një dokument zyrtar që tregon personat e autorizuar që të nënshkruajnë Kërkesën për Pagesë (dhe në këtë mënyrë angazhon në mënyrë të vlefshme Huamarrësin) dhe që përmban nënshkrimet model të këtyre personave;
  - c. disponueshmërinë e financimit;
  - d. nuk ka ndodhur asnjë Rast i Mosfunksionimit të Tregut;
  - e. nuk ka ndodhur asnjë ndryshim material negativ që nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje që, sipas opinionit të Huadhënësit, pas konsultimit me Huamarrësin, mund të cenojë materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje, specifikisht të përdorë ndonjë nga Këstet e Huasë që do të financohen dhe t'i shlyejë ato;
  - f. Nuk ka ndodhur asnjë rast mospërmbushjeje që nuk është rregulluar sipas pritshmërisë të Huadhënësit;
  - g. kur Kërkesa për Pagesë mbulon Përqindjen e Shpërndarë, Huadhënësi të ketë marrë nga Huamarrësi një kopje të një marrëveshjeje kontributi të nënshkruar që mbulon të njëjtën shumë të asaj kërkesë për pagesë.
- (5) Kësti i huasë mund të disbursohet në një ose më shumë Transhe.
- (6) Në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/1449 dhe Vendimin Zbatues të Komisionit, Huadhënësi do të lançojë çdo instrument financimi të përshtatshëm për financimin e shumës së Këstit të Huasë sipas Strategjisë së Diversifikuar të Financimit.



- (7) Huadhënësi do t'i japë Huamarrësit një Njoftim Konfirmimi që specifikon kushtet financiare të Disbursimit. Huamarrësi do të konsiderohet se ka pranuar paraprakisht kushtet e Këstit ose Transhit të Huasë të specifikuara në Njoftimin e Konfirmimit. Për shmangien e ndonjë dyshimi, Huadhënësi nuk është i detyruar të shqyrtojë në mënyrë të favorshme ndonjë kërkesë nga Huamarrësi në çdo kohë për të ndryshuar ndonjë nga kushtet financiare të një Kësti ose Transhi të Huasë.
- (8) Komisioni do të udhëzojë BQE-në që të transferojë Shumën Neto të Disbursimit të një Kësti ose Transhi të Huasë në Datën e Disbursimit në llogarinë e mëposhtme të Huamarrësit në Euro në *Banque de France*, BIC: BDFEFR2T, IBAN FR7630001000640000005394792, mbajtësi i llogarisë: (Banka e Shqipërisë) për përfituesin *Depozita e Qeverisë në EURO (Ministria e Financës e Shqipërisë)* BIC STANALTRXXX, IBAN AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E.

Një pagesë në këtë llogari bankare do të çlirojë Huadhënësin nga detyrimi i tij për pagesë në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje në lidhje me Disbursimin përkatës.

- (9) E drejta e Huamarrësit për të marrë Këste ose Transhe Huaje në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, skadon në fund të Periudhës së Disponueshmërisë, pas të cilës çdo shumë e padisbursuar e Lehtësisë të Huasë do të konsiderohet si e anuluar menjëherë, me përjashtim të ndonjë transhi të Këstit të Huasë për të cilin Komisioni ka miratuar një vendim lëvrimi përpara asaj date.

## Neni 9 PËRFAQËSIMET, GARANCITË DHE SIPËRMARRJET

- (1) Përfaqësimet

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi përfaqëson dhe i garanton Huadhënësit se në datën e kësaj Marrëveshjeje të Huasë dhe në çdo Datë Disbursimi:

- (a) çdo Këst i Huasë ose çdo Transh i saj do të përbëjë një detyrim të pasiguar, të drejtpërdrejtë, të pakushtëzuar, të pavarur dhe të përgjithshëm të Huamarrësit dhe do të renditet të paktën *pari passu* me të gjitha huatë dhe detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit që rezultojnë nga Borxhi i tij i Jashtëm i tashëm ose i ardhshëm, me kusht që, megjithatë Huamarrësi nuk do të ketë asnjë detyrim të kryejë pagesë (a) të barabartë ose të llogaritshme në çdo kohë në lidhje me ndonjë Borxh tjetër të Jashtëm të tillë dhe, në veçanti, nuk do të ketë asnjë detyrim që të paguajë Borxhe të tjera të Jashtme në të njëjtën kohë ose si kusht për pagimin e shumave të kërkueshme mbi Lehtësinë e Huasë dhe anasjelltas; dhe
- (b) Opinioni Ligjor i dhënë në përputhje me Shtojcën 3 është i saktë dhe i duhur.

- (2) Sipërmarrjet

Huamarrësi merr përsipër, deri në momentin kur i gjithë principlali sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje është rimbursuar plotësisht dhe të gjitha interesat dhe shumat shtesë, nëse ka, të



kërkueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, janë paguar plotësisht:

- (a) që të përdorë Shumën Neto të Disbursimit të çdo Disbursimi në pajtim me Rregulloren (BE) 2024/1449, në përputhje me Axhendën e Reformës, Marrëveshjen e Lehtësisë dhe çdo kusht përkatës të zbatueshëm në kohën e dhënies të Kërkesës për Pagesë;
- (b) të marrë dhe të mbajë në fuqi të plotë dhe të zbatojë të gjitha autorizimet e nevojshme që ai të përmbushë detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje;
- (c) të pajtohet në të gjitha aspektet me ligjet në fuqi që mund të ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur këtë Marrëveshje Huaje;
- (d) të paguajë çdo tarifë, kosto, shpenzimet e drejtpërdrejta dhe shpenzimet operative, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, kostot e ndërprerjes dhe koston e menaxhimit të likuiditetit, të llogaritura sipas Metodologjisë së Shpërndarjes të Kostove;
- (e) në lidhje me borxhin e jashtëm, të pranojë se Huadhënësi do të ketë të njëjtën zotësi juridike, imunitete dhe privilegje që u jepen institucioneve financiare ndërkombëtare;
- (f) të garantojë që kontrollet dhe masat e përmendura në Nenin 15 të kësaj Marrëveshjeje Huaje, të jenë funksionale;
- (g) me përjashtim të barrëve hipotekore të renditura në nënparagrafët (1) deri (7) më poshtë:
  - (i) të mos sigurojë me hipotekë, peng ose ndonjë barrë tjetër mbi asetet ose të ardhurat e veta, asnjë borxh të jashtëm aktual ose të ardhshëm dhe ndonjë garanci ose dëmshpërblim të dhënë në lidhje me to, përveç rasteve kur Lehtësia e Huasë ndan në të njëjtën kohë *pari passu* dhe *pro rata* në një garanci të tillë; dhe
  - (ii) të mos i japë asnjë kreditori ose mbajtësi tjetër të borxhit të tij sovran, ndonjë përparësi ndaj Huadhënësit.

Dhënia e barrëve të mëposhtme hipotekore nuk përbën shkelje të këtij Neni 9:

- (1) barra hipotekore mbi ndonjë pronë, e vendosur për të siguruar financim për çmimin e blerjes ose ndërtimin e kësaj prone dhe çdo rinovim ose zgjatje e ndonjë barre të tillë e cila është e kufizuar për pronën fillestare të mbuluar prej saj dhe që siguron çdo rinovim ose zgjatje të financimit fillestar të siguruar; dhe
- (2) barra hipotekore mbi mallrat tregtare që lindin gjatë transaksioneve të zakonshme tregtare (dhe që skadojnë maksimumi brenda një viti më pas) për të financuar importin ose eksportin e këtyre mallrave në ose nga vendi i Huamarrësit; dhe
- (3) barra hipotekore që sigurojnë kryerjen e pagesës ose parashikojnë pagesën e



borxhit të jashtëm të krijuar ekskluzivisht për të siguruar financim për një projekt specifik investimi, me kusht që pronat për të cilat zbatohen këto barra hipotekore, të jenë prona që janë objekt i këtij financimi projekti, ose që janë të ardhura ose pretendime që rezultojnë nga projekti; dhe

- (4) çdo barrë tjetër ekzistuese hipotekore në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje, me kusht që këto barra hipotekore mbeten të mbyllura për pronat e cenuara aktualisht prej tyre dhe pronat që cenohen nga këto barra hipotekore sipas kontratave në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje (duke përfshirë, për shmangien e ndonjë dyshimi, kristalizimin e çdo tarife luhatëse që ishte lidhur në datën e kësaj Marrëveshjeje Huaje), dhe më tej me kusht që këto barra hipotekore të sigurojnë ose të parashikojnë pagesën e vetëm atyre detyrimeve të siguruar në këtë mënyrë ose të parashikuara në datën e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë rifinancim të këtyre detyrimeve; dhe
- (5) të gjitha barrët hipotekore dhe privilegjet e tjera statutore që funksionojnë vetëm në bazë të ligjit dhe që nuk mund të shmangen në mënyrë të arsyeshme nga Huamarrësi; dhe
- (6) çdo barrë hipotekore që siguron pagesën e detyrimeve të Huamarrësit pranë çdo depozituesi qendror të letrave me vlerë siç është *Euroclear*, të dhëna në ecurinë normale të biznesit; dhe
- (7) çdo barrë hipotekore që garanton mbetjen e një borxhi më pak se 3 milionë EURO, me kusht që shuma maksimale totale e borxhit të garantuar nga kjo barrë nuk tejkalon shumën 50 milionë EURO.

Siç përdoret në këtë Nen 9 "financimi për një projekt investimi specifik" është çdo financim i blerjes, ndërtimit ose zhvillimit të ndonjë prone në lidhje me një projekt, nëse subjekti që ofron këtë financim pranon shprehimisht të kërkojë për pronat e financuara dhe të ardhurat që do të krijohen nga funksionimi ose humbja ose dëmtimi i pronave të tilla si burimi kryesor i shlyerjes për paratë e dhëna parapagim.

#### Neni 10 KOSTOT DHE SHPENZIMET

- (1) Në lidhje me çdo Këst të papaguar të Huasë, Huamarrësi do të transferojë në llogarinë e përmendur në Nenin 12(3) të kësaj Marrëveshjeje Huaje në lidhje me çdo Këst ose Transh të Huasë
  - (a) në çdo Datë të Kërkueshme, shumën e Kostos së Financimit;
  - (b) në çdo Datë të Kërkueshme, shumën e Kostos së Shërbimit;
  - (c) në çdo Datë të Kërkueshme, shumën e Kostos së Menaxhimit të Likuiditetit.



- (2) Periudha e Interesit dhe Datat e Kërkueshme do të vendosen, për çdo Këst ose Transh të Huasë, në Njoftimin e Konfirmimit për atë Këst ose Transh të Huasë dhe do t'i komunikohen Huamarrësit.

Huadhënësi do t'i komunikojë Huamarrësit shumën e Kostos së Financimit, Kostos së Shërbimit dhe Kostos së Menaxhimit të Likuiditetit, sa më shpejt të jetë e mundur përpara Datës së Kërkueshme.

- (3) Kostot e shkaktuara nga Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshje Huaje dhe që i ngarkohen Huamarrësit, do të llogariten bazuar në një formulë të vendosjes së çmimit të përbërë nga Kostoja e Financimit, Kostoja e Shërbimit dhe Kostoja e Menaxhimit të Likuiditetit, të cilat do të llogariten dhe faturohen në bazë të Metodologjisë së zbatueshme të Shpërndarjes së Kostove.

- (4) Pa cenuar kushtet e Nenit 13 të kësaj Marrëveshjeje Huaje, nëse Huamarrësi nuk paguan ndonjë shumë të pagueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje në Datën e Kërkueshme të saj, Huamarrësi do të paguajë kamatëvonesë mbi këtë shumë (ose, sipas rastit, shumën e saj aktualisht të kërkueshme dhe të papaguar) për Huadhënësin nga Data e Kërkueshme deri në datën e pagesës aktuale të plotë, të llogaritur duke iu referuar periudhave vijuese të interesit (secila prej kohëzgjatjeve të tilla që Huadhënësi mund të zgjedhë herë pas here, ku periudha e parë fillon në Datën përkatëse të Kërkueshme dhe, kurdoherë që është e mundur, kohëzgjatja e kësaj periudhe do të jetë një javë) mbi një shumë të tillë që i ka kaluar afati, në vlerën më të lartë të:

- (a) një norme në vit që është totali i:
- (i) 350 pikëve bazë, dhe
  - (ii) normës së përdorur nga Banka Qendrore Evropiane për veprimet e saj kryesore të rifinancimit, ose
- (b) 200 pikë bazë mbi Koston e Financimit e cila do të kishte qenë e pagueshme, nëse shumata që i ka kaluar afati do të kishte qenë, gjatë periudhës së mospagesës, një Këst Huaje, ose
- (c) 0 pikëve bazë.

Për aq kohë sa vazhdon mospagesa, kjo normë do të rivendoset në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi (4) të këtij Neni 10 në ditën e fundit të secilës periudhë të tillë të interesi dhe interesi i papaguar sipas këtij Neni 10, për sa i përket periudhave të mëparshme të interesit, i shtohet shumës së interesit të kërkueshme në fund të çdo periudhe të tillë interesi. Kamatëvonesa është e kërkueshme dhe e pagueshme menjëherë.



- (5) Huamarrësi merr përsipër t'i paguajë Huadhënësit të gjitha interesat shtesë dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifatat ligjore, të shkaktuara dhe të pagueshme nga Huadhënësi si rezultat i një shkeljeje të ndonjë detyrimi në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje nga Huamarrësi. Për shmangien e dyshimit, një pagesë nga Huamarrësi në çdo datë të ndryshme nga Data e Kërkueshme, do të interpretohet si shkelje e detyrimeve për shlyerje në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

#### Neni 11 SHLYERJA, ZBRITJA, PEZULLIMI DHE ANULIMI

- (1) Huamarrësi do të paguajë shumën e principalit të çdo Disbursimi në Datën (at) e Kërkueshme dhe në bazë të kushteve që Huadhënësi i ka njoftuar atij në Njoftimin përkatës të Konfirmimit.

Huamarrësi do të transferojë shumën e principalit të kërkueshëm në llogarinë e përmendur në Nenin 12(3) të kësaj Marrëveshjeje Huaje, në Datën e Kërkueshme.

Shuma e principalit që transferohet për qëllime të një shlyerjeje në llogarinë e përmendur në Nenin 12(3) të kësaj Marrëveshjeje Huaje nga Huamarrësi, nuk mund të ri-merret hua nga Huamarrësi në bazë të Lehtësisë të Huasë.

- (2) Huadhënësi mund të pezullojë ose anulojë Këstin ose Transhet e patërhequra të Huasë, nëse:
- (a) Huamarrësi deklaron se synon të mos tërheqë më në bazë të Lehtësisë së Huasë; ose
  - (b) nevojat për financim të Huamarrësit reduktohen rrënjësisht në krahasim me parashikimet fillestare; ose
  - (c) Huamarrësi nuk zbaton kushtet e Axfordës së Reformës, Marrëveshjes së Lehtësisë, një Marrëveshjeje Kontributi dhe/ose Marrëveshjes së Huasë;
  - (d) vendimi i Komisionit për lëvrimitin, të përmendur në Nenin 8 (1) të kësaj Marrëveshjeje Huaje, për këstin e patërhequr të huasë, nuk miratohet brenda periudhës së disponueshmërisë
  - (e) Marrëveshja e Lehtësisë pezullohet ose ndërpritet.

#### Neni 12 PAGESAT

- (1) Të gjitha pagesat që do të bëhen nga Huamarrësi, do të paguhen pa kompensim ose kundërpretendim, pa detyrime monetare dhe pa zbritje për dhe për llogari të ndonjë takse, komisioni dhe tarife tjetër për të gjithë afatin e kësaj Marrëveshjeje Huaje.



(2) Huamarrësi deklaron se të gjitha pagesat dhe transfertat në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, si dhe vetë Marrëveshja e Huasë, nuk janë objekt i asnjë takse ose ndonjë tarife, detyrimi ose tatim tjetër në shtetin e Huamarrësit dhe nuk do të jenë objekt i tyre gjatë gjithë afatit të kësaj Marrëveshjeje Huaje. Megjithatë, nëse Huamarrësi ose Banka Kombëtare e Huamarrësit janë të detyruar me ligj që të bëjnë ndonjë zbritje të tillë, Huamarrësi do të paguajë shumat shtesë të kërkuara, në mënyrë që Huadhënësi të marrë plotësisht shumat e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje Huaje.

(3) Të gjitha pagesat nga Huamarrësi do të bëhen në Datën e Kërkueshme përpara orës 11:00 paradite, me orën e Luksemburgut, në llogarinë e Komisionit Evropian 4062990131 në BQE, nëpërmjet pjesëmarrësit TARGET2 SWIFT-BIC ECBFDEFFBAC, në favor të përfituesit përfundimtar EUCOLULLL XXX ose në ndonjë llogari tjetër që Huadhënësi mund të komunikojë me njoftim me shkrim përpara Datës përkatëse të Kërkueshme.

Pagesa e kryer në Datën e Kërkueshme në këtë llogari do të çlirojë Huamarrësin nga detyrimi përkatës i shlyerjes.

(4) Nëse Huamarrësi paguan një shumë në lidhje me secilin prej Këstit të Huasë ose Transhit të saj, e cila është më e vogël sesa shuma totale e kërkueshme dhe e pagueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë, për të bërë ndonjë ndarje të shumës të paguar në lidhje me shumat e kërkueshme.

Shuma e paguar në lidhje me Këstin e Huasë ose ndonjë Transhi të saj, do të përdoret në ose për shlyerjen e pagesave të kërkueshme sipas këtij Kësti të Huasë ose ndonjë Transhi të saj, sipas rendit të mëposhtëm:

- (a) *së pari* kundrejt çdo tarife, shpenzimi dhe dëmshpërblimi;
- (b) *së dyti* kundrejt çdo interesi për pagesat e vonuara, siç përcaktohet në Nenin 10(4) të kësaj Marrëveshjeje Huaje;
- (c) *së treti* kundrejt interesit; dhe
- (d) *së katërti* kundrejt principalit,

me kusht që këto shuma të jenë të kërkueshme ose që u ka kaluar afati për pagesë në atë datë.

(5) Çdo llogaritje dhe përcaktim nga Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje:

- (a) do të bëhet në një mënyrë të arsyeshme tregtare; dhe
- (b) në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të përbëjë detyrim për Huadhënësin dhe Huamarrësin.

(6) Do të zbatohet Metoda e Llogaritjes së Ditëve të Punës, siç është komunikuar në Njoftimin e Konfirmimit.



## Neni 13 RASTET E MOSPËRMBUSHJES

- (1) Huadhënësi mund të deklarojë, duke i dhënë njoftim me shkrim Huamarrësit, se shuma e papaguar e principalit të Lehtësisë së Huasë është e kërkueshme dhe e pagueshme, së bashku me interesin e llogaritur, dhe/ose anulohet çdo Këst ose Transh të patërhequr të Huasë, nëse:
- (a) Huamarrësi nuk paguan ose nuk mund të paguajë në Datën përkatëse të Kërkueshme ndonjë shumë të principalit ose Kostot e Financimit, ose Kostot e Shërbimit, ose Kostot e Menaxhimit të Likuiditetit, ose ndonjë shumë tjetër të kërkueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje në datat e tyre të kërkueshme, qoftë plotësisht ose pjesërisht, në mënyrën e rënë dakord në këtë Marrëveshje Huaje, në lidhje me çdo Këst ose Transh të Huasë; ose
  - (b) Huamarrësi nuk përmbush ose nuk mund të përmbushë ndonjë detyrim në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje përveç atij të përmendur në Nenin 13(1)(a) (duke përfshirë detyrimin e përcaktuar në Nenin 2(4) për të përdorur Lehtësinë e Huasë në përputhje me kushtet e Axfordës së Reformës, Marrëveshjes së Lehtësisë dhe kësaj Marrëveshjeje të Huasë), dhe një mospërmbushje e tillë do të vazhdojë për një periudhë prej një muaji pasi Huamarrësit t'i jetë dhënë njoftimi me shkrim nga Huadhënësi; ose
  - (c) Huadhënësi i dërgon Huamarrësit një deklaratë mospërmbushjeje në rrethanat kur detyrimet e Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje deklarohen nga një gjykatë e juridiksionit kompetent se nuk përbëjnë detyrim për ose të zbatueshme ndaj Huamarrësit ose janë deklaruar nga një gjykatë e juridiksionit kompetent si të paligjshme; ose
  - (d) Huadhënësi i dërgon Huamarrësit një deklaratë mospërmbushjeje në rrethanat kur (i) është vërtetuar se në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, ose Marrëveshjen e Lehtësisë, Huamarrësi është përfshirë në ndonjë akt mashtrimi ose korrupsioni, ose në ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm të dëmshëm për interesat financiare të Huadhënësit ose (ii) çdo përfaqësim ose garanci e bërë nga Huamarrësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje ose Marrëveshjes së Lehtësisë është e pasaktë, e pavërtetë ose çorientuese dhe që sipas opinionit të Huadhënësit, mund të ketë ndikim negativ në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje ose mbi të drejtat e Huadhënësit sipas saj; ose
  - (e) çdo marrëveshje huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit ose ndonjë institucioni apo organi të BE-së, pavarësisht nga shuma, është objekt i një deklaratë mospërmbushjeje ose ka mospërmbushje të ndonjë detyrimi për pagesë të çfarëdo lloji ndaj Huadhënësit ose ndonjë institucioni ose organi të BE-së nga Huamarrësi që shkakton një deklaratë mospërmbushjeje; ose
  - (f) Huamarrësi nuk është në pajtim me Axfordën e Reformës të miratuar nga Vendimi Zbatues i Komisionit, dhe/ose Marrëveshja e Lehtësisë dhe/ose një marrëveshje kontributi, dhe/ose nëse Marrëveshja e Lehtësisë është ndërprerë.



- (g) anulohet një projekt investimi i përzgjedhur i përmendur në një Marrëveshje Kontributi, ose Përfituesi nuk mund të sigurojë dëshminë e kryerjes së pagesës për FPEBP-në.
  - (h) Huamarrësi nuk paguan ose nuk mund të paguajë ndonjë shumë të kërkesës për garanci sipas ndonjë garancie me të cilën Huamarrësi i garanton Huadhënësit përmbushjen e detyrimeve të pagesës të një pale tjetër ndaj Huadhënësit; ose
  - (i) Borxhi i jashtëm i Huamarrësit që ka një shumë totale të principalit më të madhe se 50 milionë EURO, është objekt i një deklarate mospërmbushjeje që përcaktohet në ndonjë instrument që rregullon ose evidenton një borxh të tillë dhe si rezultat i një deklarate të tillë të mospërmbushjes, ka një përshpejtim të një borxhi të tillë ose një shtyrje afati *de facto* mbi pagesat; ose
  - (j) Huamarrësi nuk kryen riblerje në kohë nga FMN-ja në lidhje me Marrëveshjen e FMN-së dhe është objekt i një deklarate mospërmbushjeje; ose
  - (k) Huamarrësi nuk paguan një pjesë të konsiderueshme të Borxhit të tij të Jashtëm në kohën kur është e kërkueshme ose deklararon ose vendos një shtyrje afati mbi pagesën e Borxhit të tij të Jashtëm ose të Borxhit të Jashtëm të marrë ose të garantuar prej tij.
- (2) Huadhënësi mund të ushtrojë, por nuk është i detyruar, të drejtat e tij sipas këtij Neni 13 dhe gjithashtu mund t'i ushtrojë vetëm pjesërisht, pa cenuar ushtrimin e ardhshëm të këtyre të drejtave. Asnjë heqje dorë nuk duhet të nënkuptohet nga ndonjë vonesë në ushtrimin e këtyre të drejtave.
- (3) Huamarrësi do të rimbursojë të gjitha kostot, shpenzimet dhe tarifatat e pagueshme nga Huadhënësi si pasojë e një Shlyerjeje të Parakohshme të ndonjë Kësti ose Transhi të Huasë sipas këtij Neni 13. Gjithashtu, Huamarrësi do të paguajë kamatëvonesën, siç parashikohet në Nenin 10(4) të kësaj Marrëveshjeje Huaje, e cila shtohet nga data kur shumata e principalit të papaguar të Lehtësisë të Huasë është deklaruar menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme, deri në datën e kryerjes së pagesës të plotë.

#### Neni 14 SIPËRMARRJET PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT

- (1) Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Huaje, Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit:
- (a) çdo informacion në lidhje me gjendjen e tij fiskale dhe ekonomike, siç Huadhënësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme;
  - (b) çdo informacion që lidhet me ndonjë rast që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të shkaktojë një rast mospërmbushjeje (dhe hapat, nëse ka, që po ndërmerren për ta korrigjuar atë rast), duke përfshirë çdo informacion relevant për vlerësimin e çdo akti



ose aktiviteti sipas Nenit 13 (1)(d)(i) të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

- (2) Huamarrësi merr përsipër të informojë Huadhënësin menjëherë nëse ndodh ndonjë rast që do ta bënte të pasaktë ndonjë deklaratë të bërë në Opinionin Ligjor, siç specifikohet në Shtojcën 3.
- (3) Me kërkesë të Komisionit, gjatë përgatitjes së raportit sipas Nenit 25 të Rregullores (BE) 2024/1449, Huamarrësi i paraqet Huadhënësit raporte mbi përdorimin e Lehtësisë të Huasë.
- (4) Huadhënësi ka të drejtë të ndalojë lëvrimin e ndonjë transhi të Këstit të Huasë në rast se Huamarrësi nuk ka dorëzuar Deklaratën e Garancisë sipas Shtojcës B të Marrëveshjes së Lehtësisë në lidhje me transhin e mëparshëm të Këstit të Huasë, dhe dokumentet e listuara në Nenet 14 (10) dhe 14(11) të Marrëveshjes së Lehtësisë.

#### **Neni 15        SIPËRMARRJET NË LIDHJE ME INSPEKTIMET, PARANDALIMIN E MASHTRIMIT DHE AUDITIMET**

- (1) Gjatë zbatimit të Lehtësisë të Huasë, Huadhënësi ka të drejtë të monitorojë qëndrueshmërinë e marrëveshjeve financiare të Huamarrësit, procedurat administrative dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm që kanë lidhje me ndihmën.
- (2) Në përputhje me Nenin 129(1) të Rregullores Financiare, Huadhënësi, duke përfshirë Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA) dhe, kur është e zbatueshme, Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO), do të ketë të drejtat dhe aksesin e nevojshëm për të ushtruar kompetencat e tyre përkatëse, duke përfshirë të drejtën për të dërguar agjentët e tyre ose përfaqësuesit e autorizuar, sipas rregullave, që të kryejnë çdo kontroll teknik ose financiar, hetime, përfshirë kontrollet dhe inspektimet në vend (duke përfshirë operacionet dhe intervistat dixhitale forensike) dhe auditimet (përfshirë auditimet e dokumenteve dhe kontrollet në vend) që ata i çmojnë të nevojshme në lidhje me menaxhimin e kësaj Lehtësie Huaje, për të mbrojtur interesat financiare të Huadhënësit.
- (3) Huamarrësi do të japë informacionin dhe dokumentet relevante që mund të kërkohen për qëllime të këtyre vlerësimeve, hetimeve, kontrolleve ose auditimeve dhe do të marrë të gjitha masat e duhura për të lehtësuar punën e personave që janë udhëzuar t'i përmbushin ato, duke përfshirë dhënie të drejtës personave të përmendur në paragrafin 2 të këtij Neni për të pasur akses në vendet dhe ambientet ku ruhen informacionet dhe dokumentet përkatëse.
- (4) Huamarrësi do të kontrollojë rregullisht nëse financimi i dhënë nga Huadhënësi është përdorur në mënyrën e duhur dhe do të garantojë hetimin dhe trajtimin e pranueshëm të çdo rasti të dyshuar dhe aktual mashtrimi, korrupsioni ose aktiviteti tjetër të paligjshëm në lidhje me menaxhimin e huasë, të dëmshme për interesat financiare të BE-së. Të gjitha këto raste, si dhe masat që lidhen me to, të marra nga autoritetet kompetente kombëtare, duke përfshirë veprimet ligjore për të rikuperuar çdo fond të dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, do t'i raportohen Huadhënësit pa vonesë.



- (5) Huamarrësi do të kontrollojë rregullisht nëse shumat e marra hua në bazë të Lehtësisë së Huasë, përdoren në përputhje me Axhendën e Reformës, Marrëveshjen e Lehtësisë dhe këtë Marrëveshje Huaje, dhe do të sigurojë që janë në funksion masat e duhura për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet. Në rast të përdorimit të parregullt ose të papërshtatshëm të shumave të marra hua në bazë të Lehtësisë së Huasë, Huamarrësi do të ndërmarrë veprime ligjore për t'i rikuperuar këto shuma.

#### **Neni 16 NJOFTIMET**

- (1) Të gjitha njoftimet, në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, do të jepen në mënyrë të vlefshme nëse janë me shkrim, përfshirë edhe me e-mail, dhe u dërgohen marrësve të përmendur në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje Huaje. Secila Palë do të përditësojë marrësit e njoftimeve dhe do të njoftojë Palën tjetër për këtë, për ndryshimin e të njëjtës, herë pas here.
- (2) Njoftimet hyjnë në fuqi në datën e marrjes së e-mailit ose letrës me të cilën janë dorëzuar njoftimet.
- (3) Të gjitha dokumentet, informacioni dhe materialet që do të jepen në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, do të jenë në gjuhën angleze.
- (4) Secila Palë në këtë Marrëveshje Huaje do të njoftojë palën tjetër, sipas rastit, për listën dhe nënshkrimet model të personave të autorizuar për të vepruar në emër të saj në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje. Gjithashtu, secila Palë do të përditësojë këtë listë dhe do të njoftojë Palën tjetër sipas rastit.

#### **Neni 17 TË NDRYSHME**

Huamarrësi nuk do të ketë asnjë të drejtë që të caktojë ose transferojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

#### **Neni 18 PËRGJEGJËSIA PËR DËMET**

Huadhënësi nuk mban përgjegjësi për ndonjë dëm të shkaktuar nga Huamarrësi ose ndonjë palë e tretë e përfshirë në zbatimin e Axhendës së Reformës, e cila lind nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Huaje.

#### **Neni 19 NDRYSHIMET**

- (1) Çdo ndryshim i rënë dakord nga Palët, do të bëhet me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje Huaje.



- (2) Me përjashtim të Nenit 19(1), ndryshimet në detajet e llogarisë të përfshira në Nenin 8(8) do t'i njoftohen me shkrim Huadhënësit nga Huamarrësi në adresat e specifikuar në Shtojcën 4 dhe do të përdoren për një disbursim pas konfirmimit me shkrim nga Huadhënësi.

#### Neni 20           LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI

- (1) Kjo Marrëveshje Huaje dhe çdo detyrim jashtëkontraktor që lind nga ose në lidhje me të, rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, i cili plotësohet kur është e nevojshme nga legjislacioni i Luksemburgut.
- (2) Palët angazhohen që të paraqesin çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me ligjshmërinë, vlefshmërinë, interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Huasë, në juridiksionin ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, në përputhje me Nenin 272 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian.
- (3) Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian do të jenë plotësisht të detyrueshme dhe të zbatueshme nga Palët.
- (4) Huadhënësi mund të zbatojë çdo vendim të marrë nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, ose të drejta të tjera ndaj Huamarrësit në gjykatat e Huamarrësit, në përputhje me procedurat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të gjykatave të huaja, siç specifikohet në legjislacionin e Huamarrësit.
- (5) Huamarrësi heq dorë në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar nga i gjithë imuniteti për të cilin ka ose mund të ketë të drejtë, në lidhje me veten ose asetet e tij, nga procedurat ligjore në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë, pa kufizim, imunitetin nga padia, vendimi, ose urdhër tjetër, nga konfiskimi, arrestimi ose masa për sigurimin e padisë, dhe nga ekzekutimi dhe përmbarimi ndaj aseteve të tij, në masën që nuk ndalohet nga ligji i detyrueshëm.
- (6) Huadhënësi pranon se Huamarrësi e konsideron këtë Marrëveshje Huaje si një "Traktat Ndërkombëtar" në kuptimin e Nenit 3 (dh) të Ligjit 43/2016 të Republikës së Shqipërisë "Për Marrëveshjet Ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë".

#### Neni 21           PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME DHE DIFERENCAT E PAQËLLIMSHME

- (1) Nëse një ose më shumë nga dispozitat e përfshira në këtë Marrëveshje Huaje duhet të jenë ose bëhen plotësisht ose pjesërisht të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme në çdo aspekt sipas ndonjë ligji në fuqi, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të përfshira në këtë Marrëveshje Huaje nuk do të ndikohet ose dëmtohet në asnjë mënyrë prej tyre. Dispozitat që janë plotësisht ose pjesërisht të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, do të interpretohen dhe zbatohen sipas frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje. Dispozitat e këtij Neni nuk cenojnë Nenin 13(1) (c) të kësaj Marrëveshjeje Huaje.
- (2) Preambula dhe Aneksat e kësaj Marrëveshjeje Huaje formojnë dhe në vijim do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

**Neni 22    HYRJA NË FUQI**

- (1) Pas nënshkrimit të saj nga të gjitha Palët dhe me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Lehtësisë, kjo Marrëveshje e Huasë do të hyjë në fuqi në datën kur Huadhënësi ka marrë njoftimin zyrtar në formën e Opinionit Ligjor të hartuar në përputhje me Shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje Huaje nga Huamarrësi, se të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të Huasë dhe angazhimi i vlefshëm dhe i përvokueshëm i Huamarrësit për të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje të Huasë janë përmbushur.
- (2) Hyrja në fuqi nuk do të jetë më vonë se 6 muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë. Nëse Marrëveshja e Huasë nuk ka hyrë në fuqi deri në atë datë, Palët e Marrëveshjes së Huasë nuk do të jenë më të detyruara ligjërisht ndaj saj.
- (3) Një kopje e nënshkruar ose e nënshkruar në mënyrë elektronike e kësaj Marrëveshjeje Huaje, e dërguar me email të sigurt, ose mjete të tjera të sigurta të transmetimit elektronik, do të konsiderohet se ka të njëjtin efekt juridik si dorëzimi i një kopjeje origjinale të ekzekutuar të kësaj Marrëveshjeje Huaje për të gjitha qëllimet.

**Neni 23    EKZEKUTIMI I MARRËVESHJES**

Kjo Marrëveshje Huaje do të ekzekutohet në gjuhën angleze nga secila Palë në aq kopje origjinale sa është edhe numri i Palëve, secila prej të cilave do të përbëjë një instrument/dokument origjinal.

Kjo Marrëveshje Huaje mund të nënshkruhet në çdo numër kopjesh. Çdo kopje do të konsiderohet origjinale.

Kjo Marrëveshje Huaje mund të nënshkruhet me një nënshkrim elektronik të përshtatshëm sipas kuptimit të Rregullores (BE) Nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 23 korrik 2014 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm dhe që shfuqizon Direktivën 1999/93/KE.<sup>8</sup>

**Neni 24    SHTOJCAT**

Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje Huaje do të përbëjnë pjesë integrale të saj:

1. Formulari i Kërkesës për Pagesë
2. Formulari i Njoftimit të Konfirmimit
3. Formulari i Opinionit Ligjor
4. Lista e kontakteve

<sup>8</sup> GZ L 257, 28.8.2014, f. 73



PËR BASHKIMIN EVROPIAN  
si Huadhënës

Bërë në Bruksel më \_\_\_\_\_

Komisioner

Nënshkrimi:

\_\_\_\_\_

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
si Huamarrës

Bërë në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_

Petrit Malaj  
Ministër i Financave i Republikës së  
Shqipërisë

Nënshkrimi:

\_\_\_\_\_

PËR BANKËN E SHQIPËRISË  
si Agjent i Huamarrësit

Gent Sejko  
Guvernator

Nënshkrimi:

\_\_\_\_\_



## SHTOJCA 1

## FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË

[në letrën me kokë të Huamarrësit]

[data]

Komisioni Evropian  
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit  
Njësia E-3: Operacionet e Huamarrjes dhe Huadhënies  
Në vëmendje të: Drejtuesit të Njesisë  
L-2920 Luxembourg

**Lënda: Lehtësia e Reformës dhe Zgjerimit të Bashkimit Evropian për Ballkanin  
Perëndimor  
Kërkesë për Pagesë për Këstin e Huasë (Përqindja e Shpërndarë)**

I nderuar Zotëri/Zonjë,

Ne i referohemi Rregullores (BE) 2024/1449, veçanërisht Nenit 21 të saj, dhe Marrëveshjes së Huasë ("Marrëveshja e Huasë") të datës [data e nënshkrimit nga Huamarrësi] ndërmjet Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian ("Huadhënësi") dhe Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi"). Kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

Ne konfirmojmë se hapat përkatës cilësorë dhe sasiorë, të specifikuar në Vendimin Zbatues të Komisionit, janë përmbushur në mënyrë të pranueshme dhe me anë të së cilit kërkojmë disbursimin e shumës EURO [maksimumi i shumës që Huamarrësi duhet t'i transferojë në vijim FPEBP -së, siç përcaktohet në Vendimin Zbatues të Komisionit]. Ne kemi dhënë arsyetimin e duhur për këtë kërkesë për pagesë. Ne konfirmojmë se masat në lidhje me hapat cilësorë dhe sasiorë të përmbushur më parë në mënyrë të pranueshme, nuk kanë ndryshuar.<sup>9</sup>

Ne do të japim një kopje të marrëveshjes së kontributit që mbulon Këstin e Huasë dhe do ta transferojmë këstin e huasë në FPEBP pas marrjes së kërkesave për pagesë nga menaxherët e fondit.

<sup>9</sup>Për kërkesën e parë për pagesë, ju lutem fshini këtë fjali.



1. Ne kërkojmë në mënyrë të parevokueshme që Këstet e Huasë të disbursohen në bazë dhe në përputhje me Marrëveshjen e Huasë, sipas kushteve të mëposhtme:
  - a. Shuma totale e principalit të Këstit të Huasë: deri në Euro [xxx = maksimumi i shumës së huasë, që Huamarrësi duhet t'i transferojë më tej FPEBP-së, siç specifikohet në Vendimin Zbatues të Komisionit.
  - b. Ne kërkojmë Koston e Financimit, Koston e Menaxhimit të Likuiditetit dhe Koston e Shërbimit për Këstin e Huasë, bazuar në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove.
  - c. Data e Maturimit të Këstit të Huasë nuk do të kalojë 40 vjet me shlyerjen e amortizuar të principalit, duke filluar pas një periudhe mospagimi prej 10 vjetësh.
  - d. Kësti i Huasë do të disbursohet në një këst ose disa Transhe.
2. Ne pranojmë dhe biem dakord që Disbursimi të jetë në përputhje dhe sipas sa më poshtë:
  - a. Huadhënësi është siguruar në çdo kohë që fondet përkatëse janë të disponueshme për të nga palët në tregjet ndërkombëtare të kapitalit mbi terma dhe kushte të pranueshme për të;
  - b. Huadhënësi ka marrë më parë, nëpërmjet Instrumenteve të Financimit, fondet e kërkuara në këtë Kërkesë për Pagesë. Ne marrim përsipër në mënyrë të parevokueshme që të paguajmë çdo tarifë, kosto dhe shpenzim, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, kostot e ndërprerjes dhe Koston e Menaxhimit të Likuiditetit, të llogaritura sipas Metodologjisë së Shpërndarjes të Kostove. Ne marrim përsipër në mënyrë të parevokueshme që të mbulojmë kostot e zbatimit dhe çdo tarifë të kërkueshme në lidhje me zbatimin e FPEBP-it, në përputhje me Kushtet e saj të Përgjithshme;
  - c. lëshimi nga Huadhënësi, në kohën e duhur, të një Njoftimi Konfirmimi.
  - d. Huadhënësi ka marrë nga Huamarrësi një kopje të një Marrëveshjeje Kontributi të nënshkruar, që mbulon të njëjtën shumë të kësaj Kërkesë për Pagesë.
3. Ne konfirmojmë se:
  - Lista e nënshkruesve të autorizuar, e dërguar në emër të Huamarrësit nga Ministri i Financave në [data], mbetet e vlefshme dhe e zbatueshme.
  - Nuk ka ndodhur asnjë rast që do të bënte të pasaktë ndonjë deklaratë të dhënë në Opinionin Ligjor të lëshuar më [data].



- Nuk ka ndodhur asnjë rast mospërbushjeje.

[Nënshkrimi i autorizuar]

Kopje për:

Bankën Kombëtare të Huamarrësit



## SHTOJCA 1 (b)

## FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË

[në letrën me kokë të Huamarrësit]

[data]

Komisioni Evropian  
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit  
Njësia E-3: Operacionet e Huamarrjes dhe Huadhënies  
Në vëmendje të: Drejtuesit të Njesisë  
L-2920 Luxembourg

**Lënda: Lehtësia e Reformës dhe Zgjerimit të Bashkimit Evropian për Ballkanin  
Perëndimor  
Kërkesë për Pagesë për Këstin e Huasë**

I nderuar Zotëri/Zonjë,

Ne i referohemi Rregullores (BE) 2024/1449, veçanërisht Nenit 21 të saj, dhe Marrëveshjes së Huasë ("Marrëveshja e Huasë") të datës [data e nënshkrimit nga Huamarrësi] ndërmjet Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian ("Huadhënësi") dhe Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi"). Kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

Ne konfirmojmë se hapat përkatës cilësorë dhe sasiorë, të specifikuar në Vendimin Zbatues të Komisionit, janë përmbushur në mënyrë të pranueshme dhe me anë të së cilit kërkojmë disbursimin e shumës EURO [maksimumi i shumës që Huamarrësi nuk duhet t'i transferojë më tej FPEBP -së, siç përcaktohet në Vendimin Zbatues të Komisionit]. Ne kemi dhënë arsyetimin e duhur për këtë kërkesë për pagesë. Ne konfirmojmë se masat në lidhje me hapat cilësorë dhe sasiorë të përmbushur më parë në mënyrë të pranueshme, nuk kanë ndryshuar.<sup>10</sup>

1. Ne kërkojmë në mënyrë të parevokueshme që Këstet e Huasë të disbursohen në bazë dhe në përputhje me Marrëveshjen e Huasë, sipas kushteve të mëposhtme:
  - a. Shuma totale e principalit të Këstit të Huasë: deri në Euro [xxx = maksimumi i shumës së huasë, që Huamarrësi nuk duhet t'i transferojë më tej FPEBP-së, siç specifikohet në Vendimin Zbatues të Komisionit.

.....  
<sup>10</sup>Për kërkesën e parë për pagesë, ju lutem fshini këtë fjali.



- b. Ne kërkojmë Koston e Financimit, Koston e Menaxhimit të Likuiditetit dhe Koston e Shërbimit për Këstin e Huasë, bazuar në Metodologjinë e Shpërndarjes së Kostove.
  - c. Data e Maturimit të Këstit të Huasë nuk do të kalojë 40 vjet me shlyerjen e amortizuar të principalit, duke filluar pas një periudhe mospagimi prej 10 vjetësh.
  - d. Kësti i Huasë do të disbursohet në një këst ose disa Transhe.
2. Ne pranojmë dhe biem dakord që Disbursimi të jetë në përputhje dhe sipas sa më poshtë:
- a. Huadhënësi është siguruar në çdo kohë që fondet përkatëse janë të disponueshme për të nga palët në tregjet ndërkombëtare të kapitalit mbi terma dhe kushte të pranueshme për të;
  - b. Huadhënësi ka marrë më parë, nëpërmjet Instrumenteve të Financimit, fondet e kërkuara në këtë Kërkesë për Pagesë. Ne marrim përsipër në mënyrë të parevokueshme që të paguajmë çdo tarifë, kosto dhe shpenzim, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, kostot e ndërprerjes dhe Koston e Menaxhimit të Likuiditetit, të llogaritura sipas Metodologjisë së Shpërndarjes të Kostove. Ne marrim përsipër në mënyrë të parevokueshme që të mbulojmë kostot e zbatimit dhe çdo tarifë të kërkueshme në lidhje me zbatimin e FPEBP-it, në përputhje me Kushtet e saj të Përgjithshme;
  - c. lëshimi nga Huadhënësi, në kohën e duhur, të një Njoftimi Konfirmimi.
- (2) Ne konfirmojmë se:
- Lista e nënshkruesve të autorizuar, e dërguar në emër të Huamarrësit nga Ministri i Financave në [data], mbetet e vlefshme dhe e zbatueshme.
  - Nuk ka ndodhur asnjë rast që do të bënte të pasaktë ndonjë deklaratë të dhënë në Opinionin Ligjor të lëshuar më [data].
  - Nuk ka ndodhur asnjë rast mospërbushjeje.

[Nënshkrimi i autorizuar]

Kopje për:

Bankën Kombëtare të Huamarrësit



## SHTOJCA 2

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONFIRMIMIT



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT TË KOMISIONIT  
EVROPIAN  
Menaxhimi i aseteve dhe riskut  
**Huamarrja dhe huadhënia**

[Vendosni të dhënat e kontaktit të Huamarrësit]

**Lënda:** Disbursimi i një Kësti ose Transhi Huaje prej [xxx] EURO sipas Rregullores (BE)  
2024/1449

I nderuar Zotëri apo Zonjë,

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huasë të datës [vendosni datën e nënshkrimit nga Huamarrësi] ndërmjet Komisionit Evropian ("Huadhënësi") që vepron në emër të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi") në shumën maksimumi [xxx] Euro ("Marrëveshja e Huasë"). Kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë do të kenë të njëjtin kuptim këtu.  
Në pajtim me Kërkesën për Pagesë të datës [vendosni datën], kushtet e Disbursimit janë si më poshtë:



Shuma e Principalit	[xxx] EURO
Shuma neto e disbursimit	[xxx] EURO
Data e Disbursimit	[vendosni datën]
Data e Maturimit	[vendosni datën]
Datat e pagesës së interesit	Çdo vit më [vendosni datën]
Data e pagesës së parë të interesit	[vendosni datën]
Datat e Kërkueshme	[vendosni datën]
Periudha e Interesit	[vendosni datën]

Metoda e zbatueshme e Standardizuar e Llogaritjes së Ditëve, është Aktuale/Aktuale (ICMA), i pasuar nga ato të parregulluara, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Sipas Nenit 8 (7) të Marrëveshjes së Huasë, ju lutem gjeni bashkëlidhur skemën e pagesës së huasë me anë të së cilës specifikohen Datat e Kërkueshme dhe shumat e shlyerjes së principalit.

**BASHKIMI EVROPIAN**  
i përfaqësuar nga

**KOMISIONI EVROPIAN**

Shtojca: Skeduli i pagesës së huasë

Kopje: Banka Kombëtare e Huamarrësit



## SHTOJCA 3

## FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR

## MINISTRIA E DREJTËSISË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(duhet të nxirret me letrën me kokë zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë.

[vendi, data]

Komisioni Evropian  
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit  
Njësia E-3: Operacionet e Huamarrjes dhe Huadhënies  
L-2920 Luxembourg

**Re: Marrëveshja e Huasë ndërmjet Bashkimit Evropian (si Huadhënës) dhe Republikës së Shqipërisë (si Huamarrës) dhe Bankës së Shqipërisë (si agjent ndaj Huamarrësit) për një shumë maksimale prej [xxx] EURO]**

I nderuar Zotëri ose Zonjë,

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë, i referohem Marrëveshjes së Huasë të përmendur më sipër, datë [data e nënshkrimit nga Huamarrësi] dhe Shtojcave që përbëjnë pjesë integrale të saj (në vijim të referuara bashkërisht si “Marrëveshja e Huasë”) ndërmjet Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian (në vijim i referuar si “Huadhënësi”) dhe Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si “Huamarrësi”) dhe Bankës së Shqipërisë si Agjent për Huamarrësin për shumën maksimale [xxx] EURO.

Unë garantoj se jam plotësisht kompetent për të dhënë këtë opinion ligjor në lidhje me Marrëveshjen e Huasë në emër të Huamarrësit.

Unë kam shqyrtuar origjinalet ose kopjet e versioneve të nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë. Unë kam shqyrtuar gjithashtu dispozitat përkatëse të legjislacionit kombëtar dhe të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme për Huamarrësin dhe Bankën e Shqipërisë, kompetencat e nënshkruesve dhe dokumente të tjera që i kam çmuar të nevojshme ose të përshtatshme. Gjithashtu, kam kryer hetime të tjera dhe kam shqyrtuar çështje të tilla ligjore që i kam konsideruar relevante për opinionin e shprehur këtu.

Unë kam pranuar (i) vërtetësinë e të gjitha nënshkrimeve të Huadhënësit dhe përputhshmërinë e të gjitha kopjeve me origjinalet, (ii) kapacitetin/zotësinë dhe tagrin për të lidhur Marrëveshjen e Huasë, dhe autorizimin dhe nënshkrimin e tyre të vlefshëm nga Huadhënësi dhe (iii) vlefshmërinë, efektin detyrues dhe zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Huasë për secilën palë sipas ligjit të Bashkimit Evropian dhe, vetëm kur ligji i BE-së nuk shprehet për një çështje të caktuar, ligjin e Luksemburgut.



Termet e përdorur dhe që nuk iu është dhënë kuptimi në këtë opinion, kanë kuptimin e specifikuar në Marrëveshjen e Huasë.

Ky opinion është i kufizuar në ligjin e Republikës së Shqipërisë, siç është në datën e këtij opinion.

Bazuar në sa më sipër, jam i mendimit se:

1. Në lidhje me ligjet, rregulloret dhe vendimet ligjërish të detyrueshme aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë, Huamarrësi është i angazhuar në mënyrë të vlefshme dhe të parevokueshme për ekzekutimin e Marrëveshjes së Huasë nga Gent Sejko që të përmbushë të gjitha detyrimet e tij në bazë të Marrëveshjes.
2. Ekzekutimi, dorëzimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Huasë nga Huamarrësi: (i) janë autorizuar siç duhet nga të gjitha pëlqimet, veprimet, miratimet dhe autorizimet e nevojshme; dhe (ii) nuk shkelin asnjë rregullore ose vendim të zbatueshëm të ndonjë autoriteti kompetent ose ndonjë marrëveshjeje ose traktati ndërkombëtar që përbën detyrim për të.
3. Asgjë në këtë Marrëveshje Huaje nuk bie ndesh me ose kufizon të drejtat e Huamarrësit për të bërë pagesën e përpiktë dhe të efektshme të ndonjë shume të kërkueshme për principalin, interesin ose tarifën e tjera në bazë të Marrëveshjes së Huasë.
4. Marrëveshja e Huasë është në formën e duhur ligjore sipas zbatimit të ligjit të Republikës së Shqipërisë ndaj Huamarrësit. Zbatimi i Marrëveshjes së Huasë nuk do të ishte në kundërshtim me dispozitat detyruese të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me rendin ligjor të Republikës së Shqipërisë, me traktatet ndërkombëtare ose me parimet e pranura përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare detyruese për Huamarrësin.
5. Nuk është e nevojshme për të garantuar ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Huasë që është depozituar, shënuar ose regjistruar në ndonjë gjykatë ose autoritet në Republikën e Shqipërisë.
6. Asnjë taksë, tatim, tarifë ose detyrime të tjera të vendosura nga Republika e Shqipërisë ose autoritet tatimor i tij ose tek ai nuk janë të pagueshme në lidhje me ekzekutimin dhe dorëzimin e Marrëveshjes së Huasë dhe me ndonjë pagesë ose transferim të principalit, interesit, komisioneve dhe shumave të tjera të kërkueshme në bazë të Marrëveshjes së Huasë.
7. Nuk kërkohen autorizime për kontrollin e këmbimit dhe asnjë tarifë ose komision tjetër nuk duhet të paguhet për transferimin e ndonjë shume të kërkueshme në bazë të Marrëveshjes së Huasë.
8. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Gent Sejko është autorizuar sipas rregullave nga [vendosni bazën e autorizimit p.sh. urdhri i [xx] të nënshkruajë Marrëveshjen e Huasë sipas [vendosni bazën ligjore p.sh. paragrafi (x) i pjesës [x] të Nenit [x] të [p.sh. Ligji për Traktatet Ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë].  
Nënshkrimi i Marrëveshjes së Huasë nga Gent Sejko, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë sipas [vendosni bazën e autorizimit p.sh. urdhri i xx siç u përmend në paragrafin e mëparshëm], përbën detyrim të ligjshëm dhe të vlefshëm për Bankën e Shqipërisë.
9. Zgjedhja e ligjit të Bashkimit Evropian dhe, vetëm kur ligji i BE-së nuk shprehet për një çështje



të caktuar, ligji i Luksemburgut, si ligji rregullues për Marrëveshjen e Huasë, është një zgjedhje e vlefshme e ligjit që përbën detyrim për Huamarrësin dhe Bankën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin e Republikës së Shqipërisë.

10. Në përputhje me Nenin 20 të Marrëveshjes, Huamarrësi i është nënshtruar ligjërish, në mënyrë efektive dhe të parevokueshme juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në lidhje me Marrëveshjen e Huasë dhe çdo vendim i kësaj gjykate do të jetë përfundimtar dhe i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.
11. As Huamarrësi, as ndonjë nga pronat e tij nuk janë të imunizuar, bazuar në sovranitetin ose ndryshe nga juridiksioni, konfiskimi – qoftë para apo pas gjykimit apo ekzekutimit në lidhje me ndonjë veprim apo procedurë në lidhje me Marrëveshjen e Huasë.
12. Marrëveshja e Huasë për ekzekutim është në përputhje me të gjitha kërkesat e brendshme kushtetuese që Marrëveshja e Huasë të jetë operative për sa i përket ligjit të Republikës së Shqipërisë dhe të jetë e detyrueshme për Huamarrësin dhe Bankën Kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe të jetë bërë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
13. Marrëveshja e Huasë është ratifikuar në mënyrë të vlefshme me miratimin e [*vendosni referencën në ligjin kombëtar*], e cila ka hyrë në fuqi në [*vendosni datën*], ose me ndjekjen e një procedure tjetër të brendshme të zbatueshme në përputhje me rendin e saj ligjor që konsiston në [*vendosni procedurën e parashikuar sipas ligjit kombëtar*].
14. Së fundi, Marrëveshja e Huasë është ekzekutuar sipas rregullave në emër të Huamarrësit dhe të gjitha detyrimet e Huamarrësit në lidhje me Marrëveshjen e Huasë janë të vlefshme, të detyrueshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre dhe asgjë më tej nuk kërkohet për t'i dhënë efekt/fuqi Marrëveshjes.
15. Bashkëlidhur gjenden përkthimet jozyrtare në gjuhën angleze të dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë mbi bazën e të cilave është dhënë opinioni i mësipërm. Ky legjislacion është në fuqi dhe efekt të plotë në datën e dhënies së këtij opinioni.

Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë



**SHTOJCA 4**  
**LISTA E KONTAKTEVE**

**Për Huadhënesin:**

Komisioni Evropian  
Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë & Negociatat për Zgjerimin  
Njësia D-3 “Shqipëria, Maqedonia e Veriut”  
Në vëmendje të: Drejtuesit të Njesisë  
1040, Bruxelles

Sigrid Brettel  
[Sigrid.BRETTEL@ec.europa.eu](mailto:Sigrid.BRETTEL@ec.europa.eu)

Njësia A-4 “Kordinimi i instrumenteve të financimit – performanca, rezultatet dhe vlerësimi”

Alessandro Cascavilla [Alessandro.CASCAVILLA@ec.europa.eu](mailto:Alessandro.CASCAVILLA@ec.europa.eu)

Komisioni Evropian  
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit  
Njësia E-3 "Veprimet e Huadhënies dhe Huamarrjes"  
Në vëmendje të: Drejtuesit të Njesisë  
L-2920 Luxembourg

Christian Engelen  
[Christian.ENGELEN@ec.europa.eu](mailto:Christian.ENGELEN@ec.europa.eu)

Thilo Sarre  
[Thilo.SARRE@ec.europa.eu](mailto:Thilo.SARRE@ec.europa.eu)

**Për Huamarrësin:**

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë  
Në vëmendje të:  
Petrir Malaj  
Ministër i Financave  
Bulevardi Deshmoret e Kombit, Nr.3,  
Tiranë, Shqipëri  
[sekretariamin@financa.gov.al](mailto:sekretariamin@financa.gov.al)

**Kopje drejtuar:**

Bankës së Shqipërisë  
Në vëmendje të:  
Guvernatorit  
Gent Sejko  
Sheshi Skenderbej Nr. 1,  
Tiranë, Shqipëri



**DEKRET**  
Nr. 99, datë 17.3.2025

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E  
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI  
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Shpalljen e ligjit nr. 18/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për ‘Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanit Perëndimor’”.

**Neni 2**

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 18/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për ‘Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**LIGJ**  
Nr. 19/2025

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
SË FACILITETIT NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË  
PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I  
MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, DHE BASHKIMIT  
EVROPIAN, TË PËRFAQËSUAR  
NGA KOMISIONI, PËR  
RREGULLIMET SPECIFIKE PËR  
ZBATIMIN E MBËSHTETJES SË  
BASHKIMIT EVROPIAN PËR  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË,  
NË KUADËR TË FACILITETIT  
PËR REFORMA DHE RITJE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

**Neni 2**

Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton vendimin për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes së facilitetit bashkëlidhur këtij ligji.



## Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 100, datë 17.3.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

**MARRËVESHJE FACILITETI  
NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN TË  
PËRFAQËSUAR NGA KOMISIONI  
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË  
PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I  
MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, PËR RREGULLIMET  
SPECIFIKE PËR ZBATIMIN E  
MBËSHTETJES SË BASHKIMIT EVROPIAN  
PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, NË  
KUADËR TË FACILITETIT PËR REFORMA  
DHE RRIJTJE**

**TABELA E PËRMBAJTJES  
TITULLI I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

- Neni 1 Interpretimi dhe përkufizime
- Neni 2 Objekti dhe qëllimi i Marrëveshjes
- Neni 3 Parime të përgjithshme për mbështetjen e Bashkimit në kuadër të Facilitetit
- Neni 4 Masa kufizuese të BE-së
- Neni 5 Koordinatori Kombëtar i Facilitetit të Reformës dhe Rritjes

**TITULLI II: RREGULLAT PËR ZBATIMIN**  
Neni 6 Parakushtet, kushtet e përgjithshme dhe kushtet e pagesës për mbështetjen e Bashkimit në kuadër të Facilitetit

**TITULLI III: TAKSAT DHE PRANUESHMËRIA**

- Neni 7 Taksat, detyrimet dhe tarifat
  - Neni 8 Rregullat për pranueshmërinë
- TITULLI IV: MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARË TË BASHKIMIT**

- Neni 9 Sistemet e kontrollit të brendshëm dhe detyrimet për të luftuar keqmenaxhimin e fondeve
- Neni 10 Shërbimi i Koordinimit kundër Mashtrimit

- Neni 11 Struktura e BE-së kundër mashtrimit dhe bashkëpunimi i Përfituesit me atë strukturë

Neni 12 Të drejtat e institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit për të monitoruar dhe zbatuar Facilitetin, për të hetuar dhe pasur akses

**TITULLI V: LIRIMI I FONDEVE, RIKUPERIMI DHE EKZEKUTIMI**

- Neni 13 Parafinancimi
- Neni 14 Rregullat për lirimin e fondeve
- Neni 15 Alokimi i pagesës
- Neni 16 Pagesa e mbështetjes me hua
- Neni 17 Rregullat për mbajtjen, zbritjen dhe shpërndarjen e fondeve përpara lirimit të fondeve
- Neni 18 Rregulla për zbritjen, rikuperimin dhe ekzekutimin pas lirimit të fondeve

Neni 19 Mbështetja e pakthyeshme e kanalizuar nëpërmjet Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor

Neni 20 Mbështetja me hua e kanalizuar nëpërmjet Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor

**TITULLI VI: TRANSPARENCA, MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE VIZIBILITETI**

- Neni 21 Mbledhja e të dhënave dhe transparenca
- Neni 22 Mbrojtja e të dhënave
- Neni 23 Vizibiliteti
- Neni 24 Ruajtja e dokumenteve

**TITULLI VII: MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI**

Neni 25 Kërkesat e përgjithshme të raportimit për Përfituesit

Neni 26 Gjuha

Neni 27 Informacion për kontekstin e vlerësimeve *ex-post* të Facilitetit të Reformës dhe Rritjes nga Komisioni

**TITULLI VIII: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

- Neni 28 Hyrja në fuqi
- Neni 29 Ndryshimet
- Neni 30 Pezullimi i Marrëveshjes
- Neni 31 Ndërprerja e Marrëveshjes
- Neni 32 Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Neni 33 Legjislacioni dhe juridiksioni rregullues

Neni 34 Rregullimet për dhënien e informacionit shtesë

Neni 35 Parlamenti Evropian dhe Këshilli

Neni 36 Anekset

**ANEKSI A: MODELI I KËRKESËS PËR LIRIMIN E FONDEVE**

**ANEKSI B: MODELI I DEKLARATËS SË GARANCISË**



ANEKSI C: RAPORTIMI I PARREGULLSIVE

ANEKSI D: PËRKUFIZIME TË MËTEJSHME, ME QËLLIM MBROJTJEN E INTERESAVE FINANCIARË TË BE-së

Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “**Komisioni**”, nga njëra anë,

dhe

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në vijim e referuar si “**Përfituesi**”, nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të dyja të referuara si “**Palët**”,

*duke pasur parasysh që:*

1. Rregullorja (BE) 2024/1449 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit krijoi ‘Facilitetin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor’ (**Faciliteti**)<sup>1</sup> për të mbështetur procesin e zgjerimit, duke përshpejtuar përafrimin me *acquis* të Bashkimit, për të përshpejtuar integrimin ekonomik rajonal, si edhe konvergencën socio-ekonomike me BE-në;

2. Në përputhje me nenin 11, të Rregullores (BE) 2024/1449, më 11 tetor 2024, Përfituesi i ka dorëzuar Komisionit një Agjendë Reforme për kohëzgjatjen e Facilitetit, e cila ofron një kuadër gjithëpërfshirës për arritjen e objektivave të Facilitetit dhe është bazuar në reformat strukturore, pjesë e programit të fundit të reformës ekonomike dhe udhëzimeve të përbashkëta të politikave, të miratuara në dialogun ekonomik dhe financiar, në maj 2023, strategjinë e saj të rritjes kur është e zbatueshme, kuadrin e politikave të zgjerimit dhe Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Agjenda e Reformës përcakton edhe fushat e investimeve;

3. Sipas nenit 13 të Rregullores (BE) 2024/1449, data përfundimtare e zbatimit, 31 dhjetor 2027, e përcaktuar në Agjendën e Reformës për përmbushjen e kushteve të pagesës, në lidhje me grupin përfundimtar të masave, duhet të përfshijë kohën e nevojshme që Komisioni të vlerësojë përmbushjen me sukses të kushteve të pagesës në fjalë dhe të miratojë vendimet e mëvonshme të lirimit të fondeve. Si rrjedhojë dhe siç parashikohet nga neni 13(1), pika “i” e Rregullores (BE) 2024/1449, Përfituesi duhet të zbatojë hapat cilësorë dhe sasiorë të miratuar të paktën deri më 31

gusht 2027 dhe të paraqesë një kërkesë të arsyetuar siç duhet për lirimin e fondeve, në lidhje me kushtet e përmbushura të pagesës për këto hapa sasiorë dhe cilësorë pa vonesë dhe të paktën deri më 30 shtator 2027;

4. Në përputhje me nenin 14 të Rregullores (BE) 2024/1449, Komisioni vlerësoi relevancën, gjithëpërfshirjen dhe përshtatshmërinë e Agjendës së Reformës;

5. Agjenda e Reformës duhet të miratohet me Vendim Zbatues të Komisionit;

6. Në përputhje me nenin 19 të Rregullores (BE) 2024/1449, me qëllim maksimizimin e ndikimit të mbështetjes financiare të Bashkimit për të tërhequr investime shtesë dhe për të garantuar kontrollin e Bashkimit mbi shpenzimet, investimet në infrastrukturë që mbështesin Agjendën e Reformës, duhet të zbatohen nëpërmjet Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor (**WBIF**) dhe Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, të krijuar nën WBIF, për marrjen e kontributeve të donatorëve (**EWBJF**), në përputhje me rregullat e fondit (**Kushtet e Përgjithshme të Fondit të Përbashkët**). Komisioni i paraqet Bordit Operacional të WBIF-së, për opinionin e tij, propozimet për projekte ose programe investimi vetëm pas plotësimit të kushteve përkatëse dhe miratimit të vendimit të Komisionit të përmendur në nenin 21(3) të Rregullores (BE) 2024/1449. Në përputhje me nenin 9 të Rregullores (BE) 2024/1449, Komisioni duhet të lidhë një marrëveshje faciliteti (**Marrëveshje Faciliteti**) me Përfituesin që përcakton parimet e bashkëpunimit financiar ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit, dhe detyrimet dhe kushtet që duhet të plotësojë Përfituesi për lirimin e fondeve të Facilitetit;

7. Duke pasur parasysh se në kuadër të Facilitetit, mbështetja e kanalizuar nëpërmjet WBIF-së, synon të financojë projekte investimi që kanë një periudhë të gjatë zbatimi, justifikohet parashikimi i një periudhe zbatimi prej 204 muajsh, e cila është në raport me kohëzgjatjen e projekteve të investimit;

8. Në përputhje me nenin 9 të Rregullores (BE) 2024/1449, Marrëveshja e Facilitetit duhet të përbëjë një marrëveshje kuadër që përcakton rregullime specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit në kuadër të Facilitetit, duke kthyer

<sup>1</sup> Rregullorja (BE) 2024/1449 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 maj 2024, për krijimin e Facilitetit Faqe | 6266

të Reformës dhe të Rritjes për Ballkanin Perëndimor (BP) OJ L, 2024/1449, 24.5.2024, f. 1.



dispozitat përkatëse të Rregullores (BE) 2024/1449, në detyrime dhe të drejta dypalëshe për Komisionin dhe Përfituesin. Ajo duhet të përbëjë, gjithashtu, një marrëveshje financimi sipas kuptimit të nenit 114(2) të Rregullores (BE, Euratom) 2024/2509<sup>2</sup> (**Rregullorja Financiare**) për sa i përket shumës së mbështetjes së pakthyeshme sipas Facilitetit;

9. Duhet të garantohet zbatimi i rregullave për bashkëpunimin për mbrojtjen e interesave financiarë të Bashkimit, të përcaktuara në nenin 223(5)(c) dhe nenin 129 të Rregullores Financiare;

10. Marrëveshja e Facilitetit nuk cenon detyrimin për të raportuar në Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) çdo sjellje kriminale, në lidhje me të cilën ai mund të ushtrojë kompetencën e tij, në përputhje me nenin 24 të Rregullores së Këshillit (BE) 2017/1939<sup>3</sup>, si edhe flukset e njoftimeve ndërmjet Komisionit dhe OLAF-it dhe ndërmjet Komisionit dhe EPPO-së, të përcaktuara në Rregullimet Administrative ndërmjet Komisionit Evropian dhe OLAF-it (C(2018)7705, të datës 21 nëntor 2018) dhe marrëveshjen e punës ndërmjet OLAF-it dhe EPPO-së, të datës 5 korrik 2021 dhe Marrëveshjen e 18 qershorit 2021, ndërmjet Komisionit Evropian dhe EPPO-së;

11. Në kuadër të masave kufizuese të Bashkimit, të miratuara në bazë të nenit 29 TBE dhe nenit 215 TFBE, asnjë fond ose burim ekonomik nuk mund të vendoset në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ose në përfitim të personave juridikë, subjekteve ose organeve të caktuara. Përveç kësaj, masat kufizuese sektoriale ndalojnë, ndër të tjera, disa transaksione me vendet e treta që i nënshtrohen sanksioneve, duke ndaluar financimin dhe ndihmën financiare, në lidhje me mallrat dhe shërbimet e ndaluara, duke ndaluar kontratat publike ose koncesionare me persona në disa vende të treta që i nënshtrohen sanksioneve, dhe mbështetjen sipas programeve të Bashkimit në përfitim të personave në disa vende të treta që i nënshtrohen sanksioneve. Si rrjedhojë, Marrëveshja e Facilitetit duhet të përcaktojë detyrimin e Përfituesit që të garantojë që

financimi në kuadër të Facilitetit të mos bëhet në shkelje të ndonjë prej masave kufizuese të Bashkimit;

kanë rënë dakord, si më poshtë:

## TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Interpretimi dhe përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim që u është përcaktuar dhe dhënë në Rregulloren (BE) 2024/1449.

2. Referencat për këtë Marrëveshje synohen si referenca për këtë Marrëveshje të ndryshuar, të plotësuar ose të zëvendësuar.

3. “**Masa kufizuese të Bashkimit**” janë masat kufizuese të miratuara nga Bashkimi në përputhje me nenin 29 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) ose me nenin 215 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBU).

4. “**WBIF**” nënkupton Kuadrin e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF), një nismë e përbashkët e BE-së, organizatave partnere financiare, donatorëve dypalësh dhe përfituesve, i cili synon të rrisë harmonizimin dhe bashkëpunimin për investime për zhvillimin socio-ekonomik të rajonit dhe të kontribuojë në perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor, siç përmendet në nenin 12 të Rregullores (BE) 2021/1529<sup>4</sup>.

5. “**Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (EWBJF)**” është fondi i përbashkët i krijuar nën Kuadrin e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) për marrjen e kontributeve të donatorëve, në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të miratuara së fundi me vendimin e Komisionit C(2023)4806, të datës 19 korrik 2023<sup>5</sup>.

6. “**Marrëveshje e Kontributit**” është marrëveshja me shkrim e lidhur ndërmjet një Kontribuesi dhe EWBJF-së, e cila përcakton

<sup>2</sup> Rregullorja (BE, Euratom) 2024/2509, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 shtator 2024, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit, OJ L 239, 26.9.2024.

<sup>3</sup> Rregullore e Këshillit (BE) 2017/1939, e datës 12 tetor 2017, që zbaton bashkëpunimin e forcuar për krijimin e Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (EPPO), OJ L 283, 31.10.2017, f. 1.

<sup>4</sup> Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 shtator 2021, për krijimin e Instrumentit të Ndihmës ParaAderimit (IPA III), OJ L 330, 20.9.2021, f. 1.

<sup>5</sup> Vendimi i Komisionit C(2023)4806, që ndryshon vendimin e Komisionit C(2016)3610 përfundimtar, në lidhje me miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, 19.7.2023.



shumën e angazhuar nga Kontribuesi për EWBJF-në, monedhën e kontributit, mënyrën sesi do të bëhen pagesat e tij në Llogarinë e Fondit dhe mund të përmbajë çështje të tjera administrative që mund të kërkojnë dhe lejohen nga Kushtet e Përgjithshme dhe do të mbështetet në modelin bashkëlidhur aneksit A të Kushteve të Përgjithshme, sipas rastit. Marrëveshja e Kontributit shërben, gjithashtu, si respektim i Kushteve të Përgjithshme.

7. “**Menaxherë të Fondit**” janë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI), menaxherët e EWBJF-së.

8. “**Koordinatori Kombëtar i Facilitetit për Reformën dhe Rritjen**” (Koordinatori) është përfaqësues i Përfituesit me Komisionin për zbatimin e përgjithshëm të Facilitetit.

9. “**Organizata Financiare Partnere**” nënkupton institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat kombëtare të zhvillimit që zbatojnë investime socio-ekonomike në Ballkanin Perëndimor në kuadër të WBIF-së.

10. “**Kërkesë për lirim fondesh**” është kërkesa e Përfituesit, në formën e aneksit A, për lirimin e kësteve.

11. “**Person i kufizuar**” është çdo subjekt, individ ose grup individësh të përcaktuar nga BE-ja si subjekt të masave kufizuese të BE-së<sup>6</sup>.

12. Gjithashtu, për qëllimin e mbrojtjes së interesave financiare të Bashkimit, zbatohen përkufizimet e aneksit D.

## Neni 2

### Objekti dhe qëllimi i Marrëveshjes

1. Në përputhje me nenin 9 të Rregullores (BE) 2024/1449, kjo Marrëveshje përcakton parimet e bashkëpunimit financiar ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit sipas Rregullores (BE) 2024/1449. Ajo përcakton, midis elementeve të tjera, dispozita të hollësishme për:

- menaxhimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin dhe auditimin e fondeve në kuadër të Facilitetit; si edhe
- masat për parandalimin, zbulimin, korrigjimin dhe raportimin efektiv të parregullsive, mashtrimit,

<sup>6</sup> [www.sanctionsmap.eu](http://www.sanctionsmap.eu). Harta e sanksioneve është një mjet IT për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian (OJ). Në rast Faqe | 6268

korupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që cenojnë interesat financiarë të Bashkimit, duke përfshirë konfliktin e interesit, si dhe për të mundësuar integrimin efektiv të tyre dhe ndjekjen penale nga organet kompetente të Bashkimit dhe/ose ato kombëtare.

2. Kjo Marrëveshje, gjithashtu, përbën një marrëveshje financimi sipas kuptimit të nenit 114(2) të Rregullores Financiare, në lidhje me shumën e mbështetjes së pakthyeshme të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

3. Në përputhje me Vendimin Zbatues të Komisionit C(2024)7375, të datës 23 tetor 2024, që miraton Agjendën e Reformës për Përfituesin, Bashkimi vendos në dispozicion një kontribut financiar total deri në 264,627,144.33 euro si mbështetje e pakthyeshme dhe një kontribut financiar total deri në 657,458,743.67 euro si mbështetje me hua, që do të lirohen pas një vlerësimi pozitiv të përmbushjes së kënaqshme nga ana e Përfituesit të kushteve të pagesës të përcaktuara në Agjendën e Reformës.

4. Kjo shumë mund të ndryshohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Siç përcaktohet në pjesën 2 të Agjendës së Reformës, data përfundimtare e zbatimit, 31 dhjetor 2027, për përmbushjen e kushteve të pagesës, në lidhje me grupin përfundimtar të masave, përfshin kohën e nevojshme që Komisioni të vlerësojë përmbushjen me sukses të kushteve të pagesës në fjalë dhe të miratojë vendimet pasuese të lirimit të fondeve. Në këto rrethana, Përfituesi do të zbatojë hapat cilësorë dhe sasiorë të miratuara të paktën deri më 31 gusht 2027 dhe do të paraqesë një kërkesë të justifikuar siç duhet për lirimin e fondeve, në lidhje me kushtet e përmbushura të pagesës për këto hapa sasiorë dhe cilësorë pa vonesë dhe të paktën deri më 30 shtator 2027.

6. Shumat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, mund të rriten si rezultat i një rishpërndarjeje të fondeve ndërmjet Përfituesve të Facilitetit, në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje dhe me kusht që Komisioni të ndryshojë vendimin zbatues, një ndryshim në këtë Marrëveshje dhe

mospërputhjeje ndërmjet akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, versioni i OJ-së do të ketë përparësi.



lidhjen e një marrëveshjeje të re huaje për çdo shumë shtesë huaje.

7. Në përputhje me nenin 21(6) të Rregullores (BE) 2024/1449, çdo shumë në formën e mbështetjes së pakthyeshme që korrespondon me kushtet e pagesës të cilat nuk janë përmbushur deri më 31 dhjetor 2028, nuk do t'i paguhet Përfituesit dhe nuk do të angazhohet.

8. Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit të kësaj Marrëveshjeje është 204 muaj nga hyrja e saj në fuqi.

9. Sipas nenit 9(2) të Rregullores (BE) 2024/1449, kjo Marrëveshje do të plotësohet me një marrëveshje huaje.

10. Përfituesit do t'i jepen fondet në formën e mbështetjes së pakthyeshme dhe huas vetëm pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe marrëveshjes së zbatueshme të huas.

11. Financimi për mbështetjen e pakthyeshme do të zbatohet nën menaxhimin indirekt me subjektet e besuara dhe do të jepet gradualisht nëpërmjet kontributeve që i paguhen EWBJF-së, në përputhje me kushtet e marrëveshjeve të kontributit të lidhura ndërmjet Komisionit dhe menaxherëve të fondit (siç specifikohet në nenin 20 të kësaj Marrëveshjeje).

### Neni 3

#### **Parime të përgjithshme për mbështetjen e Bashkimit në kuadër të Facilitetit**

1. Mbështetja e Bashkimit në kuadër të Facilitetit do të ofrohet në përputhje me kuadrin e politikave të zgjerimit dhe do të marrë parasysh Komunikimin e Komisionit mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së dhe raportet e përfshira në paketën vjetore të Komisionit për zgjerimin, si edhe rezolutat përkatëse të Parlamentit Evropian, komunikatat përkatëse nga Komisioni dhe dokumentet e tyre shoqëruese, në veçanti, sipas rastit, mbi sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, dokumentet e punës së stafit të Komisionit dhe komunikatat e përbashkëta nga Komisioni dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë.

2. Sipas nenit 4 të Rregullores (BE) 2024/1449, parimet e mëposhtme do të zbatohen për mbështetjen e Bashkimit në kuadër të Facilitetit të Reformës dhe të Rritjes:

a) Bashkëpunimi në kuadër të Facilitetit do të bazohet në nevoja dhe do të promovojë parimet e efektivitetit të zhvillimit, përkatësisht pronësinë e prioriteteve të zhvillimit nga Përfituesi, fokusin mbi kushtëzimin e qartë dhe rezultatet e prekshme, partneritetet gjithëpërfshirëse, transparencën dhe llogaridhënien e ndërsjellë. Ky bashkëpunim do të bazohet në një alokim dhe përdorim efektiv dhe efikas të burimeve;

b) Dhënia e ndihmës makro-financiare nuk do të përfshihet në qëllimin e Facilitetit të Reformës dhe Rritjes;

c) Mbështetja nga Faciliteti do t'i shtohet dhe do të plotësojë mbështetjen e ofruar në kuadër të programeve dhe instrumenteve të tjera të Bashkimit. Aktivitetet e pranueshme për financim sipas Rregullores (BE) 2024/1449 mund të marrin mbështetje nga programe dhe instrumente të tjera të Bashkimit, me kusht që kjo mbështetje të mos mbulojë të njëjtën kosto dhe të garantohet mbikëqyrja dhe kontrolli buxhetor i duhur. Komisioni do të garantojë komplementaritetin dhe sinergjinë ndërmjet Facilitetit dhe programeve dhe instrumenteve të tjera të Bashkimit, dhe që të shmangët duplikimi i ndihmës dhe financimi i dyfishtë. Nuk do të ketë mbivendosje ndërmjet mbështetjes së ofruar sipas Rregullores (BE) 2024/1449 dhe Rregullores (BE) 2021/1529<sup>7</sup>;

d) Aktivitetet në kuadër të Facilitetit përfshijnë dhe promovojnë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, duke harmonizuar në mënyrë progresive politikat e Përfituesit me standardet sociale, klimatike dhe mjedisore të Bashkimit. Ato do të përfshijnë zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike, sipas rastit, reduktimin e riskut nga katastrofat, mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit, në veçanti përmes vlerësimeve të ndikimit në mjedis, në rastet kur është e nevojshme. Aktivitetet do të mbështesin, gjithashtu, progresin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke nxitur veprime të integruara që mund të krijojnë përfitime të përbashkëta dhe të përmbushin objektiva të shumëfishtë në një mënyrë koherente. Këto aktivitete do të shmangin asetet e bllokuara dhe do të udhëhiqen nga parimi “mos shkakto dëm të madh” dhe parimi “mos lejo asnjë prapa”, si edhe nga qasja integruuese e

<sup>7</sup> Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 shtator 2021, për krijimin e

Instrumentit të Ndihmës së ParaAderimit (IPA III) (OJ L 330, 20.9.2021, f. 1.



qëndrueshmërisë që mbështet Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane;

e) Përfituesi dhe Komisioni do të garantojnë që barazia gjinore, integrimi gjinor dhe integrimi i perspektivës gjinore të merren parasysh dhe të promovohen gjatë zbatimit të Agjendës së Reformës dhe zbatimit të Facilitetit. Përfituesi dhe Komisioni do të ndërmarrin hapat e duhur për të parandaluar çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës ose origjinës etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual;

f) Faciliteti nuk do të mbështesë aktivitete ose masa që janë të papajtueshme me planet e Përfituesit për Energjinë dhe Klimën, Kontributin e tyre të Përcaktuar Kombëtar sipas Marrëveshjes së Parisit dhe ambicien për të arritur neutralitetin ndaj klimës të paktën deri në vitin 2050. As nuk do të mbështesë aktivitete që nxisin investimet në lëndët djegëse fosile ose që shkaktojnë efekte madhore negative mbi mjedisin, klimën ose biodiversitetin;

g) Në përputhje me parimin e partneritetit gjithëpërfshirës, Komisioni do të përpiqet të garantojë, sipas rastit, një kontroll demokratik në formën e konsultimit të parlamentit nga qeveria e Përfituesit përkatës, si dhe nga palët përkatëse të interesuara, duke përfshirë autoritetet lokale dhe rajonale, partnerët socialë dhe shoqërinë civile, në veçanti grupet vulnerabël, të gjitha pakicat dhe komunitetet, sipas rastit, në mënyrë që të mund të marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e aktiviteteve të pranueshme për financim, në kuadër të Facilitetit dhe në proceset përkatëse të monitorimit, kontrollit dhe vlerësimit, sipas rastit. Ky konsultim do të synojë të përfaqësojë pluralizmin e shoqërisë së Përfituesit;

h) Përfituesi do të publikojë të dhëna të përditësuara për përfituesit fundorë që marrin fondet e Bashkimit për zbatimin e reformave dhe investimeve sipas këtij Faciliteti, siç përshkruhet në nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 4

#### Masa kufizuese të BE-së

1. Palët do të sigurojnë që asnjë fond ose burim ekonomik të mos vendoset drejtpërdrejt ose tërthorazi në dispozicion, ose në dobi të një personi të kufizuar.

2. Përfituesi do të sigurojë që asnjë transaksion, objekt i një rezultati pozitiv të verifikuar kundrejt

listës së sanksioneve të BE-së, të mos përfitojë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga financimi i BE-së. Përfituesi angazhohet që të sigurojë këtë detyrim:

- duke kontrolluar rezultatet pozitive kundrejt listës së sanksioneve të Bashkimit, përpara lidhjes së marrëveshjeve, dhe kryerjes së pagesave sipas marrëveshjeve përkatëse, çdo kontraktori, përfituesi granti dhe përfituesi fundor me të cilin Përfituesi ose organizata partnere financiare e WBIF-së në emër të Përfituesit, ka ose pritet të ketë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë kontraktuale, në mënyrë që të vlerësojë nëse ai përfitues është person i kufizuar;

- duke kontrolluar ose me anë të mjeteve të tjera të përshtatshme (që mund të përfshijnë një verifikim *ex-post*) me qasje të bazuar në risk, që asnjë person fizik ose juridik, subjekt ose organ i cili do të merrte në mënyrë të tërthortë fonde nga Bashkimi, nuk është person i kufizuar.

3. Gjithashtu, Palët do të garantojnë që fondet në kuadër të Facilitetit të mos sigurohen në shkelje të ndonjë mase tjetër kufizuese të miratuar nga Bashkimi.

4. Në rast se Përfituesi çmon se ndonjë nga përfituesit (direkt ose indirekt) e fondeve të BE-së është ose është bërë person i kufizuar i përmendur në paragrafin 1, ose që financimi është në kundërshtim me masat kufizuese të përmendura në paragrafin 3, Përfituesi do të informojë Komisionin menjëherë.

5. Pa cenuar detyrimin në paragrafin 3, nëse Komisioni çmon se përdorimi i ndihmës financiare të Bashkimit në kuadër të Facilitetit rezulton ose ka rezultuar në shkelje të masave kufizuese të Bashkimit, ai do të informojë Përfituesin, dhe shumat korresponduese do të bëhen të papranueshme në kuadër të Facilitetit. Një procedurë kundërshtuese mund të kryhet për këtë qëllim, nëse Përfituesi nuk e ka korrigjuar shkeljen. Kjo nuk cenon asnjë të drejtë që Komisioni mund të ketë për të pezulluar ose ndërprerë për shkaqe të tjera veprimin e prekur nga kjo shkelje, për të rikuperuar çdo financim të BE-së të kontribuar nga Komisioni ose për të pezulluar, ose ndërprerë këtë Marrëveshje.

6. Kjo klauzolë nuk cenon përjashtimet ose shmangiet e përcaktuara në masat kufizuese të Bashkimit.

7. Përfituesi do të vendosë detyrimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, ndaj të gjithë përfituesve të fondeve të paguara për masat



në zbatim të reformave dhe projekteve të investimeve të përfshira në Agjendën e Reformës ose ndaj të gjithë personave fizikë, ose subjekteve të tjera të përfshira në zbatimin e tyre. Këto detyrime do të autorizojnë shprehimisht - brenda kufijve të kompetencave të tyre përkatëse - Komisionin, OLAF-in, ECA-n dhe EPPO-në për të ushtruar të drejtat e tyre, siç parashikohet në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 5

### Koordinatori Kombëtar i Facilitetit të Reformës dhe Rritjes

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator që të veprojë si përfaqësues me Komisionin për zbatimin e përgjithshëm të Facilitetit.

2. Koordinatori do të jetë përfaqësues i lartë i Këshillit të Ministrave ose administratës qendrore të Përfituesit me autoritetin e duhur për të vepruar në emër të Këshillit të Ministrave dhe për të koordinuar punën e të gjitha ministrave dhe institucioneve përkatëse të përfshira në zbatimin e Facilitetit.

3. Koordinatori:

- do të garantojë koordinimin e përgjithshëm, zbatimin në kohë, raportimin dhe monitorimin e ndihmës për Përfituesin, në veçanti koordinimin brenda administratës dhe me donatorët e tjerë, sipas rastit, në përputhje me objektivat e përcaktuar në Rregulloren (BE) 2024/1449;

- do të koordinojë një dialog të rregullt të politikave të nivelit të lartë me Komisionin;

- do të sigurojë një lidhje të ngushtë ndërmjet përdorimit të fondeve të Facilitetit dhe procesit të përgjithshëm të anëtarësimit;

- do të garantojë që ndihma e marrë në kuadër të Facilitetit të plotësojë ndihmën e marrë sipas Rregullores (BE) 2021/1529 dhe çdo ndihmë tjetër të jashtme të marrë nga Përfituesi;

- do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesave për lirimin e fondeve në kuadër të Facilitetit, për sigurimin e vërtetësisë së tyre dhe nënshkrimin e deklaratës së garancisë;

- do të nënshkruajë ose bashkë nënshkruajë kërkesat për pagesë sipas Marrëveshjes së Huas;

- do të ketë: i. kapacitetin administrativ për sa i përket burimeve njerëzore (numri dhe profilet e stafit), përvojën dhe ekspertizën institucionale; dhe ii. mandatin dhe autoritetin për të ushtruar të gjitha

detyrat përkatëse, duke përfshirë përgjegjësitë e raportimit dhe monitorimit;

- do të jetë përgjegjës për koordinimin me autoritetin përkatës për garantimin e përmbushjes së kënaqshme të hapave përkatës cilësorë dhe sasiorë të identifikuar për zbatimin e Agjendës së Reformës dhe për menaxhimin e fondeve, në përputhje me të gjitha rregullat në fuqi, në veçanti rregullat për shmangien e konfliktit të interesave, parandalimin e mashtrimit, korrupsionit dhe financimit të dyfishtë;

- do të drejtojë dhe orientojë punën për kontributin e Përfituesit në Komitetin e Monitorimit të përmendur në nenin 25 të kësaj Marrëveshjeje;

- do të sigurohet që Komisioni të marrë kopjet e marrëveshjeve të kontributit të nënshkruara nga Përfituesi me menaxherët e fondit dhe vërtetimin e disbursimit për EWBJF-në, pa vonesë (siç specifikohet në nenin 20 të kësaj Marrëveshjeje);

- do të jetë përgjegjës për koordinimin e ndërlidhjes me Komisionin, Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO), ku secili vepron brenda kompetencave të tij përkatëse dhe autoritetet e Përfituesit për zbatimin e përgjithshëm të Facilitetit. Koordinatori do të sigurojë që Komisioni, OLAF-i, Gjykata Evropiane e Audituesve dhe EPPO të jenë të aftë të ushtrojnë lirisht të drejtat e tyre dhe të kenë akses të plotë për të ushtruar kompetencat e tyre. Në rastin e OLAF-it, këto të drejta përfshijnë, ndër të tjera, të drejtën për të kryer hetime, duke përfshirë kontrollet dhe inspektimet në terren, brenda kufijve të mandatit të tij dhe në rastin e EPPO-së, të drejtat e përcaktuara në marrëveshjet në fuqi për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale;

- do të jetë përgjegjës për koordinimin e përpjekjeve për të garantuar që fondet në kuadër të Facilitetit të përdoren në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit për qëllimin e synuar;

- do të jetë përgjegjës për koordinimin e subjekteve të Përfituesit, që duhet të garantojnë që fondet në kuadër të Facilitetit të menaxhohen siç duhet, veçanërisht në përputhje me rregullat e Përfituesit të plotësuara nga standardet dhe rregullat e auditimit të Bashkimit dhe OECD-së për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, korrupsionit dhe çdo aktivitet tjetër të paligjshëm, si edhe konfliktin e interesave dhe



parregullsitë që prekin interesat financiarë të Bashkimit;

- do të sigurojë mbledhjen, aksesin dhe transferimin në një format elektronik të të dhënave për personat fizikë dhe juridikë që marrin fonde për zbatimin e masave në kuadër të Facilitetit, në përputhje me nenin 22 dhe 23(2)(d) të Rregullores (BE) 2024/1449;

- do të jetë përgjegjës për sigurimin e monitorimit të krijimit dhe vënies në funksionim të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të përmendura në nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje;

- do të jetë përgjegjës për ruajtjen e procedurave të duhura për hartimin e deklaratës së garancisë dhe përmbledhjen e auditimeve dhe kontrolleve të kryera në nivel kombëtar. Kjo përfshin:

- një procedurë efektive për hartimin e deklaratës së garancisë në përputhje me modelin në aneksin B, duke dokumentuar përmbledhjen e auditimeve dhe kontrolleve, dhe mbajtur informacionin bazë për gjurmën e auditimit; dhe

- procedura efektive për të garantuar që të gjitha rastet e parregullsive, mashtrimit, korrupsionit dhe konfliktit të interesave që prekin interesat financiarë të Bashkimit, të raportohen dhe të korrigjohen siç duhet nëpërmjet rikuperimeve;

- do të mirëmbajë një sistem efektiv për ruajtjen e të gjithë informacionit dhe dokumenteve të nevojshme për qëllimet e gjurmimit të auditimit, në lidhje me zbatimin e hapave cilësorë dhe sasiorë;

- do të sigurojë zbatimin e masave të duhura, duke përfshirë procedurat për të kontrolluar nëse janë përmbushur hapat përkatës cilësorë dhe sasiorë të identifikuar për zbatimin e Agjendës së Reformës dhe nëse janë respektuar parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar. Kjo përfshin:

- mjetet e duhura që autoritetet përgjegjëse për zbatimin e Agjendës së Reformës të kontrollojnë nëse janë përmbushur hapat përkatës cilësorë dhe sasiorë (p.sh. analizë dokumentuese, kontrolle në terren); dhe

- mjetet e duhura që këto autoritete të kontrollojnë që nuk ka parregullsi, mashtrime, korrupsion ose aktivitete të tjera të paligjshme, duke përfshirë konfliktin e interesave që prek interesat financiarë të Bashkimit dhe financimin e dyfishtë (p.sh. analizë dokumentuese, kontrolle në terren).

## TITULLI II RREGULLAT PËR ZBATIMIN

### Neni 6

#### **Parakushtet, kushtet e përgjithshme dhe kushtet e pagesës për mbështetjen e Bashkimit në kuadër të Facilitetit**

1. Në përputhje me nenin 5(1) të Rregullores (BE) 2024/1449, financimi në kuadër të këtij Faciliteti i nënshtrohet përmbushjes së parakushteve, kushteve të përgjithshme dhe kushteve të pagesës nga Përfituesi, të cilat duhet të përmbushen për çdo lirim të fondeve, përveç parafinancimit ku zbatohen vetëm parakushtet dhe kushtet e përgjithshme.

2. Parakushtet për mbështetjen në kuadër të Facilitetit do të jenë ato të përcaktuara në nenin 5(1) të Rregullores (BE) 2024/1449.

3. Sipas nenit 12(3) të Rregullores (BE) 2024/1449, kushtet e përgjithshme për mbështetje në kuadër të Facilitetit janë stabiliteti makro-financiar, menaxhimi i qëndrueshëm i financave publike, transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit.

4. Kushtet e pagesës për mbështetjen në kuadër të Facilitetit janë përcaktuar në Agjendën e Reformës. Kur Agjenda e Reformës, përfshirë kushtet përkatëse të pagesës, nuk është më e realizueshme nga Përfituesi, pjesërisht ose tërësisht, për shkak të rrethanave objektive, Përfituesi mund të propozojë një Agjendë Reforme të ndryshuar. Në këtë rast, Përfituesi mund t'i bëjë një kërkesë të arsyetuar Komisionit për të ndryshuar vendimin e tij zbatues të Komisionit për miratimin e Agjendës së Reformës, të përmendur në nenin 15(1) të Rregullores (BE) 2024/1449.

## TITULLI III TAKSAT DHE PRANUESHMËRIA

### Neni 7

#### **Taksat, detyrimet dhe tarifat**

1. Financimi nga Bashkimi nuk do të gjenerojë ose aktivizojë mbledhjen e taksave, detyrimeve ose tarifave specifike. Neni 28 i Marrëveshjes Kuadër të Partneritetit Financiar për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit sipas IPA III, do të zbatohet për këtë Facilitet.



2. Ky nen nuk cenon privilegjet dhe imunitetet e subjekteve që zbatojnë fondet e Facilitetit nën menaxhim indirekt, dhe çdo marrëveshje që këto subjekte kanë lidhur ose mund të lidhin me Përfituesin në lidhje me taksat, detyrimet dhe tarifat.

#### Neni 8

### Rregullat për pranueshmërinë

1. Pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe dhënien e granteve për aktivitetet e financuara në kuadër të Facilitetit, do të jetë e hapur për organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe për të gjithë personat fizikë që janë shtetas ose persona juridikë të krijuar në fakt, në:

a) Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, përfituesit, vendet candidate dhe palët kontraktuese në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Evropiane;

b) vende të cilat ofrojnë një nivel mbështetjeje për Përfituesit e këtij Faciliteti të krahasueshëm me atë që ofron Bashkimi, duke marrë parasysh madhësinë e ekonomisë së tyre, dhe për të cilat Komisioni vendos qasjen e ndërsjellë ndaj ndihmës së jashtme për Përfituesit e këtij Faciliteti.

2. Qasja e ndërsjellë e përmendur në paragrafin 1(b) mund të jepet për një periudhë të kufizuar prej të paktën një viti, kur një përfitues i shpall të kualifikuar në kushte të barabarta subjektet e Bashkimit dhe të vendeve të pranueshme në kuadër të Facilitetit. Komisioni do të vendosë për qasjen e ndërsjellë pas konsultimit me Përfituesin.

3. Të gjitha furnizimet dhe materialet e financuara dhe të prokuruar nga Përfituesi sipas këtij Faciliteti, do të vijnë nga çdo vend i përmendur në paragrafin 1 (a) dhe (b), përveç rasteve kur këto furnizime dhe materiale nuk mund të merren për kushte të arsyeshme në ndonjë nga ato vende. Përveç kësaj, do të zbatohen rregullat për kufizimet e përcaktuara në paragrafin 6.

4. Rregullat e pranueshmërisë sipas këtij neni nuk do të zbatohen dhe nuk do të krijojnë kufizime të shtetësisë për personat fizikë të punësuar ose ndryshe të kontraktuar ligjërisht nga një kontraktues i kualifikuar ose, sipas rastit, nënkontraktor, përveç rasteve kur kufizimet e shtetësisë bazohen në rregullat e parashikuara në paragrafin 6.

5. Për aktivitetet e bashkëfinancuara nga një njësi ekonomike ose të zbatuara nën menaxhimin direkt ose indirekt me subjektet e përmendura në nenin 62(1), pika (c) e Rregullores Financiare, do të

zbatohen, gjithashtu, rregullat e zbatueshme për këto subjekte. Kjo nuk cenon kufizimet sipas paragrafit 6 të këtij neni, të cilat do të pasqyrohen siç duhet në marrëveshjet e lidhura me ato subjekte.

6. Rregullat e pranueshmërisë dhe rregullat për origjinën e furnizimeve dhe materialeve, në paragrafët 1 dhe 3, dhe rregullat për shtetësinë e personave fizikë, siç parashikohen në paragrafin 4, mund të kufizohen në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike ose natyrën e personave juridikë që marrin pjesë në procedurat e shpalljes së kontratave fituese, si edhe në lidhje me origjinën gjeografike të furnizimeve dhe materialeve, kur:

a) këto kufizime kërkohen për shkak të natyrës ose objektivave specifike të aktivitetit, ose procedurës specifike të shpalljes së kontratës fituese, ose kur këto kufizime janë të nevojshme për zbatimin efektiv të aktivitetit;

b) aktiviteti ose procedurat specifike të shpalljes së kontratës fituese ndikojnë në sigurinë ose rendin publik, veçanërisht në lidhje me asetet dhe interesat strategjike të Bashkimit, të Shteteve Anëtare ose të Përfituesit, duke përfshirë sigurinë, qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e integritetit të infrastrukturës digjitale, në veçanti infrastrukturën e rrjetit 5G, komunikimin dhe sistemet e informacionit, dhe zinxhirët e furnizimit përkatës.

7. Aplikantët në tender dhe kandidatët nga vendet që nuk kualifikohen, mund të përfshihen si të pranueshëm në raste urgjente ose kur shërbimet nuk janë të disponueshme në tregjet e vendeve, ose territoreve në fjalë, ose në raste të tjera të vërtetuara siç duhet, kur zbatimi i rregullave të pranueshmërisë do të bënte të pamundur ose tepër të vështirë realizimin e një aktiviteti.

#### TTULLI IV

### MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARË TË BASHKIMIT

#### Neni 9

### Sistemet e kontrollit të brendshëm dhe detyrimet për të luftuar keqmenaxhimin e fondeve

1. Në përputhje me nenin 23 të Rregullores (BE) 2024/1449, Përfituesi duhet të garantojë që ekziston një sistem efektiv dhe efikas i kontrollit të



brendshëm, duke zbatuar parimet<sup>8</sup> e kontrollit të brendshëm të njohura ndërkombëtarisht dhe siguruar rikuperimin e menjëhershëm të shumave të paguara ose të përdorura gabimisht. Përfituesi mund të bazohet në sistemet e tij të rregullta kombëtare të menaxhimit të buxhetit për të zbatuar Facilitetin.

2. Si çështje me përparësi, gjatë viteve të para të zbatimit të Facilitetit, autoritetet e Përfituesit do të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur interesin financiar të Bashkimit dhe përmirësuar më tej efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për t'u përafuar me *acquis* të Bashkimit (sipas kriterëve për reformën e administratës publike, menaxhimin e financave publike dhe negociatat e anëtarësimit, kapitulli 8, politika e konkurrencës, 23 gjyqësori dhe të drejtat themelore, 24 drejtësia, liria dhe siguria, dhe 32 kontrolli financiar). Kjo përfshin mekanizmat e duhur për të mbrojtur sinjalizuesit, si dhe mekanizmat dhe masat e duhura për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar në mënyrë efektive parregullsitë, mashtrimin, korrupsionin dhe aktivitete të tjera të paligjshme që prekin interesat financiarë të Bashkimit, përfshirë konfliktin e interesave, si dhe për të forcuar luftën kundër pastrimit të parave, krimit të organizuar, keqpërdorimit të fondeve publike, financimit të terrorizmit, shmangies së taksave, mashtrimit tatimor ose evazionit fiskal, dhe aktivitete të tjera të paligjshme që prekin fondet e ofruara në kuadër të Facilitetit, për të garantuar që të mos ketë financim të dyfishtë nga Faciliteti dhe programe të tjera të Bashkimit dhe që shumat e paguara gabimisht ose të përdorura gabimisht të mund të rikuperohen.

3. Përfituesi do të sigurojë akses për Komisionin ose përfaqësuesit e tij në të gjitha institucionet dhe dokumentet e nevojshme për të kryer çdo auditim, verifikim dhe kontroll në vend.

4. Si pjesë e kësaj përgjegjësie, Përfituesi:

a) bën progres vendimtar drejt krijimit të një kuadri ligjor të fortë për të luftuar mashtrimin dhe korrupsionin, duke përfshirë rastet e korrupsionit të nivelit të lartë;

b) përmirëson më tej efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit, duke zbatuar parimet e

kontrollit të brendshëm të njohura ndërkombëtarisht;

c) zbaton mekanizmat e duhur për të mbrojtur sinjalizuesit në përputhje me regjimin e mbrojtjes të Direktivës (BE) 2019/1937<sup>9</sup>, kur është e zbatueshme, ose me një regjim ekuivalent mbrojtjeje sipas ligjit të Përfituesit;

d. ruan mekanizmat e përshtatshëm dhe merr masat e duhura për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar në mënyrë efektive parregullsitë, mashtrimin, korrupsionin ose çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat financiarë të Bashkimit, përfshirë konfliktin e interesave, si dhe për të forcuar luftën kundër pastrimit të parave, krimit të organizuar, keqpërdorimit të fondeve publike, financimit të terrorizmit, shmangies së taksave, mashtrimit tatimor ose evazionit fiskal dhe aktivitete të tjera të paligjshme që prekin fondet e ofruara në kuadër të Facilitetit;

e) merr masat e duhura për të lejuar autoritetet kompetente të Përfituesit që të hetojnë dhe të ndjekin penalisht veprat penale të cilat prekin interesat financiarë të Bashkimit;

f) zbulon dhe shmang financimin e dyfishtë;

g) kontrollon rregullisht nëse fondet e dhëna janë përdorur siç duhet dhe në përputhje me të gjitha rregullat e zbatueshme, veçanërisht për përmbushjen e kënaqshme të hapave përkatës cilësorë dhe sasiorë të identifikuar për zbatimin e Agjendës së Reformës dhe për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, korrupsionit ose çdo veprimtari tjetër të paligjshme, si dhe konfliktet e interesave dhe parregullsitë që prekin interesat financiarë të Bashkimit;

h) siguron rikuperimin e menjëhershëm të shumave të paguara gabimisht ose të përdorura gabimisht;

i) siguron që Komisioni, OLAF-i, ECA dhe EPPO, të përfaqësuar nga agjentët e tyre përkatës ose ekspertët e mandatuar, të kenë akses në të dhënat e përmendura në nenin 21, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit dhe me rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave;

<sup>8</sup> I referohet Kuadrit të Integruar – Parimi i Kontrollit të Brendshëm i COSO-së, siç zbatohet nga Komisioni: [C\(2017\) 2373 final](#).

<sup>9</sup> Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 23 tetorit 2019, për mbrojtjen e personave që

denoncojnë shkelje të legjislacionit të Bashkimit, OJ L 305, 26.11.2019, f. 17.



j) siguron dokumente të duhura mbështetëse që vërtetojnë, në veçanti, se zbatimi i Agjendës së Reformës pajtohet me detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që hapat cilësorë dhe sasiorë të Agjendës së Reformës, siç janë miratuar nga Vendimi Zbatues i Komisionit, të jenë zbatuar, nëse kërkohet që të bëhet në kontekstin e kontrolleve ose auditimeve të përshkruara në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje. Këto dokumente duhet të mbahen deri në fund të vitit 2033 për qëllime auditimi.

Në përputhje me nenin 133 të Rregullores Financiare, Përfituesi do të mbajë të dhëna dhe dokumente që lidhen me auditimet, apelimet, çështjet gjyqësore dhe ndjekjen e pretendimeve, në lidhje me angazhimet e tyre ligjore ose që lidhen me hetimet e OLAF-it dhe do t'i ruajë këto të dhëna dhe dokumente deri në përfundimin e këtyre auditimeve, apelimeve, proceseve gjyqësore dhe ndjekjes së kërkesave ose hetimeve. Për të dhënat dhe dokumentet e lidhura me hetimet e OLAF-it, detyrimi për ruajtje do të zbatohet pasi këto hetime t'i jenë njoftuar përfituesit.

Në përputhje me nenin 133 të Rregullores Financiare, Përfituesi do të mbajë të dhënat dhe dokumentet ose origjinale, ose kopje të njehsuara me origjinalet, ose në format ruajtës të të dhënave që është pranuar gjerësisht, duke përfshirë versionet elektronike të dokumenteve origjinale ose dokumenteve ekzistuese vetëm në version elektronik. Nëse nuk ekzistojnë versione elektronike, nuk do të kërkohet asnjë dokument origjinal kur këto dokumente plotësojnë kërkesat ligjore të zbatueshme, në mënyrë që të konsiderohen të barasvlershme me origjinalet dhe për t'u bazuar në to për qëllime auditimi.

5. Çdo ndryshim në sistemet e kontrollit të brendshëm të Përfituesit, siç përshkruhet në Agjendën e Reformës, do t'i komunikohet Komisionit pa vonesë.

6. Komisioni duhet të sigurohet mjaftueshëm që kushtet e pagesës të përcaktuara në Agjendën e Reformës, të jenë përmbushur në mënyrë të kënaqshme, siç specifikohet në kërkesën përkatëse për lirimin e fondeve. Komisioni mund të kërkojë informacion shtesë dhe të kryejë auditime (verifikime) ose kontrolle në terren, të cilat mund të kryhen mbi bazë risku.

7. Përfituesi do të forcojë luftën kundër mashtrimit, korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që prekin interesat financiarë të

Bashkimit gjatë të gjithë zbatimit të Facilitetit. Zbatimi në kohë i reformave përkatëse sipas Agjendës së Reformës, është vendimtar për arritjen e këtij qëllimi. Gjithashtu, Përfituesi do të sigurojë që autoritetet e tij të angazhohen për të përmirësuar procedurat e brendshme të mëtejshme për të parandaluar dhe/ose hetuar rastet e mashtrimit, korrupsionit, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, shmangies së taksave, mashtrimit tatimor ose evazionit fiskal dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që ndikojnë në interesat financiarë të Bashkimit.

8. Me kërkesë, Përfituesi do të vendosë në dispozicion të Komisionit të gjithë informacionin e kërkuar, për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve të Përfituesit sipas këtij neni.

#### Neni 10

#### **Shërbimi i Koordinimit kundër Mashtrimit**

1. Përfituesi do të përdorë shërbimin e pavarur të koordinimit kundër mashtrimit të krijuar në kuadër të IPA III ose në mungesë të tij, do të bazohet në struktura ekuivalente për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit, përfshirë informacionin me natyrë operacionale, me OLAF-in. Ky shërbim, në veçanti:

a) mbështet bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të administratës dhe prokurorisë së Përfituesit dhe OLAF-it;

b) udhëheq krijimin/zbatimin e një strategjie kombëtare për mbrojtjen e interesave financiarë të Bashkimit, të paraprirë nga një vlerësim risku;

c) kontribuon në identifikimin e pikave të dobëta të mundshme në sistemet e Përfituesit për menaxhimin e fondeve të Bashkimit, duke përfshirë ndihmën financiare në kuadër të këtij Faciliteti;

d) jep këshilla për çështjet kundër mashtrimit, si dhe trajnimin e stafit, duke përfshirë parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit;

e) ndan me OLAF-in informacion mbi parregullsitë, mashtrimet, korrupsionin dhe çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat financiarë të Bashkimit, duke përfshirë konfliktin e interesit;

f) garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas Rregullores (KE, Euratom) nr. 883/2013, të (Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Rregullores së Këshillit p.sh. (Euratom, KE), nr. 2988/1995 dhe



Rregullores së Këshillit (KE, Euratom) nr. 2185 /1996.

2. Shërbimi i Koordinimit të Përfituesit kundër Mashtrimit, përgjegjës për parandalimin dhe zbulimin efektiv të parregullive, mashtrimit, korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që prekin interesat financiarë të Bashkimit, përfshirë konfliktin e interesit, përgatit dhe miraton një metodologji, në përputhje me nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje, mbi mënyrën e trajtimit në nivel të brendshëm, të rasteve të dyshuara, raportimit të tyre nga Përfituesi tek Komisioni, në përputhje me modelin e dhënë në aneksin B dhe ndjekjen për korrigjimin e tyre.

3. Koordinatori duhet të sigurojë koordinim me shërbimin e koordinimit kundër mashtrimit, duke respektuar pavarësinë e tij.

Neni 11

### **Struktura e BE-së kundër mashtrimit dhe bashkëpunimi i Përfituesit me atë strukturë**

1. Autoritetet kompetente të Përfituesit do të bashkëpunojnë ngushtë me Komisionin, OLAF-in, Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe EPPO-në, brenda kufijve të kompetencave përkatëse të secilit organ, për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e parregullive, mashtrimit, korrupsionit dhe çdo veprimtarie tjetër të paligjshme që prek interesat financiarë të Bashkimit, duke përfshirë konfliktin e interesave, si dhe hetimin dhe ndjekjen penale të veprave që prekin fondet e ofruara në kuadër të Facilitetit. Sipas rastit, Përfituesi do të përdorë mekanizmat mbështetës të ofruar nga Eurojust.

2. Çdo person ose subjekt, përfshirë autoritetet kombëtare, që zbaton fondet e Bashkimit në kuadër të Facilitetit, ka detyrimin të njoftojë, pa vonesë, Komisionin dhe OLAF-in për çdo informacion në lidhje me rastet e mundshme të parregullive, mashtrimit, korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që prekin interesat financiarë të Bashkimit, përfshirë konfliktin e interesit, dhe EPPO-së për çdo sjellje kriminale që prek fondet në kuadër të Facilitetit që mund të jenë objekt i kompetencës së tij. Për këtë qëllim, preferohet që ata të përdorin një pikë hyrjeje të vetme të ofruar nga Komisioni. Çdo person që njofton Komisionin, OLAF-in ose EPPO-në për një informacion të tillë, duhet të mbrohet nga çdo formë hakmarrjeje, në përputhje me regjimin e mbrojtjes të Direktivës

(BE) 2019/1937, kur është e zbatueshme, ose me një regjim ekuivalent mbrojtjeje sipas Ligjit të Përfituesit. Shërbimi kombëtar i koordinimit kundër mashtrimit do t'i raportojë Komisionit dhe OLAF-it mbi zbatimin e këtij detyrimi në rastet kur ai ka njoftuar vetë informacionin përkatës sipas këtij paragrafi, ose kur ka koordinuar, mbështetur ose ndihmuar persona ose subjekte të tjera në këtë njoftim.

3. Autoritetet kombëtare të Përfituesit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin C, i raportojnë Komisionit, pa vonesë, për parregullsitë, mashtrimin, korrupsionin dhe aktivitete të tjera të paligjshme, të cilat kanë qenë objekt i një konstatimi parësor administrativ ose gjyqësor, pavarësisht nëse OLAF-i ose EPPO janë njoftuar sipas paragrafit 2 të këtij neni. Ato, gjithashtu, do të informojnë Komisionin për ecurinë e procedurave administrative dhe ligjore. Për këtë qëllim, autoritetet e Përfituesit do të përdorin Sistemin e Menaxhimit të Parregullive (IMS) të krijuar nga Komisioni.

4. Përfituesi do të sigurojë hetimin dhe trajtimin efektiv të rasteve të dyshuara të parregullive, mashtrimit, korrupsionit dhe çdo aktiviteti tjetër të paligjshëm që prek interesat financiarë të Bashkimit, përfshirë konfliktin e interesit, dhe do të përdorë, sipas rastit, mbështetjen e Eurojustit.

5. Përfituesi, përfshirë vendimmarrësit dhe stafin përgjegjës për zbatimin e veprimeve në kuadër të Facilitetit, do të vendosë procedurat dhe do të marrë të gjitha masat paraprake të nevojshme për të parandaluar dhe eliminuar çdo konflikt interesi, veçanërisht duke garantuar që vendimmarrësit dhe stafi i përfshirë të mos trajtojnë çështjen në fjalë.

6. Krahas kontroleve sipas nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni mund të ushtrojë të drejtat e tij siç parashikohet në nenin 129(1) të Rregullores Financiare dhe mund të kryejë verifikime, rishikime, kontrole dhe auditime për zbatimin e Agjendës së Reformës, në lidhje me:

a) masat në fuqi dhe zbatimin e tyre efektiv për të parandaluar, zbuluar, hetuar, korrigjuar dhe raportuar mashtrimin, korrupsionin dhe çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat financiarë të Bashkimit, konfliktin e interesave dhe parregullsitë, përfshirë hetimin dhe ndjekjen efektive të veprave penale që prekin fondet e ofruara në kuadër të Facilitetit;



b) informacionin dhe justifikimin në lidhje me përmbushjen e kënaqshme të hapave cilësorë dhe sasiorë në kërkesën për lirim të fondeve.

Këto verifikime, rishikime, kontrole dhe auditime mund të kryhen gjatë zbatimit të Agjendës së Reformës dhe, me përjashtim të hetimeve të OLAF-it dhe hetimeve, dhe ndjekjes penale nga EPPO, deri në pesë vjet, duke filluar nga data e liritimit përfundimtar të fondeve dhe mund të mbulojnë sistemin e informacionit që përdor Përfituesi për të mbledhur dhe siguruar të dhëna që përdoren për të justifikuar përfundimin e hapave cilësorë dhe sasiorë të identifikuar në lidhje me zbatimin e Agjendës së Reformës. Këto procedura do t'i njoftohen zyrtarisht Përfituesit. Nëse është e nevojshme, Komisioni mund të ndihmohet nga ekspertë të pavarur ose firma të jashtme auditimi.

7. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen dhe në nenin 12, në veçanti mosraportimi i parregullsive ose mosbashkëpunimi për çështjet kundër mashtrimit me Komisionin, OLAF-in, ECA-n dhe EPPO-në, do të përbëjë një rast të shkeljes së rëndë të detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për këtë arsye mund të çojë në një reduktim të kontributit financiar ose rikuperim të të gjithë ose të një pjese të disbursimit të kryer prej tij, siç parashikohet në nenin 18(1) të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 12

### **Të drejtat e institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit për të monitoruar dhe zbatuar Facilitetin, hetuar dhe pasur akses**

1. Agjentët e Komisionit, OLAF-i, Gjykata Evropiane e Audituesve dhe EPPO, brenda kufijve të mandateve të tyre përkatëse, kanë të drejtë të kryejnë çdo veprim hetimor ose auditimi, duke përfshirë verifikimet ose auditimet teknike, financiare dhe të sistemit, që ata mund të çmojnë të nevojshëm për të ndjekur zbatimin e Agjendës së Reformës. Kjo përfshin vizitat në terren dhe ambiente ku po zbatohen ose menaxhohen, do të zbatohen ose menaxhohen apo janë zbatuar ose menaxhuar aktivitetet e financuara nga Faciliteti.

2. Sipas të njëjtave kushte të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe nenin 9(4) të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi do të garantojë që agjentët ose përfaqësuesit e Komisionit, OLAF-it, ECA-së dhe EPPO-s, secili duke vepruar brenda

kompetencave të tyre përkatëse, të inspektojnë dhe të mbledhin të gjithë dokumentacionin përkatës, të dhënat digjitale, asetet dhe llogaritë e lidhura me zërat e financuar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe t'i ndihmojë që të kryejnë detyrat e tyre në lidhje me Facilitetin.

3. Kur pajisjet në pronësi private, të cilat nuk janë në pronësi të autoritetit të inspektuar, përdoren për qëllime pune, ato pajisje mund t'i nënshtrohen inspektimit nga OLAF-i. OLAF-i do t'i nënshtrojë këto pajisje për inspektim vetëm sipas të njëjtave kushte dhe në të njëjtën masë që autoritetet kombëtare të kontrollit lejohen të hetojnë pajisjet në pronësi private dhe nëse OLAF-i ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se përmbajtja e tyre mund të jetë e rëndësishme për hetimin.

4. Për të garantuar mbrojtjen efektive të interesave financiarë të Bashkimit, Komisioni, OLAF-i dhe EPPO do të jenë të aftë të kryejnë të gjitha aktet përkatëse hetimore brenda kompetencave të tyre përkatëse, dhe në veçanti, në rastin e OLAF-it, kontrole dhe inspektime në terren. Këto kontrole dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me Përfituesin, i cili do të njoftohet në kohë për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontroleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të ofrojë të gjithë ndihmën e kërkuar. Përfituesi do të identifikojë një shërbim me kompetenca të zbatimit të ligjit, i cili do të ndihmojë OLAF-in në kryerjen e hetimeve në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) nr. 883/2013 dhe Rregulloren (KE, Euratom) nr. 2185/1996, me kërkesë të OLAF-it, dhe do të bashkëpunojë me EPPO-në në ushtrimin e kompetencave të tij.

5. Kur personi ose subjekti i inspektuar i reziston kontrollit, hetimit ose inspektimit në terren, Përfituesi, duke vepruar në përputhje me ligjet dhe rregullat e veta kombëtare, do t'i japë Komisionit, OLAF-it dhe EPPO-së ndihmën e nevojshme për t'i lejuar të përmbushin detyrën e tyre në kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në terren.

6. Organet e mëposhtme mund të ushtrojnë të drejtat e tyre të parashikuara në nenin 129(1) të Rregullores Financiare për të kryer rishikime, kontrole, auditime dhe hetime, brenda kufijve të mandateve të tyre përkatëse:

- OLAF sipas rregulloreve nr. 883/2013 dhe nr. 2185/1996;

- EPPO sipas rregullores 2017/1939; dhe



- Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA) sipas nenit 287 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 263 të Rregullores Financiare.

7. Komisioni mund të marrë masat që i çmon të nevojshme, në veçanti në rastet e mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesave ose shkeljes së rëndë të detyrimeve në këtë Marrëveshje, për të reduktuar kontributin financiar dhe rikuperuar të gjitha ose një pjesë të disbursimeve të kryera prej tij, siç parashikohet në nenet 17 dhe 18 të kësaj Marrëveshjeje.

8. Gjithashtu, Komisioni ose përfaqësuesit e tij kanë të drejtë të kryejnë në çdo kohë verifikime, auditime ose kontrole në terren të sistemeve të kontrollit të brendshëm të Përfituesit, në çdo kohë, në përputhje me standardet e njohura brenda vendit. Komisioni ose përfaqësuesit e tij do të kryejnë një rishikim të sistemeve të kontrollit të brendshëm të Përfituesit jo më vonë se në vitin 2025. Raporti i auditimit që rezulton, do të përmbajë rekomandime për Përfituesin për të përmirësuar Sistemet e tij të Kontrollit të Brendshëm. Kur verifikimi, auditimi ose kontrolli në vend rezultojnë në gjetje, Komisioni ose përfaqësuesit e tij të caktuar do të hartojnë një draft raport që përmban gjetjet e përkohshme. Komisioni ose përfaqësuesit e tij të emëruar do të njoftojnë zyrtarisht draft raportin dhe do ta ftojë Përfituesin të komentojë. Duke marrë parasysh këto parashtrime, Komisioni ose përfaqësuesit e tij do të nxjerrin një raport përfundimtar që jep rekomandimet përfundimtare. Përfituesi do të hartojë një plan veprimi për të zbatuar çdo rekomandim ose për të dhënë arsyen e moszbatimit. Përfituesi do t'i dorëzojë Komisionit për miratim planin e veprimit dhe, nëse është e nevojshme, çdo arsyetim brenda 2 muajve nga marrja e raportit përfundimtar.

9. Përfituesi do t'u japë agjentëve ose përfaqësuesve të Komisionit, OLAF-it, ECA-së dhe EPPO-së, dhe përfaqësuesve të tyre të autorizuar, brenda kompetencave të tyre përkatëse dhe në përputhje me kuadrin e tyre ligjor në fuqi, akses në terren dhe ambientet ku realizohen investimet dhe reformat e financuara sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në të dhënat e përcaktuara në nenin 9(4) të kësaj Marrëveshjeje.

Përfituesi do t'i japë, gjithashtu, Komisionit, OLAF-it, ECA-s dhe EPPO-së akses të plotë dhe të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave të krijuara sipas

nenit 21 (5) të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo bazë tjetër të dhënash kombëtare, kur është e nevojshme, për ushtrimin e mandatit të tyre. Me kërkesë të arsyetuar, Përfituesi do t'i japë, gjithashtu, OLAF-it dhe EPPO-së informacion mbi llogaritë bankare të rëndësishme për hetimet e tyre dhe, kur është rreptësisht e nevojshme për një hetim, informacion mbi transaksionet bankare. Aksesit, brenda kufijve të kompetencës së tyre përkatëse, nga përfaqësuesit të autorizuar të Komisionit, OLAF, ECA dhe EPPO-ja do të lejohet me kushtin e konfidencialitetit të rreptë në lidhje me palët e treta, pa cenuar detyrimet e së drejtës publike të cilave u nënshtrohen.

10. Autoritetet kompetente të Përfituesit do të trajtojnë, pa vonesë, kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe kërkesat për ekstradim të lëshuara nga EPPO-ja dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, në lidhje me veprat penale që prekin fondet e nxjerra sipas Rregullores (BE) 2024/1449. Ata do ta bëjnë këtë në përputhje me instrumentet përkatëse mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale, në veçanti, Konventën Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale dhe Protokollin e saj Shtesë.

11. Kontrollat dhe auditimet e përshkruara më sipër zbatohen për të gjithë përfituesit dhe nënkontraktorët që kanë marrë asistencë në kuadër të Facilitetit, pavarësisht nëse janë përmendur ose jo në kontratë ose marrëveshje granti. Këto kontrole dhe auditime zbatohen, gjithashtu, për dokumentet dhe të dhënat mbi kontributin kombëtar, nëse ka, nga Përfituesi.

## TITULLI V

### LIRIMI I FONDEVE, RIKUPERIMI DHE EKZEKUTIMI

Neni 13

#### **Parafinancimi**

1. Pas dorëzimit të Agjendës së Reformës në Komision, Përfituesi ka kërkuar lirimin e një parafinancimi deri në 7% të shumës totale të parashikuar sipas këtij Faciliteti, siç përcaktohet në nenin 2(3) të kësaj Marrëveshjeje.

2. Komisioni mund të lirojë parafinancimin e kërkuar pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe të marrëveshjes së huas së përmendur në nenin 2(9) të kësaj Marrëveshjeje. Fondet do të lirohen, me kusht që të përmbushen parakushtet dhe kushtet e



përgjithshme të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Për mbështetjen e pakthyeshme, parafinancimi i dhënë sipas paragrafit 1 do të likuidohet duke zbritur një përqindje nga çdo këst. Kjo përqindje llogaritet si raport i parafinancimit të mbetur të palikuiduar me shumën e mbetur të alokuar për mbështetje të pakthyeshme. Zbritja do të vazhdojë derisa parafinancimi të jetë likuiduar plotësisht. Shumat e parafinancimit që nuk janë likuiduar deri më 31 dhjetor 2027, do të jenë menjëherë të pagueshme. Komisioni ka të drejtë të kompensojë këto shuma kundrejt çdo pretendimi që Përfituesi ka ndaj Bashkimit.

4. Me kërkesë të Përfituesit në kërkesën e tij për lirim e fondeve, shumat shtesë mund të zbriten nga çdo këst për të likuiduar parafinancimin më herët.

5. Çdo parafinancim i palikuiduar do të rikuperohet ose kompensohet plotësisht pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

6. Marrëveshja e Huas e përmendur në nenin 2(9) të kësaj Marrëveshjeje, do të përcaktojë rregullat specifike në lidhje me pagesën dhe likuidimin e parafinancimit të mbështetjes me hua.

#### Neni 14

#### Rregullat për lirim e fondeve

1. Pagesat e mbështetjes financiare të pakthyeshme dhe të huas për Përfituesin, sipas këtij neni, do të bëhen në përputhje me ndarjet buxhetore dhe në varësi të financimit të disponueshëm. Pagesat do të bëhen me këste. Një këst mund të disbursohet në një ose më shumë këste.

2. Me përjashtim të parafinancimit, Përfituesi do të paraqesë dy herë në vit një kërkesë të justifikuar siç duhet për lirim e fondeve, duke përdorur formatin e dhënë në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo kërkesë për lirim e fondeve do të raportojë për kushtet e pagesës në lidhje me hapat sasiore dhe cilësorë të përcaktuar në Agjendën e Reformës që ishin planifikuar të zbatoheshin deri në fund të periudhës gjashtëmujore paraardhëse sipas kalendarit indikativ të përfshirë në Agjendën e Reformës. Këto periudha gjashtëmujore do të përfundojnë më 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti, duke filluar nga 31 dhjetori 2024, me përjashtim të grupit të fundit të kushteve të pagesës që janë

planifikuar të zbatohen deri më 31 gusht 2027 dhe për të cilat Përfituesi duhet të paraqesë një kërkesë për lirim e fondeve jo më vonë se data 30 shtator 2027.

4. Me çdo kërkesë për lirim e fondeve të paraqitur në Komision, Përfituesi duhet të paraqesë të dhënat e kërkuara që tregojnë përmbushjen e kënaqshme të hapave cilësorë dhe sasiore të përcaktuar në aneksin përkatës të vendimit zbatues të Komisionit.

5. Mosraportimi brenda 15 ditëve pas përfundimit të periudhave gjashtëmujore të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni për zbatimin e hapave sasiore dhe cilësorë sipas kalendarit indikativ të përfshirë në Agjendën e Reformës, do të rezultojë në fillimin automatik të periudhës së zbatueshme të tolerancës/faljes. Komisioni do të ofrojë mbështetjen përkatëse, nëse është e nevojshme, kur të ofrojë mbështetjen që korrespondon me periudhat e ardhshme gjashtëmujore.

6. Brenda 90 ditëve kalendarike pas marrjes nga Përfituesi të një kërkesë për lirim e fondeve, Komisioni do të kryejë vlerësimin sipas nenit 21(2) të Rregullores (BE) 2024/1449 në bazë të informacionit të dhënë nga Përfituesi, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni. Përmbushja e kënaqshme e hapave cilësorë dhe sasiore do të presupozojë që Përfituesi të mos anulojë masat në lidhje me hapat për të cilët Përfituesi kishte arritur përmbushje të kënaqshme. Komisioni mund të ndihmohet nga ekspertë.

7. Si pjesë e vlerësimit, Komisioni do të monitorojë zbatimin në kohë nga Përfituesi të çdo rekomandimi të dhënë pas auditimit të përmendur në nenin 12(8) të kësaj Marrëveshjeje. Gjithashtu, Komisioni mund të kërkojë informacion shtesë dhe/ose të kryejë kontrole dhe verifikime në terren për përfundimin e hapave cilësorë dhe sasiore, duke përfshirë edhe për mosanulimin e hapave cilësorë dhe sasiore që janë përmbushur më parë. Periudha prej 90 ditësh kalendarike e përmendur në paragrafin 6 për vlerësimin e kërkesës për lirim e fondeve, ndërpritet kur Komisioni kërkon informacion shtesë ose kryen kontrole dhe verifikime në terren.

8. Në bazë të një vlerësimi pozitiv që Përfituesi përmbush kushtet e pagesës, parakushtet dhe kushtet e përgjithshme, siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të miratojë një vendim që autorizon lirim e fondeve për një



shumë që korrespondon me këto kushte. Vendimet për lirim e mbështetjes me hua, do të miratohen jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2027.

9. Vendimi i Komisionit që autorizon këtë lirim fondesh, do të përbëjë kushtin për shumën e fondeve që do të vihen në dispozicion si mbështetje e Bashkimit.

a) Mbështetja e pakthyeshme do t'i disbursohet EWBJF-së në përputhje me nenin 19 të kësaj Marrëveshjeje;

b) Mbështetja me hua do të disbursohet në thesarin e Përfituesit, duke përfshirë shumën e huas që do të vendoset në dispozicion nëpërmjet WBIF-së, në përputhje me nenin 20 të kësaj Marrëveshjeje.

10. Për çdo kërkesë për lirim të fondeve sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç kërkesës për parafinancim, Përfituesi do të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- Një kërkesë të nënshkruar për lirim e fondeve duke përdorur formatin e dhënë në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë një deklaratë që nuk janë anuluar masat e zbatuara për të realizuar hapat në lidhje me të njëjtën reformë të vlerësuar më parë me sukses nga Komisioni dhe që janë përmbushur në vendimet e mëparshme të lirim të fondeve;

- Një fletë për çdo hap të përmbushur në kërkesën përkatëse për lirim e fondeve që tregon se hapi është përmbushur, i mbështetur me të dhëna zyrtare në lidhje me të;

- Një Deklaratë Garancie të nënshkruar sipas formatit të dhënë në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje që konfirmon se: i. informacioni i paraqitur me kërkesën për lirim e fondeve është i plotë, i saktë dhe i besueshëm; ii. sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit japin garancinë e nevojshme që financimi i dhënë është përdorur në përputhje me rregullat e zbatueshme, veçanërisht për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesave dhe parregullsisve; dhe iii. janë marrë masat e duhura për të shmangur financimin e dyfishtë nga Faciliteti dhe programet, dhe instrumentet e tjera të Bashkimit, si dhe donatorë të tjerë;

- Një përmbledhje e auditimeve të kryera nga autoritetet përkatëse, duke përfshirë pikat e dobëta të identifikuara dhe çdo veprim korrigjues të ndërmarrë;

- Për hapat në lidhje me kërkesën për lirim e fondeve, një përmbledhje e rezultateve të kontroleve që sigurojnë se çdo masë për zbatimin e

reformave dhe projekteve të investimit në kuadër të Facilitetit, është zbatuar siç duhet.

11. Përfituesi do të sigurojë dokumentacionin e duhur për të justifikuar kërkesën për lirim e fondeve për çdo hap të vetëm dhe sipas burimeve të verifikimit të përcaktuara në aneksin I të Agjendës së Reformës. Kjo duhet të përfshijë të paktën:

- një dokument përmbledhës që justifikon, sipas rregullave, përmbushjen e mjaftueshme të hapave sasiore ose cilësore (duke përfshirë të gjitha elementet përbërëse);

- për hapat që kërkojnë hyrjen në fuqi të një akti ligjor: një kopje të botimit të aktit ligjor përkatës në Fletoren Zyrtare të Përfituesit;

- për hapat që kërkojnë miratimin e një strategjie/plani veprimi/udhërrëfyesi/çdo akt tjetër publik që nuk konsiderohet akt ligjor: një kopje të aktit të miratuar dhe një link në faqen e internetit ku mund të konsultohet strategjia;

- për hapat që kërkojnë nxjerrjen e një raporti që nuk është publikuar: një kopje të raportit të brendshëm ose të jashtëm;

- për hapat që kërkojnë që një sistem i caktuar të vibet në funksionim: certifikatat e përfundimit të nënshkruara nga kontraktori dhe autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin kombëtar që tregojnë se sistemi është ngritur dhe është funksional;

- çdo dokument tjetër përkatës që çmohet i rëndësishëm për justifikimin ligjor formal të përmbushjes së kënaqshme të hapit sasiore ose cilësor, siç është përcaktuar në Agjendën e Reformës.

Komisioni mund të kërkojë të dhëna shtesë kur e çmon të nevojshme.

12. Nëse është e nevojshme, në kërkesën për lirim e fondeve Përfituesi do të specifikojë nëse ndonjë hap cilësor dhe sasiore ka marrë mbështetje dhe financim, duke përfshirë shumën korresponduese, nga programe dhe instrumente të tjera të Bashkimit ose programe të tjera donatorësh, dhe do të shpjegojë rregullimet që janë bërë për të shmangur financimin e dyfishtë.

Neni 15

### Alokimi i pagesës

1. Në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 14, Përfituesi, kur i dërgon Komisionit kërkesat për lirim e fondeve sipas kësaj Marrëveshjeje dhe kërkesat për pagesë sipas marrëveshjes së huas, do të respektojë alokimin e



mëposhtëm, në lidhje me kontributet maksimale financiare të përcaktuara në nenin 2(3) të kësaj Marrëveshjeje:

a) 28.7% nga mbështetja e pakthyeshme dhe 24.8% nga mbështetja me hua, në shumën 53.5%, që do të vendoset në dispozicion nëpërmjet Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF); dhe

b) 46.5% nga mbështetja me hua, do të vendoset në dispozicion direkt në thesarin e Përfituesit.

2. Komisioni nuk do të jetë i detyruar nga alokimi i pagesës së specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe mundet në çdo kohë, pas njoftimit me shkrim të Përfituesit përpara kërkesës së ardhshme të planifikuar për lirimin e fondeve, të aplikojë një alokim të ndryshëm pagese.

#### Neni 16

##### **Pagesa e mbështetjes me hua**

1. Pa cenuar nenet 13, 14 dhe 15 të kësaj Marrëveshjeje, disbursimi i mbështetjes me hua do të bëhet sipas rregullave të përcaktuara në marrëveshjen e huas.

#### Neni 17

##### **Rregullat për mbajtjen, zbritjen dhe shpërndarjen e fondeve përpara lirimit të fondeve**

1. Nëse pas kërkesës për lirimin e fondeve dhe sipas rregullave në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni kryen një vlerësim negativ të përmbushjes së plotë ose të pjesshme të çdo kushti sipas planifikimit kohor indikativ, lirimi i fondeve që korrespondojnë me këto kushte do të mbahet plotësisht ose pjesërisht. Shumat e mbajtura do të lirohen vetëm kur Përfituesi të ketë justifikuar siç duhet, si pjesë e kërkesës vijuese për lirimin e fondeve, se ka marrë masat e nevojshme për të garantuar përmbushjen e kënaqshme të kushteve përkatëse.

2. Me kusht që të jenë përmbushur kushtet e pagesës, disbursimi i fondeve përkatëse të mbajtura mund të kryhet gjatë periudhës së ardhshme për lirimin e fondeve dhe deri në 24 muaj për kushtet e pagesës që duhet të bëhet në vitin e parë dhe 12 muaj për kushtet e pagesës që duhet të bëhet në vitet në vijim, siç përcaktohet në planifikimin kohor të përcaktuar në Agjendën e Reformës.

3. Kur Komisioni arrin në përfundimin se Përfituesi nuk ka marrë masat e nevojshme brenda një periudhe prej 12 muajsh nga vlerësimi fillestar negativ i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, Komisioni zvogëlon shumën e mbështetjes financiare të pakthyeshme dhe të huas në raport me pjesën që korrespondon me kushtet përkatëse të pagesës. Gjatë vitit të parë të zbatimit do të aplikohet një afat prej 24 muajsh, i llogaritur nga vlerësimi fillestar negativ i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

4. Kur një hap cilësor dhe sasior që është vlerësuar i përmbushur në masë të kënaqshme në një kësht pagese të mëparshme, është anuluar ose më vonë është konstatuar se nuk është zbatuar, Komisioni mund të ulë shumën e një pagese vijuese me shumën korresponduese, në përputhje me nenet 21 ( 2) dhe (5) të Rregullores (BE) 2024/1449. Paragrafi 5 i këtij neni zbatohet në përputhje me rrethanat.

5. Komisioni mund të ftojë Përfituesin që të paraqesë parashtrimet e tij brenda 2 muajve, në rastet kur Komisioni ka vendosur të ulë shumën e disbursimit të fondeve në përputhje me paragrafët 3 ose 4 të këtij neni.

6. Pa cenuar paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni dhe dispozitat e marrëveshjes së huas, Përfituesit nuk do t'i paguhet asnjë shumë që korrespondon me kushtet e pagesës që nuk janë përmbushur deri më 31 dhjetor 2028.

Komisioni mund të vendosë që çdo shumë e zbritur sipas paragrafit 3 të këtij neni, të rishpërndahet ndërmjet Përfituesve të tjerë të Facilitetit.

#### Neni 18

##### **Rregulla për zbritjen, rikuperimin dhe ekzekutimin pas lirimit të fondeve**

1. Komisioni mund të zbresë shumën e mbështetjes financiare të disponueshme në kuadër të Instrumentit dhe të rikuperojë nga Përfituesi, në veçanti me anë të kompensimit, çdo shumë të shpenzuar për arritjen e objektivave të Facilitetit, duke kërkuar shlyerjen e parakohshme të huas në përputhje me marrëveshjen e huas, dhe duke i kërkuar Përfituesit që t'i kthejë Komisionit një shumë të barabartë me shumën e mbështetjes financiare të pakthyeshme të angazhuar tashmë nga Komisioni për EWBIF-në:



a) nëse fondet janë paguar në mënyrë të parregullt;

b) në raste të identifikuara ose probleme të rënda rreth parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit dhe konflikteve të interesave që prekin interesat financiarë të Bashkimit, të cilat nuk janë korrigjuar nga Përfituesi, në përputhje me nenin 23(3) të Rregullores (BE) 2024/1449;

c) në rast të një shkeljeje të rëndë të çdo detyrimi që rezulton nga kjo marrëveshje, ose marrëveshja e huas, në veçanti bazuar në raporte të autoriteteve të auditimit të Përfituesit ose në informacionin e dhënë nga OLAF-i ose në raporte të Gjykatës së Audituesve;

d) anulimi i hapave cilësorë dhe/ose sasiorë sipas Agjendës së Reformës ose në rastet kur konstatohet, pas kryerjes së pagesës, se hapat nuk janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme.

2. Anulimi i hapave cilësorë dhe/ose sasiorë në kuadër të reformave të krijuara për të trajtuar mangësitë në sistemin e Përfituesit për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin në mënyrë efektive të parregullsive, mashtrimit, korrupsionit, në veçanti korrupsionit të nivelit të lartë dhe konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 13(1) të Rregullores (BE) 2024/1449, duke përfshirë ato të çmuara nga Komisioni si plotësuese për atë sistem sipas kapitujve të negociatave të përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 24(1) të asaj rregulloreje, mund të rezultojë në një shkelje të rëndë të detyrimit në kuptimin e pikës (c) të paragrafit 2.

3. Kur vendos për shumën që është objekt i zbritjes, ose shumën që duhet të shlyhet më herët, Komisioni do të respektojë parimin e proporcionalitetit dhe do të marrë parasysh shkallën e parregullsisë, mashtrimit, korrupsionit ose konfliktit të interesit që prek interesat financiarë të Bashkimit, ose të shkeljes së një detyrimi. Përpara se të bëhet zbritja ose të kërkohet shlyerja para kohe, Përfituesi do të ftohet të paraqesë parashtrimet e tij brenda 2 muajve.

4. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian do të ketë juridiksion ekskluziv për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të përmendur në paragrafin 1 dhe për të pezulluar zbatimin e tij. Megjithatë, Gjykatat e Përfituesit do të kenë juridiksion mbi ankimet për mënyrën e parregullt të zbatimit. Në këtë kontekst, Gjykatat e Përfituesit do t'i referojnë pyetjet mbi interpretimin e kësaj

marrëveshjeje dhe të drejtës së BE-së për vendim nga Gjykata e Drejtësisë.

5. Institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian të përfshira në zbatimin e Facilitetit ose në kontrollet mbi atë program, do të kenë të drejtë të komunikojnë drejtpërdrejt, në veçanti nëpërmjet sistemeve të shkëmbimit elektronik, me çdo person fizik me banim ose çdo person juridik të krijuar te Përfituesi dhe që merr fonde të lidhura me Facilitetin, si dhe çdo palë të tretë të përfshirë në zbatimin e Facilitetit që banon ose është krijuar te Përfituesi. Këta persona, subjekte dhe palë mund t'u paraqesin drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që u kërkohet të paraqesin në bazë të kontratave ose marrëveshjeve të lidhura për zbatimin e Facilitetit.

Neni 19

### **Mbështetja e pakthyeshme e kanalizuar nëpërmjet Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor**

1. Pa cenuar dispozitat e tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje, fondet e Facilitetit në formën e mbështetjes së pakthyeshme, të cilat kanalizohen nëpërmjet WBIF-së, u nënshtrohen dispozitave të përcaktuara në këtë nen.

2. Në bazë të një vlerësimi pozitiv të kërkesës për lirimin e fondeve sipas nenit 14, dhe pas opinionit pozitiv të Bordit Operacional të WBIF-së, të përmendur në nenin 35(8) të Rregullores (BE) 2021/947 për propozimet përkatëse të projekteve të investimit, Komisioni do t'i shpërndajë fondet e liruara për projektet e përzgjedhura të investimeve, duke lidhur marrëveshje kontributi me menaxherët e fondit. Kjo marrëveshje kontributi do të nënshkruhet nga Komisioni, pasi të marrë vërtetimin e nënshkrimit të marrëveshjes së kontributit ekuivalent ndërmjet EWBJF-së dhe Përfituesit në fjalë. Komisioni do t'i transferojë këto fonde në këste tek EWBJF pas paraqitjes së kërkesave për pagesë nga menaxherët e fondit.

3. Shumat që mbeten në EWBJF në fund të zbatimit të projektit të fundit të investimit të mbështetur nga Faciliteti, do t'i transferohen Komisionit në përputhje me rregullat e EWBJF-së.



Neni 20

**Mbështetja me hua e kanalizuar nëpërmjet  
Kwadrit të Investimeve në Ballkanin  
Perëndimor**

1. Pa cenuar dispozitat e tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje, fondet e Facilitetit në formën e mbështetjes me hua, të cilat kanalizohen nëpërmjet WBIF-së, u nënshtrohen dispozitave të përcaktuara në këtë nen.

2. Përpara çdo disbursimi të mbështetjes me hua në thesarin e Përfituesit që do të kanalizohet me pas nëpërmjet WBIF-së, Përfituesi do të lidhë marrëveshje kontributi me menaxherët e fondit për shumat përkatëse të dhëna në përputhje me nenin 14(9)(b) të kësaj Marrëveshjeje që do të alokohen si bashkëfinansim i investimeve të vlerësuara pozitivisht nga Bordi Operacional i WBIF-së, siç përmendet në nenin 19 (2).

3. Përfituesi do t'i japë Komisionit kopjet e marrëveshjeve përkatëse të kontributit, si dhe çdo ndryshim të tyre, pa vonesë. Pas marrjes së këtyre njoftimeve, Komisioni do të disbursojë shumat përkatëse të huas drejtpërdrejt në thesarin e Përfituesve. Përfituesit do t'i transferojnë këto fonde me këste tek EWBJF-ja pas paraqitjes së kërkesave për pagesë nga menaxherët e fondit dhe pa vonesë do t'i japin Komisionit vërtetimin e çdo pagese sipas çdo marrëveshjeje me menaxherët e fondit.

4. Çdo shumë e rikuperuar në EWBJF do të mbetet në dispozicion të Përfituesit në përputhje me rregullat e EWBJF-së.

5. Shumat që mbeten të papërdorura në fund të zbatimit të projektit të fundit të investimit të mbështetur në kuadër të Facilitetit, do t'i transferohen Përfituesit në përputhje me rregullat e EWBJF-së.

6. Në rast se anulohet një projekt investimi i përzgjedhur, ose përfituesi nuk i jep EWBJF-së vërtetimin e pagesës të përmendur në paragrafin 3 të tij, Komisioni rezervon të drejtën që të kërkojë shlyerjen e parakohshme të shumës përkatëse të huas, në përputhje me marrëveshjen e huas.

TTULLI VI

**TRANSPARENCA, MBROJTJA E TË  
DHËNAVE DHE VIZIBILITETI**

Neni 21

**Mbledhja e të dhënave dhe transparenca**

1. Përfituesi angazhohet për transparencë dhe llogaridhënie në zbatimin e Facilitetit.

2. Përfituesi do të garantojë mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme për personat dhe subjektet që marrin fonde në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni dhe aksesin e Komisionit në këto të dhëna, duke përfshirë informacionin mbi pronësisë përfituese, sipas kuptimit të nenit 3(6) të Direktivës (BE) 2015/849.

3. Përfituesi do të publikojë të dhëna të përditësuara për përfituesit fundorë që marrin shuma financimi që tejkalojnë ekuivalentin prej 50 000 euro në mënyrë kumulative gjatë periudhës 4-vjeçare, për zbatimin e reformave dhe investimeve të specifikuar në Marrëveshjen e Facilitetit.

4. Përfituesi do të përditësojë të dhënat e përmendura në paragrafin 3 të paktën një herë në vit.

5. Për përfituesit fundorë të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, informacioni i mëposhtëm do të publikohet në një format të lexueshëm nga pajisja në një faqe interneti, sipas fondit total të marrë:

- Në rastin e një personi juridik, emrin e plotë ligjor të përfituesit dhe numrin e identifikimit të TVSH-së ose numrin e identifikimit tatimor, kur ka, ose një identifikues tjetër unik të përcaktuar nga legjislacioni i zbatueshëm për personin juridik.

- Në rastin e një personi fizik, emrin dhe mbiemrin e përfituesit.

- Shumën e marrë nga përfituesi dhe reformat dhe investimet sipas Agjendës së Reformës për zbatimin e së cilave kontribuon kjo shumë.

6. Informacioni i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni nuk do të publikohet, nëse nxjerrja e tij rrezikon të kërcënojë të drejtat dhe liritë e përfituesve fundorë në fjalë ose të dëmtojë seriozisht interesat e tyre tregtarë. Megjithatë, ky informacion do t'i vendoset në dispozicion Komisionit dhe autoritetit përkatës të auditimit.

7. Përfituesi do t'i transmetojë Komisionit në mënyrë elektronike, të paktën një herë në vit, të dhënat për përfituesit fundorë të përmendur në



paragrafin 3, duke përdorur formatin XML, sipas një modeli të ofruar nga Komisioni.

8. Përfituesi do t'i japë Komisionit të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme për krijimin e Tabelës së Rezultateve të Facilitetit dhe përditësimin e saj dy herë në vit, siç përcaktohet në nenin 26 të Rregullores (BE) 2024/1449. Ky informacion do të përfshijë raporte në kohë dhe të sakta për ecurinë e zbatimit të Agjendës së Reformës. Përfituesi do të bashkëpunojë plotësisht me Komisionin për të garantuar që tabela e rezultateve të jetë funksionale deri më 1 janar 2025 dhe e aksesueshme nga publiku në internet.

9. Përfituesi bie dakord që Agjenda e Reformës dhe kërkesa për lirim të fondeve të vendosen në dispozicion të publikut jo më vonë se kërkesa e parë për lirim të fondeve.

#### Neni 22

##### Mbrojtja e të dhënave

1. Përfituesi garanton mbrojtjen e duhur të të dhënave personale ekuivalente me atë të kërkuar nga Rregullorja (BE) 2018/1725 dhe Rregullorja (BE) 2016/679. Të dhëna personale janë informacionet për një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Çdo veprim që përfshin përpunimin e të dhënave personale, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi, fshirja ose shkatërrimi, do të bazohet në rregullat dhe procedurat e Përfituesit dhe do të bëhet vetëm në masën e nevojshme për zbatimin e Facilitetit.

2. Në veçanti, Përfituesi merr masat e duhura teknike dhe organizative të sigurisë për mbrojtje nga rreziqet e natyrshme të çdo veprimi dhe natyrën e informacionit për personin fizik të prekur, me qëllim që:

- të parandalojë aksesin e çdo personi të paautorizuar në sistemet kompjuterike që kryejnë këto veprime, dhe veçanërisht leximin, kopjimin, ndryshimin ose heqjen e paautorizuar të mediave të ruajtjes, hedhjen e paautorizuar të të dhënave, si dhe çdo zbulim, ndryshim ose fshirje të paautorizuar të informacionit të ruajtur;

- të sigurojë që përdoruesit e autorizuar të një sistemi IT që kryejnë këto veprime, të mund të ketë akses vetëm në informacionin që korrespondon me të drejtat për akses;

- të ideojë strukturën e tij organizative në mënyrë të tillë që të plotësojë kërkesat e mësipërme.

#### Neni 23

##### Vizibiliteti

1. Përfituesi do të marrë masat e nevojshme për të njohur në mënyrë aktive origjinën dhe për të garantuar vizibilitetin e financimit të Bashkimit, në veçanti, nëse ka, duke shfaqur emblemën e Bashkimit dhe një deklaratë të përshtatshme financimi që lexon “financuar nga Bashkimi Evropian” ose “bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian”, veçanërisht kur promovohen projekte dhe rezultatet e tyre, duke dhënë informacion të synuar koherent, efektiv dhe proporcional për audienca të shumta, përfshirë median dhe publikun.

2. Këto masa vizibiliteti, komunikimi, publiciteti dhe informacioni do të sigurohen në një format të aksesueshëm dhe do të jenë në pajtim me udhëzimet për veprimet e jashtme të BE-së “Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së”, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni, në fuqi në kohën e masave.

3. Përfituesi do të sigurojë një plan gjithëpërfshirës komunikimi dhe vizibiliteti jo më vonë se kërkesa e parë për lirim të fondeve, për miratim nga Komisioni. Përfituesi duhet të sigurojë që planit të komunikimit dhe vizibilitetit t'i caktohen burime të mjaftueshme dhe që ai të zbatohet siç duhet. Përfituesi do të përfshijë informacionin e mëposhtëm në planin e tij të komunikimit dhe vizibilitetit: objektivat; audiencat e synuara (përfshirë audiencat lokale); aktivitetet/kanalet e komunikimit; buxhetin e planifikuar; projektet kryesore të përzgjedhura; marrëveshjet e koordinimit me Komisionin; dhe monitorimin dhe vlerësimin.

#### Neni 24

##### Ruajtja e dokumenteve

1. Sipas nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi do të ruajë për pesë vjet nga data e përfundimit të një projekti:

a) të gjitha dokumentet përkatëse për procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, kontratat, shtesat, korrespondencën përkatëse dhe të gjitha dokumentet përkatëse, në lidhje me pagesat dhe rikuperimet për projektet e investimit të financuara nëpërmjet EWBIF-së;



b) të gjitha dokumentet që lidhen me zbatimin e mbështetjes në formën e huave, qoftë të kanalizuar drejtpërdrejt në thesaret e Përfituesit, ose nëpërmjet WBIF-së.

2. Periudha e përmendur në paragrafin 1 do të ndërpritet ose në rast të proceseve ligjore, duke përfshirë hetimet nga OLAF-i ose hetimet dhe ndjekjet penale nga EPPO dhe auditimet nga ECA ose me një kërkesë të arsyetuar siç duhet të Komisionit.

## TITULLI VII MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI

Neni 25

### **Kërkesat e përgjithshme të raportimit për Përfituesit**

1. Komisioni dhe Përfituesi do të krijojnë një komitet monitorimi për Facilitetin e Reformës dhe të Rritjes, jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Komiteti i Monitorimit të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes do të vlerësojë shkallën dhe cilësinë e zbatimit të të gjitha reformave dhe të investimeve në drejtim të përmbushjes së objektivave të përcaktuar në Agjendën e Reformës dhe në Rregulloren (BE) 2024/1449.

Për këtë qëllim, Përfituesi do të monitorojë rregullisht dhe sistematikisht, në nivel politik dhe teknik, dhe do të zbatojë rregullime raportimi për të informuar mbi progresin drejt arritjes së rezultateve të planifikuara, duke siguruar kështu që raportimi të Komisioni të jetë i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Rregullimet për monitorimin dhe raportimin do të përfshijnë të gjitha elementet e mëposhtme:

i. struktura institucionale (duke përfshirë rregullimet e nevojshme të koordinimit dhe zinxhirin e miratimit të palëve të interesuara që do të sigurojnë saktësinë e raportimit);

ii. informacionin që do të përdoret dhe jepet dhe planifikimin e brendshëm të disponueshmërisë së këtij informacioni;

iii. proceset e kontrollit të cilësisë që rregullojnë mbledhjen dhe analizën e të dhënave përkatëse (duke përfshirë, kur është e nevojshme, rregullimet për garantimin e cilësisë për mbledhjen e të dhënave nga partnerët e mëvonshëm – duke përfshirë

ndarjen e të dhënave (d.m.th. sipas gjinisë, moshës, rurale/urbane etj.); dhe

iv. parashikimet për vlerësimin e palës së tretë, kur është e nevojshme. Nëse ka mangësi serioze që ndikojnë në cilësinë e informacionit të përdorur, Përfituesi do të specifikojë pasojat dhe masat lehtësuese të parashikuara në përputhje me rrethanat.

Monitorimi dhe raportimi do të duhet, gjithashtu, të marrin në konsideratë masën në të cilën reformat dhe investimet përkatëse marrin parasysh parimin “mos lejo asnjë prapa” dhe kontribuojnë në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Gjithashtu, Përfituesi do të angazhohet të sigurojë që një sistem i tillë të jetë i pavarur dhe mund të garantojë llogaridhënie dhe transparencë efektive në zbatimin e buxhetit të Bashkimit.

3. Komiteti i Monitorimit do të përbëhet nga përfaqësues të Komisionit, Koordinatorit dhe autoriteteve dhe organeve të tjera përkatëse të Përfituesit dhe, sipas rastit, donatorët dypalësh, organizatat ndërkombëtare, institucionet financiare ndërkombëtare dhe palët e tjera të interesuara, si shoqëria civile dhe organizatat e sektorit privat.

4. Një përfaqësues i Komisionit dhe i Koordinatorit do të bashkëkryesojnë mbledhjet e Komitetit të Monitorimit të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes.

5. Komiteti i Monitorimit do të mbledhet të paktën një herë në vit. Takimet *ad hoc* mund të thirren, gjithashtu, me nismën e Komisionit ose të Përfituesit, veçanërisht për të diskutuar tema specifike.

6. Për të garantuar një koordinim efektiv gjatë zbatimit të Facilitetit, përfaqësuesit e Komisionit, Zyrës së Koordinatorit dhe institucioneve të tjera të Përfituesit do të zhvillojnë takime të rregullta në nivel teknik për të diskutuar investimet dhe reformat në Agjendën e Reformës, të cilat mund të krijojnë sfida specifike zbatimi dhe/ose ndonjë risk madhor për planifikimin kohor për realizimin e çdo hapi, veçanërisht kur kjo mund të ketë implikime për afatin kohor të kërkesës shoqëruese për lirimin e fondeve.

7. Të dhënat e monitorimit të mbledhura dhe të trajtuara nga Përfituesi:

a) Do të përfshihen në një raport gjashtëmujor mbi përmbushjen e kushteve të pagesës të Agjendës së Reformës, i cili do të shoqërojë të gjitha kërkesat për lirimin e fondeve. Çdo raport do të japë një



përshkrim të saktë të zbatimit të reformave themelore të matura nga treguesit përkatës (dhe bazat përkatëse të referimit dhe hapat cilësorë dhe sasiorë).

b) Do të përfshihen në një raport vjetor mbi ecurinë e përgjithshme të Agjendës së Reformës në drejtim të arritjes së objektivave të përgjithshëm dhe specifike të Facilitetit, në përputhje edhe me treguesit e përfshirë në Agjendën e Reformës, duke përdorur formatin e ofruar nga Komisioni. Kjo do të kontribuojë në monitorimin vjetor të Facilitetit nga Komisioni, në përputhje me nenin 25 të Rregullores (BE) 2024/1449. Raporti përfundimtar vjetor do të mbulojë të gjithë periudhën e zbatimit të Agjendës së Reformës. Raporti vjetor do të dorëzohet së bashku me Programin Ekonomik dhe të Reformës së Përfituesit, nëse është e mundur, jo më vonë se data 1 mars e çdo viti. Raporti vjetor do të përmbushë, gjithashtu, kërkesat e raportimit të përcaktuara në nenin 28 të Rregullores (BE) 2024/1449.

8. Për të mundësuar që Komisioni të monitorojë Instrumentin e Facilitetit, Përfituesi do të bëjë rregullimet e nevojshme për t'i dhënë Komisionit akses të plotë në të dhënat themelore të monitorimit.

9. Komisioni mund të ndërmarrë vlerësime shtesë, si nëpërmjet stafit të tij dhe/ose konsulentëve të pavarur të rekrutuar drejtpërdrejt nga Komisioni për rishikime të pavarura monitorimi.

#### Neni 26 Gjuha

1. Të gjitha raportet, deklaratat, deklaratimet dhe llogaritë në lidhje me përgatitjen ose zbatimin e asistencës në kuadër të Instrumentit të Facilitetit, do t'i jepen Komisionit në gjuhën angleze.

#### Neni 27 Informacioni për kontekstin e vlerësimeve *ex-post* të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes nga Komisioni

1. Përfituesi do të lehtësojë aksesin e Komisionit të palët e interesuara dhe në të gjithë informacionin përkatës, duke përfshirë të dhënat themelore të monitorimit, vlerësimet dhe/ose studimet e tjera që Përfituesi mund të kryejë në kuadër të Instrumentit të Facilitetit, të cilat janë të nevojshme që Komisioni të kryejë vlerësimin *ex-post* të përmendur në nenin 27

të Rregullores (BE) 2024/1449 pas dhjetorit 2027 dhe deri më dhjetor 2031.

#### TITULLI VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 28 Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje, pas nënshkrimit të saj nga Palët, do të hyjë në fuqi në datën kur Përfituesi njofton me shkrim Komisionin për përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Marrëveshja do të mbetet në fuqi derisa të përfundojnë të gjitha masat e financuara nga Instrumenti i Facilitetit, të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur interesat financiarë të Bashkimit dhe të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve.

#### Neni 29 Ndryshimet

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve do të bëhet me shkrim dhe mund të marrë formën e një shkëmbimi letrash. Çdo ndryshim do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve do të hyjë në fuqi në datën kur Përfituesi njofton me shkrim Komisionin për përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të ndryshimit.

3. Pa cenuar paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Komisioni mund të ndryshojë në mënyrë të njëanshme çdo aneks. Komisioni do të njoftojë Përfituesin për çdo ndryshim të tillë.

#### Neni 30 Pezullimi i Marrëveshjes

1. Marrëveshja e mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

- Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, nëse BE-ja ose Përfituesi vendos të pezullojë ose të pushojë procesin e anëtarësimit në BE;

- Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nëse Përfituesi shkel parakushtet e përcaktuara në nenin 5(1) të Rregullores (BE)



2024/1449 ose një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose sipas marrëveshjes së huas.

- Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, nëse Përfituesi shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimeve të demokracisë dhe sundimit të ligjit, ose në raste të rënda të korrupsionit;

- Kjo Marrëveshje mund të pezullohet në rastet e forcës madhore. “Forcë madhore” është çdo situatë ose ngjarje e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve që pengon secilën prej tyre në përmbushjen e detyrimeve të tyre, e cila nuk i atribuohet një gabimi apo pakujdesie nga ana e tyre (ose nga ana e kontraktuesve, agjentëve apo të punësuarve të tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme, pavarësisht kujdesit të duhur. Defektet në pajisje ose në materiale apo vonesat në vënien e tyre në dispozicion, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një Palë nuk mund të konsiderohet se ka shkelur detyrimet të saj, nëse pengohet t’i përmbushë nga një rast i forcës madhore, për të cilin Pala tjetër është informuar në mënyrën e duhur. Një Palë që përballet me forcë madhore duhet të informojë Palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe ndonjë masë për minimizimin e dëmit të mundshëm. Asnjë nga Palët nuk mund të shpallet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse pengohet në përmbushjen e tyre, për shkak të një force madhore, me kusht që të marrë masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm.

2. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake para se të ndodhë pezullimi.

4. Kur njoftohet pezullimi, duhet të specifikohen pasojat për zbatimin e Instrumentit të Facilitetit.

5. Palët fillojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje menjëherë pasi këtë e lejojnë kushtet, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo bëhet pa cenuar ndonjë ndryshim të kësaj Marrëveshjeje që mund të jetë i nevojshëm për t’u përshtatur me kushtet e reja të zbatimit, ose ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 31.

Neni 31

### Ndërprerja e Marrëveshjes

1. Nëse çështjet që çuan në pezullimin e kësaj Marrëveshjeje nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje me një njoftim 30 ditë para.

2. Pa cenuar paragrafin 1, nëse në çdo kohë, Komisioni çmon se qëllimi i kësaj Marrëveshjeje nuk mund të realizohet më në mënyrë efektive ose të përshtatshme, kjo Marrëveshje mund të ndërpritet duke dërguar një njoftim të arsyetuar me shkrim 30 ditë para.

3. Pa cenuar nenin 28(2), pasojat e kësaj ndërprerjeje në zbatimin e Instrumentit të Facilitetit mund të analizohen, sipas nevojës, dhe të përcaktohen rast pas rasti.

Neni 32

### Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

1. Komisioni cakton Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, ose çdo drejtori të përgjithshme pasardhëse në të ardhmen, si interlokutor/pjesëmarrës në negociatën për monitorimin e zbatimit të Instrumentit të Facilitetit dhe të kësaj Marrëveshjeje në emër të Komisionit.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të nënshkruhet dhe të jepet si dokument origjinal ose dokument origjinal i skanuar.

3. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

#### Për Komisionin:

Komisioni Evropian

Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Fqinjësinë dhe Zgjerimin

Në vëmendje të Drejtorit të Ballkanit  
Perëndimor

Rue de la Loi 200/Wetstraat 200, 1049  
Bruxelles/Brussel, Belgium (Belgjikë)

Email: NEAR-D@ec.europa.eu

#### Për Përfituesin:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë



Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC) dhe Koordinatori Kombëtar për IPA-n

Znj. Eridana Çano, Drejtore e Përgjithshme, SASPAC dhe Koordinatore Kombëtare për IPA-në  
Rruga e Kuvajtit, Tiranë, Shqipëri  
Email: [Eridana.Cano@saspac.gov.al](mailto:Eridana.Cano@saspac.gov.al)

Neni 33

### Legjislacioni dhe juridiksioni rregullues

1. Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jashtëkontraktor që rrjedh nga ose në lidhje me të, do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, të plotësuar, kur është e nevojshme, nga legjislacioni i Luksemburgut.

2. Palët angazhohen të paraqesin çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mbi ligjshmërinë, vlefshmërinë, interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në juridiksionin ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 272 të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

3. Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian do të jenë plotësisht të detyrueshme për dhe të zbatueshme nga Palët.

4. Komisioni mund të zbatojë çdo vendim në lidhje me paragrafin 3 të këtij neni, të marrë nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, Përfituesi, në gjykatat e Përfituesit, në përputhje me procedurat e njohjes dhe të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të huaja të përcaktuara në legjislacionin e Përfituesit.

5. Në këtë mënyrë, Përfituesi heq dorë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar nga çdo imunitet për të cilin ai ka ose mund të ketë të drejtë, në lidhje me veten ose pasuritë e tij, nga proceset ligjore, në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë, por jo vetëm, imunitetin nga padia, gjykimi ose urdhër tjetër, nga sekuestrimi, arrestimi ose vendimi i ndërmjetëm para vendimit gjyqësor, dhe nga ekzekutimi dhe përmbarimi kundër aseteve të tij, në masën që nuk ndalohet me ligj detyrues.

Neni 34

### Rregullimet për dhënien e informacionit shtesë

1. Komisioni do të ketë mundësinë që të kërkojë informacion shtesë nga Përfituesi përpara kërkesës

së radhës për lirim të fondeve. Nëse Përfituesi nuk arrin të përmbushë këtë afat, Komisioni do të lejohet të mos trajtojë kërkesat për lirim të fondeve derisa të jepet informacioni.

Neni 35

### Parlamenti Evropian dhe Këshilli

1. Sipas nenit 11(7) të Rregullores (BE) 2024/1449, Përfituesi bie dakord që Komisioni t'i përcjellë Agjendën e Reformës Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

2. Sipas nenit 9(2) dhe nenit 17(4) të Rregullores (BE) 2024/1449, Përfituesi bie dakord që Komisioni mund t'i vendosë në dispozicion Parlamentit Evropian, sipas kërkesës, një kopje të kësaj Marrëveshjeje dhe një kopje të marrëveshjes së huas.

Neni 36

### Anekset

Anekset e mëposhtme përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje:

Aneksi A: Modeli i kërkesës për lirim të fondeve

Aneksi B: Modeli i deklaratës së garancisë

Aneksi C: Raportimi i parregullsisë

Aneksi D: Përkufizime të mëtejshme për qëllim të mbrojtjes së interesave financiare të BE-së

### Nënshkrimet

Kjo Marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Nënshkruar për dhe në emër të Përfituesit, në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_

nga \_\_\_\_\_

Znj. Eridana Çano

Drejtore e Përgjithshme, SASPAC dhe Koordinatorë Kombëtarë për IPA-në

Nënshkruar për dhe në emër të Bashkimit Evropian, në Bruksel më \_\_\_\_\_

nga \_\_\_\_\_

Znj. Valentina Superti

Drejtore për Ballkanin Perëndimor



ANEKSI A  
MODELI I KËRKESËS PËR LIRIMIN E FONDEVE

Vendi, data

Ambasador x  
Delegacioni/Zyra e BE-së në xxx  
XXXXXXXXXXXX

Deklaroj se për zbatimin e ndihmës financiare të BE-së për *[Përfituesin e Instrumentit të Reformës dhe Rritjes]*, në kuadër të Instrumentit të Facilitetit për periudhën (TMX/VV), bazuar në gjykimin tim dhe informacionin që kam në dispozicion, si dhe në të dhënave bashkëlidhur, kushtet e pagesës të përcaktuara në Agjendën e Reformës së *[Përfituesit të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes]* për hapat e mëposhtëm janë përmbushur:

Reforma	Hapi	Vlera financiare
1	1,1	(X) EURO
1	1,2	(X) EURO
		Totali

Bazuar në sa më sipër, kërkoj që shuma prej (X) euro të vihet në dispozicion, (Y) euro të disbursohet drejtpërdrejt në thesarin e *[Përfituesit të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes]* dhe (Z) euro të vendoset në dispozicion nëpërmjet Kuadrit të Investimit në Ballkanin Perëndimor (WBIF), nga të cilat (A) euro në formën e huas dhe (B) EURO në formën e mbështetjes së pakthyeshme<sup>1011</sup>.

Gjeni bashkëlidhur një vlerësim të çdo hapi, të dhënat e kërkuara që tregojnë përmbushjen e kënaqshme të hapave cilësorë dhe sasiorë të përcaktuar në aneksin përkatës të vendimit zbatues të Komisionit<sup>12</sup> dhe informacion tjetër të kërkuar sipas nenit 14 të Marrëveshjes së Instrumentit.

Deklaroj, gjithashtu, se masat në lidhje me reformat për të cilat është deklaruar përmbushje e kënaqshme më parë, në vendimet e mëparshme të Komisionit, nuk janë anuluar nga *[Përfituesi i Instrumentit të Reformës dhe Rritjes]*.

**(Vendi dhe data e lëshimit)**  
**Nënshkrimi nga Koordinatori**  
**(Mbiemri, emri, titulli ose funksioni)**

<sup>10</sup> Sipas rregullave të përcaktuara në nenet 16 dhe 17, çdo këst do të tërheqë nga kontributet financiare indikative të përcaktuara në nenin 2, paragrafin 2, si më poshtë: a) 28.7% nga mbështetja e pakthyeshme dhe 24.8% nga huaja, totali 53.5%, që do të vendoset në dispozicion nëpërmjet Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF); dhe b) 46.5% nga huaja që do të kanalizohet drejtpërdrejt në Thesar.

<sup>11</sup> Një kusht pararendës për disburimin e huas në Thesar që do të kanalizohet nëpërmjet WBIF-së, është dorëzimi i marrëveshjes së nënshkruar të kontributit me WBIF-në. Kjo marrëveshje e nënshkruar duhet të sigurohet përpara se të kryhet çdo disburim huaje.

<sup>12</sup> [referenca e numrit CID, data]



## ANEKSE

Përmbledhja e auditit e bërë nga autoritetet relevante, duke përfshirë dobësitë e identifikuara, si dhe çdo masë korigjuese të ndërmarrë.

### 1. Fisha që do të përdoret për çdo hap:

Hapi në rishikim	[Lutem kopjoni nga Agjenda e Reformave]
Baza e referimit	[Lutem kopjoni nga Agjenda e Reformave]
Afati i hapit	[muaji/viti]
Rezultatet aktuale	[Jepni një analizë të detajuar të përmbushjes së hapit ose justifikimit për mospërmbushjen e hapit]
Të dhënat e ofruara	[Jepni burimin specifik të verifikimit që vërteton rezultatet]
Kontrollet e kryera gjatë verifikimit të hapit dhe gjetjet përkatëse	[Jepni një përshkrim të masave të ndërmarra për të kontrolluar që hapi është përmbushur në përputhje me rregullat e aplikueshme dhe gjetjet përkatëse]
Konkluzioni i qartë për arritjen e hapit	[realizuar plotësisht ose nuk është realizuar/ realizuar pjesërisht (e vlefshme vetëm në fund të periudhës së tolerancës)]

#### Udhëzuesi për hapat sasiorë të realizuar pjesërisht

Për hapat sasiorë (d.m.th. hapat objektivisht të matsbëm), një normë përmbushjeje e pjesshme e përcaktuar si një nivel realizimi më pak se 100%, do të garantonte një lirim të pjesshëm të fondeve në fund të periudhës së tolerancës, të zbatueshme sipas parametrave të mëposhtëm:

- 0% disbursim për një nivel realizimi ndërmjet 0% dhe 49%;
- 50% disbursim për një nivel realizimi ndërmjet 50% dhe 89%;
- 100% disbursim për një normë realizimi prej 90%–100% ose më lart.

Nëse hapi nuk përmbushet brenda afatit, autoritetet do ta ri-paraqesin hapin për departamentet përkatëse të Komisionit për ta vlerësuar atë në fund të periudhës së tolerancës. Disbursimet e pjesshme do të kryhen vetëm pas vlerësimit në fund të periudhës së tolerancës. Nëse hapi është përmbushur pjesërisht, atëherë parametrat e mësipërm do të zbatohen në llogaritjen e shumës së detyrimit. Nëse hapi është përmbushur në një nivel më të ulët se 50%, atëherë fondet do të mbahen në përputhje me dispozitat në fuqi (neni 21 i Rregullores (BE) 2024/1449).

Për hapat apo nënhapat cilësorë, realizimi i pjesshëm nuk është i mundur.

#### Udhëzuesi për të dhënat që duhet të jepen

**Të dhënat** që shoqërojnë kërkesën për lirin e fondeve, duhet:

- të tregojnë përmbushje të kënaqshme të hapit (nuk është e nevojshme të ngarkoni të dhëna përtej asaj që kërkohet);

- të kenë emra të shkurtër, por të qartë dhe unikë të dosjeve që i referohen qartë hapit në fjalë dhe që numërohen për të lejuar një referencë unike dhe treguar qartë përmbajtjen e saj;

- të përfshijnë identifikuesit përkatës, si referenca në Fletoren Zyrtare, datën e botimit dhe nenet që tregojnë hyrjen në fuqi (i njëjti format për referencën në tekste ligjore duhet të përdoret në të gjitha rastet);

- të përfshijnë identifikimin e nënshkruarit/sve (funktionin, jo emrat) dhe autoritetin që ata përfaqësojnë, çdo varg identifikues të numrave dhe/ose karaktereve dhe numrin e protokollit, nëse jepet (për dokumente joligjore) dhe të mbajnë numrin e regjistrimit (për shembull dokumentet kadastrale, regjistrin e shoqërive tregtare, regjistrin e anijeve etj.), nëse figurojnë në ndonjë lloj regjistri zyrtar;

- të shoqërohen me një link në faqen e internetit ku publikohen të dhënat (ose në rast se dokumenti ngarkohet në një platformë elektronike, duhet të përmendet platforma dhe çdo numër reference që lejon aksesin në të);

- të paraqiten në mënyrë të qartë dhe të organizuar, duke përmbajtur referenca të qarta të kryqëzuara/krabasuese për kërkesën të cilën të dhënat supozohet të vërtetojnë;

- të japin garanci të arsyeshme që janë përmbushur elementet përbërëse të hapit – për këtë qëllim, të dhënat e ofruara duhet të jenë parësore dhe të drejtpërdrejta që tregojnë përmbushjen e kërkesës përkatëse; nuk pranohen vetëdeklarimet.

Përmbushja e kënaqshme e çdo hapi duhet të justifikohet, duke siguruar të dhëna dhe dokumentacion zyrtar. Kjo duhet të përfshijë të paktën:



- një dokument përmbledhës që ofron një vlerësim të qartë sesi hapat sasiorë ose cilësorë (duke përfshirë të gjithë elementet përbërëse) janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme në përputhje me dispozitat e përcaktuara në përshkrimin e hapit, siç parashikohet në Agjendën e Reformës dhe aneksin I shoqërues;

- për hapat që kërkojnë hyrjen në fuqi të një akti ligjor: një kopje të botimit në Fletoren Zyrtare të aktit ligjor përkatës;

- për hapat që kërkojnë miratimin e një strategjie/plani veprimi/udhërrëfyesi/çdo akt tjetër publik që nuk konsiderohet akt ligjor: një kopje të aktit që miraton zyrtarisht strategjinë dhe një linku në faqen e internetit ku mund të konsultohet strategjia;

- për hapat që kërkojnë nxjerrjen e një raporti që nuk është publikuar: një kopje të raportit të brendshëm ose të jashtëm, të miratuar nga instanca përgjegjëse (p.sh. ministri, drejtuesi i zyrës, organi menaxhues...);

- për hapat që kërkojnë që një infrastrukturë/sistem/sbërbim i caktuar të vihet në funksionim: certifikatat e përfundimit të nënshkruara nga kontraktori dhe autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin kombëtar që tregojnë se sistemi është ngritur dhe është funksional, të shoqëruara me dëshmi që do të vihet në përdorim (p.sh. akses i Përfituesve në agjenci të reja);

- nëse matja e nivelit të realizimit të një hapi kërkon që t'i bëhet referencë të dhënave zyrtare statistikore: përmendja e qartë e burimeve zyrtare statistikore;

- çdo dokument tjetër përkatës që çmohet i rëndësishëm për justifikimin ligjor formal të përmbushjes së kënaqshme të hapit sasior ose cilësor, në përputhje me parashikimet e Agjendës së Reformës dhe Aneksit të Agjendës së Reformës.

### **Perspektivat e realizimit të hapave të kërkuar për lirin e ardhshëm të fondeve**

- Kjo pjesë do të ofrojë një vlerësim të mundësive të përmbushjes së hapave për lirin e ardhshëm të fondeve, bazuar në progresin e regjistruar më sipër.

## **ANEKSI B**

### **MODELI I DEKLARATËS SË GARANCISË**

Unë, i nënshkruari, [Emri Mbiemri], në cilësinë time si Koordinator,

Deklaroj se, për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për [Përfituesin e Instrumentit të Reformës dhe Rritjes], në kuadër të Instrumentit për periudhën XX/YY, bazuar në gjykimin tim dhe në informacionin që kam në dispozicion, në veçanti

rezultatet e sistemeve kombëtare të kontrollit dhe auditimit të përshkruara në Agjendën e Reformës:

1. Fondet janë përdorur për qëllimin e tyre të synuar, siç përcaktohet në nenin 1(1) të Marrëveshjeve të Instrumentit dhe Huas ndërmjet Komisionit dhe [Përfituesit të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes].

2. Informacioni i paraqitur me kërkesën për lirin e fondeve është i plotë, i saktë dhe i besueshëm; justifikon siç duhet që hapat cilësorë dhe sasiorë janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme dhe që ekziston gjurma e auditimit, e cila tregon realizimin e këtyre hapave.

3. Sistemet e kontrollit në zbatim japin garancitë e nevojshme që financimi i dhënë është përdorur në përputhje me të gjitha rregullat e zbatueshme, veçanërisht për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesave dhe parregullsive.

4. Rregullimet në fuqi japin garancinë e nevojshme që fondet e ofruara nuk kanë rezultuar në financim të dyfishtë nga Instrumenti i Facilitetit dhe programe apo instrumente të tjera të Bashkimit, si edhe donatorë të tjerë.

Një përmbledhje e auditimeve kombëtare të kryera në lidhje me paragrafët 1 deri në 4 më sipër, me një analizë të pikave të dobëta të konstatuara dhe veprimeve korrigjuese të ndërmarra ose të planifikuara, plotëson këtë deklaratë garancie. [Në përmbledhjen shoqëruese të auditimeve, nuk janë konstatuar shkelje për sa u përket mashtrimit, korrupsionit apo konfliktit të interesit.] [Në përmbledhjen shoqëruese të auditimeve janë konstatuar shkeljet e mëposhtme për sa u përket mashtrimit, korrupsionit apo konfliktit të interesit: (identifikoni dhe specifikoni veprimet korrigjuese të ndërmarra)]

Konfirmoj se parregullsitë e identifikuar gjatë raporteve përfundimtare të auditimit ose kontrollit për zbatimin e Agjendës së Reformës janë korrigjuar dhe rikuperuar në mënyrë të duhur nga përfituesit fundorë ose janë në proces korrigjimi dhe rikuperimi. Sipas nevojës, mangësitë në sistemin e kontrollit të theksuara në ato raporte janë ndjekur në mënyrë të përshtatshme ose janë në proces të ndjekjes, veçanërisht për veprimet e mëposhtme të nevojshme korrigjuese: (nëse është e nevojshme, specifikoni se cilat veprime korrigjuese janë ende në proces, në datën e nënshkrimit të deklaratës).



Në përfundim, konfirmoj se nuk jam në dijeni të ndonjë çështjeje të pazbuluar reputacioni për zbatimin e programit.

(Vendi dhe data e lëshimit)

Nënshkrimi

(Mbiemri, emri, titulli ose funksioni)

## ANEKSI C RAPORTIMI I PARREGULLSIVE

### **Klauzola 1 Përkufizimet**

Për qëllime të raportimit të parregullsisve, përfshirë mashtrimin, do të zbatohen përkufizimet e përcaktuara në aneksin D, për mbrojtjen e interesit financiar të Bashkimit.

### **Klauzola 2 Raportimi i parregullsisve**

1. Përfituesi do t'i raportojë Komisionit pa vonesë çdo parregullsi, duke përfshirë mashtrimin e dyshuar, mashtrimin, korrupsionin dhe aktivitete të tjera të paligjshme, të cilat kanë qenë objekt i një konstatimi parësor administrativ ose gjyqësor, dhe do ta informojë atë mbi ecurinë e procedurave administrative dhe ligjore.

Parregullsitë për një shumë më të ulët sesa 300 euro në kontributin e BE-së, nuk do të raportohen. Kjo dispozitë nuk zbatohet për parregullsitë që shkaktojnë fillimin e proceseve administrative ose gjyqësore në nivel kombëtar, për të vërtetuar praninë e mashtrimit ose veprave të tjera penale.

Në atë raport, Përfituesi në të gjitha rastet do të japë detajet e mëposhtme:

- a) Emrin dhe numrin e programit/veprimit në fjalë;
- b) Identitetin e personave fizikë dhe juridikë të përfshirë ose të çdo subjekti tjetër pjesëmarrës dhe rolin e tyre;
- c) Identifikimin e rajonit ose të zonës ku është kryer operacioni, duke përdorur informacionin e duhur;
- d) dispozitat që janë shkelur;
- e) datën dhe burimin e pjesës së parë të informacionit që çon në dyshimin se është kryer një parregullsi;
- f) natyrën, qëllimet dhe sjelljet dhe praktikatat materiale të përdorura në kryerjen e parregullsisve;
- g) sipas rastit, nëse praktika krijon dyshime për mashtrim;
- h) mënyrën sesi është zbuluar parregullsia;

Faqe | 6292

i) sipas rastit, Shtetet Anëtare dhe/ose vendet e treta të përfshira;

j) periudhën gjatë së cilës, ose momentin kur është kryer parregullsia;

k) datën e vërtetimit të konstatimit parësor administrativ ose gjyqësor për parregullsinë;

l) shumën totale të shpenzimeve të pranueshme të specifikuar nga kontributi i Bashkimit, kontributin e Përfituesit dhe kontributin privat;

m) shpenzimet e cenuara nga parregullsia, të specifikuar nga kontributi i Bashkimit dhe kontributi i Përfituesit;

n) shumën që do të ishte paguar në mënyrë të paligjshme nëse parregullsinë nuk do të ishte identifikuar, sipas kontributit të Bashkimit dhe kontributit të Përfituesit;

o) natyrën e shpenzimeve të parregullta;

p) pezullimin e pagesave, nëse ka, dhe mundësinë e rikuperimit;

q) nëse ka, arsyet për çdo braktisje të procedurave të rikuperimit;

r) nëse ka, numri i plotë i çështjes OLAF/EPPO.

2. Kur një pjesë e informacionit të përmendur në paragrafin 1 dhe në veçanti informacioni mbi praktikatat e përdorura në kryerjen e parregullsisë dhe mënyrën në të cilën u zbulua, nuk është në dispozicion ose duhet të korrigojë, Përfituesi duhet t'i japë Komisionit pa vonesë informacionin e munguar ose të saktë.

3. Nëse dispozitat përkatëse ligjore kombëtare parashikojnë konfidencialitetin e hetimeve, komunikimi i informacionit do të kushtëzohet nga autorizimi i trupit gjyqësor ose gjykatës kompetente.

### **Klauzola 3 Informacioni për sanksionet**

1. Përfituesi do t'i japë Komisionit pa vonesë, duke iu referuar çdo raporti të mëparshëm të bërë sipas klauzolës 2, detaje në lidhje me fillimin, përfundimin ose braktisjen e çdo procedure për vendosjen e sanksioneve administrative ose penale në lidhje me parregullsitë e raportuara, si edhe me rezultatin e këtyre procedurave.

a) Në lidhje me parregullsitë për të cilat janë vendosur sanksione, Përfituesi duhet të specifikojë, gjithashtu:

b) nëse sanksionet kanë natyrë administrative apo penale;

c) nëse sanksionet rezultojnë nga një shkelje e ligjit të Bashkimit ose të Përfituesit;

d) dispozitat ku parashikohen sanksionet;



e) nëse është konstatuar mashtrim.

2. Me kërkesë me shkrim të Komisionit, Përfituesi do të japë informacion shtesë për një parregullsi specifike ose grup parregullsish.

#### **Klauzola 4 Raportimi elektronik nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Parregullsive (IMS)**

Informacioni i përmendur në klauzolat 2 dhe 3 do të dërgohet në gjuhën angleze, me rrugë elektronike, duke përdorur Sistemin e Menaxhimit të Parregullsive (IMS) të krijuar nga Komisioni për këtë qëllim.

#### **Klauzola 5 Përdorimi i informacionit**

Komisioni mund të përdorë çdo informacion me natyrë të përgjithshme ose operationale të komunikuar nga Përfituesit e Instrumentit, sipas këtyre dispozitave për të kryer analizat e riskut, duke përdorur, gjithashtu, mbështetjen e teknologjisë së informacionit, dhe në bazë të informacionit të marrë, mund të nxjerrë raporte dhe të zhvillojë sisteme që shërbejnë për të identifikuar riskun në mënyrë më efektive. OLAF-i, ECA dhe EPPO-ja mund të përdorin informacionin sipas mandatit të tyre.

#### **Klauzola 6 Përdorimi i euros**

Euro do të përdoret si monedhë për raportimin e parregullsive. [Nëse është e zbatueshme: Përfituesi do të konvertojë shumat e shpenzimeve të kryera në monedhën e tij në euro. Këto shuma do të konvertohen në euro, duke përdorur kursin mujor të këmbimit të Komisionit në muajin gjatë të cilit është regjistruar shpenzimi. Kursi i këmbimit publikohet në mënyrë elektronike nga Komisioni çdo muaj.

Kur shumat lidhen me shpenzimet e regjistruara në llogaritë e autoriteteve të Përfituesit gjatë një periudhe më shumë se 1 muaj, mund të përdoret kursi i këmbimit në muajin gjatë të cilit shpenzimi është regjistruar për herë të fundit. Kur shpenzimi nuk është regjistruar në llogaritë e autoritetit të Përfituesit, do të përdoret kursi më i fundit i këmbimit i publikuar në mënyrë elektronike nga Komisioni.]

#### **Klauzola 7 Mbrojtja e të dhënave personale**

1. Përfituesit e instrumentit të Reformës dhe Rritjes dhe Komisioni do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo zbulim të paautorizuar ose akses në informacionin e përmendur në klauzolat 2 dhe 3.

Informacioni i përmendur në klauzolat 2 dhe 3 nuk mund t'u dërgohet personave të tjerë përveç

atyre të Përfituesit ose brenda institucioneve, agjencive, zyrave dhe organeve të Bashkimit, detyrat e të cilëve kërkojnë që ata të kenë akses në të, përveç rasteve kur Përfituesi që jep këtë informacion nuk e ka shprehur dakordësinë e tij shprehimisht.

2. Çdo e dhënë personale e përfshirë në informacionin e përmendur në klauzolat 2 dhe 3, do të përpunohet vetëm për qëllimin e specifikuar në ato dispozita.

### **ANEKSI D**

#### **PËRKUFIZIME TË MËTEJSHME PËR QËLLIM TË MBROJTJES SË INTERESAVE FINANCIARË TË BE-së**

Për qëllim të mbrojtjes së interesave financiarë të Bashkimit, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

“Gabim” do të thotë gabime jo të qëllimshme administrative dhe teknike të kryera nga autoritetet e Përfituesit ose nga një marrës i asistencës në kuadër të Instrumentit të Facilitetit.

“Parregullsi” është çdo shkelje e një dispozite të rregullave dhe kontratave të zbatueshme që rezulton nga një veprim ose mosveprim i një operatori ekonomik ose autoriteteve të Përfituesit, që ka ose do të kishte efektin e cenimit të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit, duke ngarkuar një zë të pajustificuar të shpenzimeve në buxhetin e përgjithshëm.

“Operator ekonomik” është çdo person fizik ose juridik, duke përfshirë një ent publik ose një grup personash të tillë, i cili ofron të furnizojë produkte, të kryejë punë ose të ofrojë shërbime ose të furnizojë pasuri të paluajtshme.

“Parregullsi sistemike” është çdo parregullsi që mund të jetë me natyrë të përsëritur, me probabilitet të lartë për të ndodhur në lloje të ngjashme operationesh, e cila rezulton nga një mangësi e rëndë në funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, duke përfshirë mungesën e krijimit të procedurave të duhura, në përputhje me rregullat në fuqi.

“Mashtrim në lidhje me shpenzimet” është çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm në lidhje me:

- përdorimin ose paraqitjen e deklaratave ose të dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota që sjell si pasojë shpërdorimin ose mbajtjen e gabuar të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të Bashkimit Evropian;



- moszbulimin e informacionit në kundërshtim me një detyrim specifik me të njëjtin efekt;

- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë fillimisht.

“Mashttrim i dyshuar” është një parregullsi që shkakton fillimin e procedimeve administrative ose gjyqësore në nivel kombëtar për të vërtetuar praninë e sjelljes së qëllimshme, në veçanti mashttrim, siç përmendet më sipër.

“Korrupsion aktiv” është veprimi i qëllimshëm i një personi, i cili premton, ofron ose jep, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, avantazh të çfarëdo lloji për një nëpunës publik që ai vetë ose një palë e tretë të veprojë ose të mos veprojë në përputhje me detyrën ose të ushtrojë funksionet e tij në një mënyrë që dëmton ose mund të dëmtojë interesat financiarë të Bashkimit.

“Korrupsion pasiv” është veprimi i qëllimshëm i një nëpunësi publik, i cili, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, kërkon ose merr përfitime të çfarëdo lloji, për veten ose për një palë të tretë, ose pranon premtime për një avantazh të tillë, për të vepruar ose për të mos vepruar në përputhje me detyrën ose ushtuar funksionet e tij në një mënyrë që dëmton ose mund të dëmtojë interesat financiarë të Bashkimit.

“Konflikt i interesave”, në përputhje me nenin 61 të Rregullores Financiare do të thotë që ushtrimi i paanshëm dhe objektiv i funksioneve të një personi të përfshirë në zbatimin e mbështetjes financiare në kuadër të Instrumentit, rrezikohet për arsye që përfshijnë jetën familjare, emocionale, përkatësinë politike ose kombëtare, interesin ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal direkt ose indirekt. Konflikti i interesave përfshin situata që objektivisht mund të perceptohen si konflikt interesash.

“Konstatim parësor administrativ ose gjyqësor” nënkupton një vlerësim të parë me shkrim nga një autoritet kompetent, qoftë administrativ apo gjyqësor, i cili përfundon mbi bazën e fakteve specifike se është kryer një parregullsi. Kjo nuk cenon mundësinë që ky përfundim mund të duhet të rishikohet ose tërhiqet më pas si rezultat i zhvillimeve në rrjedhën e procedurës administrative ose gjyqësore.

- Përkufizimet e renditura në këtë nen nuk do të interpretohen si të tilla që paraqesin lloje të reja të krimit në Kodin Penal të Përfituesit ose ndryshime të tij.

## DEKRET

Nr. 100, datë 17.3.2025

### PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

#### DEKRETOJ:

##### Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së bashkimit evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje”.

##### Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së bashkimit evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë

